



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PERFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “BASHKINË
LEZHË”**

RAPORT AUDITIMI

**MBI
AUDITIMIN FINANCIAR**

“BASHKIA LEZHË”

TIRANE 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-12
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-10
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	10-12
II.	HYRJA	12-15
1.	Objekti i auditimit	12
2.	Qëllimi i auditimit	12
3.	Identifikimi i çështjes	12
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5.	Përgjegjësitë e audituesve	12-13
6.	Kriteret e vlerësimit	13
7.	Standardet e auditimit	13-14
8.	Metodat e auditimit	14-15
9.	Dokumentimi i auditimit	15
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-116
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.	16
2.1.	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	16-34
2.2.	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	34-52
2.3.	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	53-90
2.4.	Vlerësimi raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.	90-116
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	116-128
V.	ANEKSET	129-142

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
APP	Agjensia e Prokurimit Publik
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1017/1, datë 15.11.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 21.11.2021 deri në datën 30.03.2022, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021 në Subjektin Bashkia Lezhë, u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M. B., *Përgjegjës Grupi*
2. I. Sh., *anëtar*
3. A. R., *anëtar*
4. A. H., *anëtar*

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua regjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, si edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm. Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit. Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2021. Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 6 akte konstatimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Lezhë, brenda afatit të periudhës së auditimit. Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin, mangësitë e konstatuar gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Referuar akt-rakordimeve me Thesarin konstatohet se <u>për vitin 2021</u>, të ardhurat nga 703,556.7 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 535,113.9 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 168,442.8 mijë lekë, ose në masën 76.1%.</p> <p>Nga analiza e të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, me ndryshime të tilla realizimi edhe për të njëjtën taksë apo tarifë nga njëri vit në tjetrin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave.</p>	49-87	L	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera drejtuese, për arritjen e një planifikimi të plotë të të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore, të saktësojë treguesit e planit të ardhurave mbi baza reale, duke saktësuar regjistrin e taksapaguesve në lidhje me numrin e bizneseve (aktiv, pasiv e të

	<p>Pra, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pasi nuk është bazuar në llogaritje reale dhe të plotë të kapacitetit fiskal.</p> <p>Gjithashtu ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet regjistrit në Excel të krijuar me raportet e gjeneruara nga sistemit DATECH në fund të periudhës ushtrimore 2021.</p> <p>Pra akoma nuk administrohen të dhëna të sakta, si për numrin e bizneseve me status aktiv dhe për numrin e vlerat e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” të ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54 “Raportimi financiar” nënpika c, Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime.</p>			<p>pezulluar) nëpërmjet të dhënave nga QKR, DRTT e inspektimit në terren etj., për shfrytëzimin e plotë të kapacitetit fiskal.</p>
2	<p>Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerë progresive prej 923,488,684.9 lekë, ku vetëm shtesë për vitin 2021 është në vlerën 7,436,528 lekë, nga të cilat 7,250,861 lekë janë debitorë nga taksat dhe tarifat vendore dhe 165,207 lekë janë debitorë që vijnë nga shërbimi social dhe konvikti i shkollës.</p> <p>Referuar analizës së kësaj gjendje vërehen vlera të konsiderueshme për individë dhe për subjekte private për të cilët nuk disponohen të dhëna të sakta dhe se nga janë krijuar, se për çfarë janë debitorë, pasi nuk disponohet dokumentacion. Nga këto, vetëm për një pjesë dihet objekti i debisë si:</p> <p>a. Debitorët e institucioneve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 4,331,150 lekë.</p> <p>b. Gjobat e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 86,498,780 lekë.</p> <p>c. Debitorë të ndryshëm në vlerën 54,212,264 lekë, të krijuara para vitit 2009 të lëna si detyrime nga auditi i jashtëm në vite, për të cilat nuk disponohet dokumentacion.</p>	87-113	M	<p>-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.</p>

	<p>d. Debitorë biznesi i madh në vlerën 120,941,375.50 lekë</p> <p>e. Debitorë biznesi i vogël në vlerën 110,169,492.90 lekë</p> <p>f. Shoqëria “C. -Alb”shpk ish-Komunën Balldren, detyrim në vlerën 423,235,000 lekë i lënë nga KLSH në auditimin e kryer në vitin 2016 për periudhën viti 2015 e para tij në lidhje me qiradhënien e aseteve, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka pushuar çështjen, duke e vlerësuar se nuk ka dëm ekonomik. Ndërsa Avokatura e Shtetit nuk ka ofruar ndihmë sipas rekomandimit fillestar nga KLSH dhe për këtë arsye në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të ushtruar në vitin 2019, nga KLSH ky rekomandim është vlerësuar i pa zbatueshëm. Nga Bashkia Lezhë nuk është vepruar ligjërisht për reflektimin e veprimeve në kontabilitet.</p> <p>Për debitorët nga taksat dhe tarifatat për biznesin dhe familjarët nuk disponohen të dhëna të sakta se për çfarë lloje taksash dhe tarifash janë debitorë. Gjithashtu raportet e gjeneruara nga programi, ku mbahet sistemi i taksave dhe tarifave nuk ka funksionuar dhe nuk ka saktësi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15/b,59 /a,Kreu III. pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik “pika 3.3“ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 dhe i llogarive të klasës 5.</p>			
3	<p>Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “<i>Financim i pritshëm nga buxheti</i>” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 89,741,032.8 lekë të llogarisë 4342 “<i>Operacione me shtetin (të drejta)</i>” të bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e</p>	87-113	M	<p>-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “<i>Financim i pritshëm nga buxheti</i>”). Në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit</p>

	qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3, nënpika 59.			2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.
4	<p>Në bazë të përpunimit të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV, rezultoi se ka një numër të lartë debitorësh nga biznesi, (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesë etj), ku nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Në fund të vitit 2020 numri i debitorëve është 5451 subjekte në vlerën prej 232,216,597 lekë dhe në fund të vitit 2021 numri i debitorëve është 44349 subjekte në vlerën prej 241,253,830 lekë. Për një pjesë të debitorëve konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta, që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave apo tarifave dhe kamatëvonesave të akumuluar, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018, duke filluar nga viti 2011 janë gjeneruar nga sistemi në listim subjektësh debitorë me shumë progresive të debisë, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Nga Sektori i Borxhit për vitin 2021 janë bërë 499 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 190 masa shtrënguese si dhe janë nënshkruar 32 marrëveshje për likuidim me këste nga subjektet debitorë me vlere 26,068,589 lekë, nga të cilat janë arkëtuar brenda vitit 2021 në vlerë 20,601,727 lekë. Ndërsa për 7 institucionet debitorë në vlerën 2,892,100 lekë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së njoftimit për pagesë të detyrimeve tatimore.</p> <p>Nga DTTV për subjektet debitorë në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50 përqind të qarkullimit të realizuar ditor si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite, në kundërshtim me ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.</p>	49-87	L	<p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 44349 subjekte në vlerën prej 241,253,830 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.</p>

	<p>3, neni 35, me ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, dhe ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.</p>			<p><i>c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, DPTTV të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana DTTV dhe Drejtoria Juridike Bashkia Lezhë, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</i></p>
5	<p>Sipas listave të vëna në dispozicion për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), pranë Bashkisë Lezhë sipas shkresave periodike të dërguara nga ish-ALUIZNI (sot ASHK), Drejtoria Rajonale Lezhë rezulton se:</p> <p>Janë identifikuar 1125 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit, ku për 691 legalizime ka të dhëna për detyrimet, ndërsa për 434 legalizime nuk disponohen të dhëna për sipërfaqen dhe për detyrimin. Nga 691 legalizimet e identifikuar me të dhëna, vlera e detyrimit është 26,504,380 lekë, ku nga këto kanë paguar 407 subjekte vlerën prej 18,375,997 lekë, duke mbetur pa shlyer nga 284 posedues të lejeve të legalizimit për taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 8,128,383lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë, pa llogaritur 434 legalizimet për të cilat nuk disponohen të dhëna dhe rastet e</p>	49-87	L	<p>z Bashkia Lezhë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK, Drejtoria Lezhë që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Lezhë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi.</p> <p>zDrejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa për evidentimin e plotë të individëve të pajisur me leje legalizimi për</p>

	<p><i>tjera të paidentifikuara fare në vite, për të cilat nuk përlllogaritet dot detyrimi në vlerë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</i></p> <p>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit nuk ka patur komunikim me ZVRPP Lezhë (sot ASHK) Drejtoria Lezhë, për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për të bashkëpunuar për arkëtimin e kësaj takse nga individët që tashmë kanë kryer legalizime dhe janë debitorë ndaj Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, dhe neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.</p>			<p>ndërtimet informale që nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për gjithë periudhën e shtrirjes së procesit të legalizimit në Shqipëri, duke hartuar një databazë të plotë me të gjitha të dhënat. Në bazë të këtij databaze të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijoje me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse në shumën 8,128,383lekë, nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.</p>
6	<p>Taksa e tokës bujqësore për vitin 2021 është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%. Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhurnuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme,(sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përlllogaritur, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me cfarë etj).</p> <p>Për vitin 2021 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i rregjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë <u>nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në rregjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të të</u></p>	49-87	L	<p>-Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK dhe Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjetnjoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale</p>

<p>dhënave mbi bazën e të cilave janë përllogaritur detyrimet.</p> <p>Referuar të dhënave që disponojnë NJA-të, të cilat janë të pa përditësuara, nga përllogaritjet e përafërta për 14665.8 ha të ndarë në 14382 familje fermere me ligjin 7501 shumëzuar me vlerën vjetore të taksës së tokës të kategorisë V-së prej 2100 lekë/ha, duke zbritur të ardhurat e realizuara rezulton vlera prej 26,680,180 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24, VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b “Taksa mbi tokën bujqësore”, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10</p>		<p>në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--------------------------------------------------------

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionit i auditimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Lezhë për vitin e ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të vitit 2021 të subjektit Bashkia Lezhë, pasi veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar, si edhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike (kriteret), por konstatohen raste keq klasifikimi të llogarive apo rastet të mospërputhshmërisë, të cilat janë anomali materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore të Bashkisë Lezhë.

Baza për opinion:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për

SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 32,890 milion lekë, si dhe anomalitë e konstatuara të përshkruara në vijim.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar¹, ku ka rezultuar se anomalitë janë materiale, por jo të përhapura sipas** përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

- Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga preja e artikujve kontabël.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezulton se në vlerën prej 923,488,685 lekë, ku vetëm shtesë për vitin 2021 është në vlerën 7,436,528 lekë. Referuar analizës së kësaj gjendje vërehen vlera të konsiderueshme për individë dhe për subjekte private për të cilët nuk disponohen të dhëna të sakta dhe se nga janë krijuar, se për çfarë janë debitorë, pasi nuk disponohet dokumentacion. Gjithashtu raportet e gjeneruara nga programi, ku mbahet sistemi i taksave dhe tarifave nuk ka funksionuar dhe nuk ka saktësi.

- Nga analiza e llog.202 “Studime dhe kërkime” rezulton se, në gjendjen e saj prej 38,396,671 lekë është përfshirë një vlerë prej 2,130,600 lekë, për të cilën nuk disponohen të dhëna se për çfarë projekt-studimesh bëhet fjalë. Gjithashtu në këtë llogari janë përfshirë aktive jo materiale, të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie.

- Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 1,085,472,103 lekë (kosto historike)”, ku sipas analizës konstatohet se përfshihet një vlerë prej 1,050,872,186 lekë, e cila nuk është e detajuar dhe mungojnë të dhënat se çfarë përfaqëson.

- Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 56,275,100 lekë (kosto historike)”. Për këto aktive nuk është kryer inventar për verifikimin dhe krahasimin me inventarin kontabël.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 89,741,032.8 lekë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” të bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Lezhë.

¹Sipas *Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2, fq 141: “Një opinion i kualifikuar/modifikuar duhet të shprehet kur audituesi ka marrë evidencë të mjaftueshme të auditimit dhe konstaton se ka gabime materiale të pasqyrat financiare ose nëse audituesi nuk mund të marrë evidencë të përshtatshme për aspektet e auditimit. Opinioni i kualifikuar jepet kur anomalitë ose kufizimi e fushëveprimit nuk janë aq material dhe të përhapur sa të kërkojë një opinion të kundërt ose një mohim të opinionit. (ISSAI 1700.7)”*.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJE

1. Objekti i auditimit: Dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

- nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

2. Qëllimi i auditimit. Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit financiar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord të procedurave të prokurimit, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

3. Identifikimi i çështjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Lezhë (*Nëpunësi autorizues*) dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi. Sipas përcaktimeve të pikës 6 e neni 34, neni 65-*Administrata e njësisë administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e neni 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

5. Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit

të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara; etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Lezhë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

6. Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “*Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”
- Udhëzimi MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj.
- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- Rregullore “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Lezhë”;

7. Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;

- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditit të Brendshëm, etj.

8. Metodat e auditimit.

Teknikat audituese:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Metodat audituese: -Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi

profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

-Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon².

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5 %**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

-Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Lezhë, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Lezhë, Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Lezhë. etj.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km², bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Lezhës shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit. Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore e bën këtë bashki një destinacion tërheqës për turizmin kulturor.

E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në një distancë të afërt. Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit pritet të nxisë përqendrimin e bizneseve vendore dhe rajonale në këtë qytet.

Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki. Bashkia e re do të ketë në territorin e saj qytetin e Shëngjinit dhe një vijë të gjatë bregdetare, e cila fillon nga rezervatet natyrore të mbrojtura të Bregut të Matit dhe të Kune-Vain-Tales deri te plazhet shkëmbore në veri të qytetit të Shëngjinit.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

-Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

- Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

-Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

KLSH me Vendimin nr.88., datë 02.06.2022, ka rekomanduar 34 masa gjithsej, nga këto 23 masa organizative, 7 masa për shpërbllim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 2 masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë, masat disiplinore janë lënë që të merren nga ana e Kryetarit të Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga KLSH.

Nga verifikimi, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 23 masa organizative gjithsej të rekomanduara, nuk është zbatuar asnjë masë.

-Nga 7 masa për shpërblim dëmi gjithsej në vlerën 3,235,680 lekë të rekomanduara, nuk – është zbatuar asnjë masë.

-Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Nga 2 masa lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë, nuk është zbatuar asnjë. Po kështu nuk është vepruar për masat disiplinore të cilat janë lënë që të merren nga Kryetari i Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga Kllsh.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, për gjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat saj, duke mos kryer dhe dokumentuar monitorimin e sistemit MFK dhe realizimin e objektivave të veprimitarisë së Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

“Menaxhimi i Riskut”

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve ka sjellë mos identifikimin e vlerësimit të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Lezhë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin, testimin etj.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë risqeve; përmirësimin e rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike; të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara; gjithashtu zhvillimin e programeve të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2018-2019 rekrutimi dhe emërimi në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm në pozicion drejtues të 2 audituesve është kryer jashtë kriterëve ligjore, pasi nuk kanë qenë të certifikuar si auditues të brendshëm dhe pa eksperiencë pune në auditim. Realizimi i planit në katër vitet është në masa të ulëta në rreth 33.5%, gjë e cila nuk është e argumentuar dhe për ndryshimet e ndodhura nuk është bërë rishikimi i planit. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit, mungon ndarja e detyrave, në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të MFK, raportet nuk janë koncize; gjetjet janë të karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, mungon kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë si dhe nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët; rekomandimet janë jo të mirë përcaktuara). Projekt Raporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve; Pyetëtori i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar. Afatet në fund të Projekt-raportit dhe Raportit Final janë vendosur jo sipas fateve ligjore të përcaktuara. Nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në një pjesë të dosjeve për vitet 2018-2019 mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, ndërsa për periudhën 2020-2021 nga Memo e hartuar është pa adresim gjë që nuk vërteton faktin nëse është përcjellë tek Kryetari i Bashkisë; Në auditimet e kryera për zbatim të rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit, dhe nuk përcaktohen masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për periudhën 2018-2021 nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë rrisi si: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare etj. Procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej, pasi nuk dokumentohej në asnjë nga dosjet e shqyrtuara me plotësimin e anekseve “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik”, duke mos realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 20-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.2. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve efektiv dhe i realizueshëm, të realizojë auditime të thelluara duke përcaktuar afatet e realizimit, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. dhe të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2020 janë realizuar 2,139,258.9 mijë lekë nga 2,927,616.1 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 73.1% dhe për vitin 2021 janë realizuar 3,030,370.8 mijë lekë nga 3,911,049.6 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.5%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në vitin 2020 në masën 65.3%, në vitin 2021 në masën 70.7% , pra kemi planifikim me rezervë të tij dhe zëri

t230-231 “Shpenzime për investime” në vitin 2020 në masën 39.6% dhe në vitin 2021 në masën 72.1%.

b. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhet, ku për vitin 2020 kanë ndodhur 36 ndryshime dhe për vitin 2021 janë kryer 56 ndryshime, gjë që tregon qartë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv.

c. Detyrimet e papaguara për vitin 2021 sipas bilancit janë në shumën **273,627,818** lekë ose në masën 7.54 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat kanë ardhur duke u ulur, krahasuar me vitin 2020, ku detyrimet ishin në shumë të konsiderueshme prej 306,308,895 lekë. Detyrimet e papaguara sipas bilancit të vitit 2020 nuk rakordojnë për shumën 8,700,647 lekë me raportimin në MFE, që i përket detyrimeve të prapambetura për investime të pa financuara nga Ministrinë e Linjës dhe FSHZH, të cilat nuk janë përfshirë në raportim.

d. Të ardhurat janë realizuar për *vitin 2020* në masën **53.9%**. dhe për vitin 2021 në masën **76.1%**, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 83% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike, FZHR e Ministrinë e Linjës) dhe 16.9% nga të ardhurat e veta. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik të kryejnë planifikimin e buxhetit të argumentuar dhe planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve.

Në vazhdimësi

3.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave për detyrimet e pa likuiduara nga ana e saj si dhe të paraqesë informacion në mbledhjen e këshillit bashkiak, për gjendjen e tyre në fund të vitit ushtrimor.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Referuar akt-rakordimeve me Thesarin konstatohet se, *për vitin 2020*, të ardhurat nga 624,361 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 336,831.3 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 287,529.7 mijë lekë ose në masën 53.9%. *Për vitin 2021*, të ardhurat nga 703,556.7 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 535,113.9 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 168,442.8 mijë lekë ose në masën 76.1%.

Nga analiza e të ardhurave në harkun kohor 2020-2021 konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, me ndryshime të tilla realizimi edhe për të njëjtën taksë apo tarifë nga njëri vit në tjetrin, gjë

që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar negativisht në realizimin e tyre. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pasi nuk është bazuar mbi një përcaktim real dhe të plotë të kapacitetit fiskal.

Gjithashtu ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV-ja nëpërmjet regjistrimit në Excel të krijuar me raportet e gjeneruara nga sistemi DATECH në fund të periudhave ushtrimore 2020 dhe 2021. Pra akoma nuk kemi të dhëna të sakta, si për numrin e bizneseve me status aktiv dhe për numrin e vlerat e debitorëve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” të ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54 “Raportimi financiar” nënpika c, me Udhëzimin i MFE nr.9 datë20.03.2018 Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200.Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 53, 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandim: Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore të saktësojë treguesit e planit të ardhurave mbi baza reale, duke saktësuar në regjistrin e taksapaguesve për numrin e tyre (aktiv, pasiv e të pezulluar) nëpërmjet të dhënave nga QKR, DRTT e inspektimit në terren, për shfrytëzimin e plotë të kapacitetit fiskal.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në bazë të përpunimit të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV rezultoi se, ka një sasi të konsiderueshme debitorësh nga biznesi, (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesë etj.), ku nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2020** numri i debitorëve është *5451 subjekte* në vlerën prej *232,216,597 lekë* dhe në fund të **vitit 2021** numri i debitorëve është *44349 subjekte* në vlerën prej *241,253,830 lekë*. Për një pjesë të debitorëve konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta, që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave apo tarifave dhe kamatëvonesave të akumuluar, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018, duke filluar nga viti 2011 janë gjeneruar nga sistemi në listim subjektsh debitorë me shumë progresive të debisë, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Nga Sektori i Borxhit **për vitin 2020** janë bërë 600 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 845 njoftime për vendosje të masave siguroese, 811 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB). **Për vitin 2021** janë bërë 499 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 190 masa shtrënguese si dhe janë nënshkruar **32** marrëveshje për likuidim me këste nga subjektet debitorë me vlerë *26,068,589 lekë*, nga të cilat janë arkëtuar brenda vitit 2021 në vlerë *20,601,727 lekë*. Ndërsa për 7 institucionet debitorë në vlerën *2,892,100 lekë* është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së njoftimit për pagesë të detyrimeve tatimore. Nga DTTV për subjektet debitorë në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar ditor si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, neni 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, neni 181. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 50-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore në 44349 subjekte fizik/juridik në vlerën prej 241,253,830 lekë (*sipas CD Aneksi nr. B/5 të bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), gjithashtu të analizojë e saktësojë edhe debitorët e krijuar para viteve 2018 me detyrimet e tyre sipas llojeve të taksave dhe tarifave.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të DTTV rezulton se *taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit* (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për familjarët për vitin 2020 është realizuar 93,603 mijë lekë nga 46,653 mijë lekë ose në masën 50% dhe për vitin 2021 është realizuar 58,940 mijë lekë nga 54,900 mijë lekë e planifikuar ose në masën 107%. Kjo tregon për një planifikim jo real të bazuar vetëm në derdhjet e Agjentit tatimor UK sha Lezhë, duke përjashtuar në planifikim abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK sha. Sipas akt-rakordimeve me UK sha debitorë për *taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit* (pastrim-gjelbërim-ndriçim) për **vitin 2020** janë 3241 familje në vlerën 12,049,788 lekë dhe për **vitin 2021** janë 2003 familje në vlerën 8,282,513 lekë. Nga Bashkia Lezhë nuk është lidhur akt-marrëveshje me Agjentin tatimor UK sha Lezhë, siç është e përcaktuar në dispozitat ligjore, në bazë të së cilës i lind e drejta për gjorbitjen e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura. Nga krahasimi i numrit të familjarëve për Bashkinë e Lezhës së bashku me NJA sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke hequr numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë faturuar, si dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat, sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Lezhë si rezultat i përlogaritjeve të përafërta për periudhën 202-2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sha, detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit rezulton në vlerën 105,804,400 lekë, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë e ndarë: për vitin 2020 për 15009 familje pa kontratë në vlerën 54,244,400 lekë dhe për vitin 2021 për 14639 familje pa kontratë në vlerën 51,560,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, Bashkia Lezhë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartojë regjistrin përkatës me të dhënat dokumentare e të evidentuara në terren, të kryejë njoftimet për familjet taksapaguese si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Gjithashtu Bashkia Lezhë të lidhë kontratë dhe të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e vlerës debitore prej 20,332,301 lekë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: *Taksa e tokës bujqësore* për **vitin 2020** është realizuar në shumën 4,580 mijë lekë nga 3,814 mijë lekë të planifikuara ose në masën 120.1% dhe për **vitin 2021** është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%. Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermerë (taksa pagues), nuk janë azhurnuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme, (sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës

të përlllogaritur, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me çfarë kulturash bujqësorë apo dru-frutore, etj.).

Për vitet 2020 dhe 2021 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermerë në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i regjistrit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë, nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në regjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mos përditësim të të dhënave mbi bazën e të cilave janë përlllogaritur detyrimet.

Referuar të dhënave që disponojnë NJA-të, të cilat janë të pa përditësuara, nga përlllogaritjet e përifertra për 14,665.8 ha të ndarë në 14,382 familje fermerë me ligjin 7501 shumëzuar me vlerën vjetore të taksës së tokës të kategorisë V-së prej 2,100 lekë/ha, duke zbritur të ardhurat e realizuara për 2 vitet objekt auditimi rezulton vlera prej 52,835,368 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë, e ndarë: për vitin 2020 në vlerën 26,155,188 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 26,680,180 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24 dhe në papajtueshmëri me VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b “Taksa mbi tokën bujqësore”, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 63-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK dhe Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Sipas listave të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) pranë Bashkisë Lezhë, sipas shkresave periodike të dërguara nga ish-ALUIZNI apo sot ASHK, Drejtoria Rajonale Lezhë për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, rezulton se:

Janë identifikuar 1125 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit, ku për 691 legalizime ka të dhëna për detyrimet, ndërsa për 434 legalizime nuk disponohen të dhëna për sipërfaqen dhe për detyrimin. Nga 691 legalizimet e identifikuar me të dhëna, vlera e detyrimit është 26,504,380 lekë, ku nga këto kanë paguar 407 subjekte vlerën prej 18,375,997 lekë, duke mbetur pa shlyer nga 284 posedues të lejeve të legalizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 8,128,383 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë, pa llogaritur 434 legalizimet për të cilat nuk disponohen të dhëna dhe rastet e tjera të paidentifikuar fare në vite, për të cilat nuk përlllogaritet dot evazioni fiskal i shkaktuar nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk ka patur komunikim me ZVRPP Lezhë sot ASHK, Drejtoria Lezhë (përfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për të bashkëpunuar për arkëtimin e kësaj takse nga individët që tashmë kanë kryer legalizime dhe janë debitorë ndaj Bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 70-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të bashkëpunojë me Agjencinë e Shtetërore të Kadastrës Lezhë që të mos pajisen me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Lezhë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

8.2. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa për evidentimin e plotë të individëve të pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale që nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për gjithë periudhën kur ka filluar procesi i legalizimit si dhe arkëtimin e vlerës prej 8,128,383 lekë të taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) e pa shlyer nga 284 të cilët janë pajisur me leje legalizimi.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 896,803,545 lekë. Në këtë gjendje konstatohet se vlera prej 307,065,677 lekë e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore e përfshirë në këtë gjendje është e pasaktë, pasi sipas DTTV debitorët e biznesit dhe institucioneve në fund të vitit 2020 janë në vlerën 232,216,957 lekë. Pra kemi një mosrakordim të vlerave të kontabilizuara të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore.

Nga analiza e kësaj llogarie vihet re se, krahas debitorëve privat në shuma të konsiderueshme janë dhe debitorët e tjerë të krijuara para vitit 2015 të lëna si detyrime për ish-Komunat nga auditimi i jashtëm në vite, për të cilat nuk disponohet dokumentacion ose u ka kaluar koha e kërkimit për arkëtim, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim ligjor e kontabël për parashkrimin e tyre.

Vlera prej 896,803,545 lekë e debitorëve të akumuluar në fund të vitit 2020 është një vlerë e konsiderueshme, e cila kërkon një klasifikim të tyre në debitorë pa shpresë arkëtimi dhe debitorë të arkëtueshëm, ku për këto të fundit të merren masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi I “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik “pika 3.3“ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)nëpika 8 dhe i llogarive të klasës 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 80-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të saktësojë gjendjen debitorëve deri në fund të vitit 2022, të kryejë sistemimet kontabël dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2022

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën prej 19,407.775 lekë (kosto historike). Referuar analizës së llog. 202 “Studime dhe kërkime” rezulton se, në gjendjen e saj prej 38,396,671 lekë është përfshirë një vlerë prej 2,130,600 lekë e emërtuar studim-projektme gjendje nga viti 2009, për të cilën nuk disponohen të dhëna se për çfarë projekt-studimesh bëhet fjalë. Gjithashtu në këtë llogari janë përfshirë aktive jo materiale, të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie, pasi nga

përshkrimi i shpenzimit ato janë blerje shërbimesh apo mallrash. Pra kontabilizimi i këtyre transaksioneve financiare në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është i pasaktë, veprime kontabël këto të trashëguara nga vitet 2009-2010-2011, për të cilat në mungesë të dhënave e dokumentacionit nuk janë kryer veprime rregulluese në kontabilitet. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël), Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika “Aktivet afatgjata jo materiale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 80-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” të identifikojë vlerën prej 2,130,600 lekë e emërtuar studim-projektme nga viti e emërtuar studim-projektme nga viti 2009, të kryejë sistemimin kontabël dhe shpërndarjen e vlerave të projekteve sipas investimeve të kryera si dhe të kryejë sistemimet kontabël për aktivet e klasifikuara gabim në gjendjen e kësaj llogarie.

Brenda datës 31.12.2022

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 në të njëjtën vlerë prej 1,085,472,103 lekë (kosto historike)”. Referuar analizës së gjendjes të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 1,085,472,103 lekë në fund të vitit 2020, konstatohet se përfshihet një vlerë prej 1,050,872,186 lekë, e cila nuk është e detajuar dhe mungojnë të dhënat se çfarë përfaqëson.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në të njëjtën vlerë prej 56,275,100 lekë (kosto historike)”. Për këto aktive nuk është kryer inventar për verifikimin dhe krahasimin me inventarin kontabël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 84-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” të identifikojë vlerën prej 1,085,472,103 lekë e pa analizuar në fund të vitit 2020 dhe ta sistemojë atë.

Brenda datës 31.12.2022

11.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë inventar fizik të aktiveve të gjendje në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione”, duke i krahasuar me inventarin kontabël e cila në mbyllje të vitit 2020 paraqitet vlerën prej 56,275,100 lekë (kosto historike).

Brenda datës 31.12.2022

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 539,244,434 lekë. Kjo llogari nuk rakordon me llogarinë kundër parti në aktiv 468 “Debitorë të ndryshëm”, ku në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 896,803,545 lekë, vlera këto që nuk kanë të përfshirë vlerat debitorëve të krijuar gjatë vitit 2020. Pra gjendjet e llogarive 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” nuk paraqesin në mënyrë të plotë dhe reale detyrimet e të tretëve ndaj institucionit ose të drejtat e konstatuara. Gjithashtu në gjendjen e llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” përveç debitorëve për taksa e tarifa e detyrime të tjera nuk është përfshirë dhe vlera e gjendjes së debitorëve për tarifën e kopshteve dhe çerdheve, vlerë e cila është kontabilizuar gabimisht në llogarinë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, ku për vitin 2020 është në vlerën 163,428,730 lekë. Në llogarinë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse” evidentohen të ardhurat, që janë arkëtuar

përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 91-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të saktësojë gjendjet e llogarive 468 “Debitorë të ndryshëm”, 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” si dhe gjendjen e llogarisë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” në të cilën për vitin 2020 janë kontabilizuar gabimisht debitorët për tarifën e kopshteve dhe çerdheve në vlerën 163,428,730 lekë, duke kryer sistemimet kontabël.

Brenda datës 31.12.2022

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” paraqitet në mbyllje 2020 në vlerën e gabuar prej 21,573,666 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”, që është në vlerën 99.514.732,48 lekë. Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qenë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të përcaktuar të vitit ushtrimor raportues. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve të konstatuara në lidhje me detyrimet e shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit ushtrimor. Këto veprime t’i kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2020, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Brenda datës 31.12.2022

14. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 148 raste faturash me vlerë 291,355,037 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Lezhë, e ndarë 85 raste në vlerën 142,682,632 lekë janë kryer pagesa të vonuara në vitin 2020 dhe 63 raste në vlerën 148,672,405 lekë në vitin 2021, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh (mos realizim të ardhurash) ndërsa një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 97-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përgjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare. Në asnjë rast, njësia shpenzuese nuk duhet të raportojë në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, si detyrim të shtetit ndaj saj, shuma për të cilat ajo ka kryer prokurime, shpenzime apo investime, pa patur më parë fonde të siguruara nga granti buxhetor, donatorë të tjerë apo nga burimet e veta.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në 12 raste nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të prokurimit publik në Bashkinë Lezhë për periudhën 01.01.2018 deri më 30.09.2021, respektivisht për objektet:

- “Ndërtim i palestrës së shkollës "Nënë Tereza" Lezhë (faza II)”,
- “Rikonstruktion i rrugës Mylte, NjA Shënkoll”,
- “Mirëmbajtja, Sistemimi dhe Asfaltimi Rrugëve Rurale (rrugë komunale),

- “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh, Njësia Administrative Zejmen”,
 - “Ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat Pllane, Markatomaj, Zejmen, Spiten dhe Tresh, Nj. Ad. Zejmen Bashkia Lezhë (Loti II),
 - “Ndërtimi i ujësjellësit për zonat bregdetare të njësisë administrative Shënkoll,
 - “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”,
 - “Sistemim, asfaltim i bllokut në lagjen “Besëlidhja” tek DTT”,
 - “Sistemim asfaltim i rrugës “Azem Hajdari” Shëngjin”,
 - “Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Gramsh”,
 - “Rikonstruksion i shkollës së Mesme të Bashkuar , “Ishull Lezhë “ dhe ndërtim palestere, Maj 2019”,
 - “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “At Zef Pllumbi”, në kuadër të procesit të rindërtimit”,
- nga Njësia e Prokurimit janë vendosur kritere të veçanta për kualifikim të paargumentuara dhe jo të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, por pa shkaktuar ndikim në procesin e vlerësimit nga KVO. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20 si dhe neni 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” si dhe të rekomandimeve të APP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa që në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, të ngrejë Njësinë e Prokurimit me specialistë të fushë, që të kenë aftësinë profesionale për të përcaktuar kritere të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve në objektin shkolla e mesme e bashkuar “Karl Gega” Balldren për rehabilitim i ambienteve sportive dhe rikonstruksion i plotë të saj, lidhur nga Bashkia Lezhë, me subjektin BOE “4 A.” SHPK & “E. K.” SHPK me vlerë 74,181,004 lekë me TVSH, u konstatua lagështirë nga cilësia e dobët e punimeve të hidroizolimit me pasojë në zërat e punimeve suvatimi dhe lyrje të mureve të brendshme në ambientet e shkollës.

Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6807/3 prot., datë 02.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe BOE “4 A.” SHPK & “E. K.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë t’i kërkojë në zbatim të kontratës subjektit BOE “4 AM” SHPK& “E. K.” SHPK, eliminimin e lagështirës, riparimin e suvasë së dëmtuar dhe lyerjen e mureve të brendshme në objektin shkolla e mesme e bashkuar “Karl Gega” Balldren.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Furnizim me materiale për mirëmbajtje rrugësh dhe trotuaresh” me nr. Reference të prokurimit: REF-24546-05-30-2019, me fond limit 28,046,950 lekë, fituar nga OE “D. - A” SHPK, morën pjesë 3 OE, konkretisht: OE “S. S.-AL” SHPK pa ofertë; OE “D. - A” SHPK dhe OE “R. C.” SHPK.

KVO ka shpallur fitues OE “D.A” SHPK me ofertë anomalish të ulët dhe të pa argumentuar saktë dhe në mënyrë bindëse nga operatori ekonomik i shpallur fitues me vlerë të kontratës 19,356,096 lekë pa TVSH.

OE “R. C.” SHPK ka paraqitur ankesë në AK për mënyrën e vlerësimit nga KVO.

Titullari i AK ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona jo ekspert të fushës, komisioni i cili nuk ka kërkuar shpjegime mbi analizën e kostos

dhe mbi të gjitha e ka konsideruar të rregull edhe pse ky operator nuk ka paraqitur sqarim apo argument mbi kërkesat e kërkuara nga KVO. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu “X” “Shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor” pika 6 (a) dhe ngarkon me përgjegjësi, KSHA, KVO dhe ish Titullarin e AK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 162-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të ngrëjë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) për të shqyrtuar ankesat e nxjerrjen e vendimit për procedurat e prokurimit publik të përbërë nga 3 (tre) persona ekspert të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Tale 1 – Aske – Tale 2” Bashkia Lezhë, me vlerë 36,954,231 lekë me TVSH, fituar nga OE “A. I. G. C.” SHPK, u konstatuan se rruga në segmentin nga Pik 11 deri në Pik nr. 13, me gjatësi 400 ml dhe gjerësi 4.2 m, janë dëmtuar shtresat asfaltike (Binder me t= 5cm me vlerë 1,822,800 lekë dhe Asfaltobeton me t=3 cm me vlerë 1,367,520 si pasojë e lëvizjes së mjeteve të tonazhit të rëndë).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3984/3 prot., datë 27.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe OE “A. I. G.C.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 166 të Projektraportit të Auditimit).

18.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të kërkojë riparimin e rrugës së dëmtuar me vlerë 3,190,320 lekë nga OE “A. I.G.C.” SHPK, për punime të kryera pa cilësi në përputhje me specifikimet teknike në segmentin nga Pik 11 deri në Pik nr. 13, me gjatësi 400 ml dhe gjerësi 4.2 m sipas kontratës nr. 3984/3 prot., datë 27.06.2019.

Deri më datë 12.07.2022

19. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit e leje dhe dokumentacionit në drejtorinë e Urbanistikës të Bashkisë Lezhë për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, u konstatua se janë lëshuar gjithsej 76 leje ndërtimi. Grupi i KLSH-së, bazuar në risk dhe materialitet ka audituar 11 leje ndërtimi ose 15.49% të lejeve totale. Nga auditimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, u konstatuan disa problematika në drejtim të zbatimit të akteve ligjore e nënligjore të ligjit për Urbanistikën. Nga auditimi u konstatuan **15** problematika me shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

- Në **6 raste**, lejet e ndërtimit janë lëshuar në mungesë të dokumentit Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje, veprim ky në kundërshtim me VKM Nr. 1162, datë 24.12.2020.

- Në **4 raste**, lejet e ndërtimit janë lëshuar në mungesë të miratimit të projektit të zbatimit nga institucionet si ASHK dhe AKM, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” neni 15, germa (ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

- Në **5 raste**, lejet e ndërtimit janë lëshuar në kushtet e mosrespektimit të distancës nga objekti në kufirin e pronës si dhe distanca nga objekti në objekt, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 34, “Distancat minimale midis ndërtimeve”, neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 187-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandim: Nga DPZHT Bashkia Lezhë të merren masa konkrete për, mos lëshimin e lejeve të ndërtimit pa u pajisur fillimisht me Vërtetim për Riskun, dokumentet e miratuara nga AZHT dhe AKM, si dhe pa u zbatuar distancat nga objekti me kufirin e pronës si dhe

distanca nga objekti në objekt sipas nenit 34, të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “ Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2012 nga ish-Komuna Zejmen aktualisht NJA Zejmen janë lidhur 7 kontrata jashtë formatit tip të kontratës, me afat 30 vjet për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 58.49 ha nga fondi pyjor dhe kullësor, të cilave u mungon vlera të tarifës së qirasë, si dhe qëllimi i dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore. Nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqeje Bashkia nuk arkëton të ardhura, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë i cili është i pallogaritshëm.

Nga ish-komuna Kolsh dhe sot NJA Kolsh janë lidhur 8 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjor dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera si dhe vendosje antene. Nga këto 6 kontrata janë lidhur në vitet 2012-2013, me afat 10 vite dhe pa vlerë, duke sjellë të ardhura të munguar për Bashkinë Lezhë. Ndërsa 2 kontrata janë lidhur në vitin 2021 me afat 2 vjet, të cilat kanë likuiduar detyrimet kontraktore. Për të gjitha fermerët që kanë në përdorim parcela pyjore si për ato raste që u ka përfunduar afati dhe për ato kontrata akoma në fuqi, por nuk paguajnë nga Bashkia Lezhë nuk është kryer asnjë procedurë administrative apo ligjore për detyrimin e pagesës apo marrjen mbrapsht të parcelave, duke anuluar VKK apo kontratat. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve, me ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe me VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 74-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, të ngrejë një grup pune për verifikimin e parcelave nga fondi pyjor dhënë në përdorim nëpërmjet VKK apo kontratave individëve të ndryshëm, të bëjë saktësimin e të dhënave për sipërfaqet dhe të dhënave të tjera kadastrale, si dhe të identifikojë se për çfarë qëllimi përdoren. Të rishikojë akt-marrëveshjet dhe kontratat në fuqi dhe të negociohet për ndryshimin e kushteve nëpërmjet amendimit të kontratave fillestare. Për kontratat e përfunduara të kryhen veprimet për marrjen në dorëzim të parcelave pyjore, pas detyrimit të individëve, që i kanë patur në shfrytëzim dhe të kthimit të sipërfaqeve në gjendjen fillestare.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Lezhë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim *shpërblimin e dëmit në vlerën 3,235,680 lekë*, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së dhënies së lejes së ndërtimit për objektin “Kompleks banimi polifunksional 6 kate me një kat nëntoke” me zhvillues shoqërinë “J.” SHPK u konstatua se taksa mbi ndikimin në infrastrukturë sipas tabelës së paketës fiskale për vitin 2018 për koeficientin 6% në këtë situatë është llogaritur në vlerën në vlerën 56,460,475 lekë. Fatura e lëshuar nga ana e Bashkisë Lezhë është 55,678,520 lek, nuk është llogaritur saktë. Diferenca prej 781,955 lekë rezulton e ardhur e munguar për Bashkinë Lezhë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, neni 46 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” nga ndërtimet e reja si dhe paketës fiskale të miratuar nga bashkia për vitin përkatës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 172-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të marrë masat për arkëtimin e vlerës **781,955 lekë** nga shoqëria “J.” SHPK krijuar si rezultat i mospagimit të taksës mbi ndikimin në infrastrukturë, për objektin “Kompleks banimi polifunksional 6 kate me një kat nëntoke” Bashkia Lezhë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Asfaltim rruga Azem Hajdari” Bashkia Lezhë”, me vlerë 36,693,840 lekë me TVSH, fituar nga OE “A. K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume për zërat e punimeve: “Gërmim dheu me ekskavator 0.5 m3. në kanale me gjerësi > 2m, tok zak, kate. IV, në prezencë uji ~2m, me shkarkim në mjet”; “Transport dheu me auto deri 5.0 km” dhe “Mbushje me material të gërmuar në trupin”, në vlerën **189,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7929/3 prot datë 09.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe OE “A. K.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 147 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **189,000 lekë** pa TVSh nga OE “A.K.” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 7929/3 prot datë 09.08.2019 me objekt “Asfaltim rruga “Azem Hajdari” Lezhë”.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “At Zef Pllumbi” Bashkia Lezhë, me vlerë 220,376,980 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “N. C. 2012” ShPK & “A. - Group” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërat e punimeve: “Korimano metalike për ballkonet dhe shkallën e jashtme”, “Punime dyer dritare” “Fasadë xhami me profile alumini M4 termike me dopio xham me strukturë metalike mbajtëse”, “FV Brisole për vetratat”, në vlerën **393,860 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 23479/23 prot., datë 16.02.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe BOE “N. C. 2012” ShPK & “A. – G.” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **393,860 lekë** pa TVSh nga BOE “N. C. 2012” ShPK & “A. – G.” ShPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën nr. 23479/23 prot., datë 16.02.2021 me objekt “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “At Zef Pllumbi” Lezhë.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Mirëmbajta, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale” Bashkia Lezhë, me vlerë 252,515,250 lekë pa TVSH, fituar nga OE “P. G.” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërat e punimeve: “Mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës, përhapur dhe e ngjeshur me makineri”, “Mbushje gropa shtresë cakullit = 10 cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri”, në vlerën **563,556 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4970/3 prot., datë 24.03.2021 të lidhur mes Autoritetit

Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe OE “P. G.” ShPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 118-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **563,556** lekë pa TVSh nga OE “P. G.” ShPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën nr. 4970/3 prot., datë 24.03.2021 me objekt “Mirëmbajta, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale”, Bashkia Lezhë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Mylte, NjA Shënkoll”, Bashkia Lezhë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 39,536,680 lekë, fituar nga OE “K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 520,594 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9714/3 prot., datë 24.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë dhe OE “K.” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **520,594 lekë pa TVSh** nga OE “K.” SHPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën nr. 9714/3 prot., datë 24.12.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Mylte, NjA Shënkoll” Lezhë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Kotërr-Rraboshtë, segmenti Kotërr-Nenshat (L=1000 m) dhe segmenti Pirraj-Rraboshtë (L=2150 m)”, Bashkia Lezhë, me vlerë të kontratës (me TVSh) 46,099,540 lekë, fituar nga BOE “M.” SHPK & “N.S.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 608,565 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 12112/9 prot., datë 18.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë dhe BOE “M.” SHPK & “N. S.” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **608,565 lekë pa TVSh** nga BOE “M.” SHPK & “N.S.” SHPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën nr. 12112/9 prot., datë 18.09.2020, me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Kotër - Rraboshtë, segmenti Kotërr - Nenshat (L=1000 m) dhe segmenti Pirraj - Rraboshtë (L=2150 m)”, Lezhë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Dajç - Fshati Kotërr”, Bashkia Lezhë, me vlerë të kontratës (me TVSh) 29,396,869lekë, fituar nga BOE “S.” SHPK & “J.” SHPK & “D. - A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 178,150 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10132/3 prot., datë 17.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë dhe BOE “S.” SHPK & “J.” SHPK & “D. -A” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën prej **178,150 lekë pa TVSh** nga BOE “S.” SHPK & “J.” SHPK & “D. - A” SHPK, për punime të pakryera në cilësinë në kontratën nr. 10132/3 prot., datë 17.12.2018, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Dajç - Fshati Kotërr”, Lezhë.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME

EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit të ofertës (zërat me vlerë më të lartë) në objektin “Rikonstruksion i rrugës Mylte, NJA Shënkoll”, Bashkia Lezhë, rezultoi se për zërin e punës “Shtresë zhavorri lumi t=30 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, i përshkruar me Nr.an. 3.206, është marrë çmimi 507 lekë/m³, ose 194 lekë/m³ më shumë se çmimi i manualit të miratuar (çmimi sipas manualit 313 lekë/m³). Nisur nga fakti që është parashikuar volumi prej 7000 m³ (nga 8200 m³ i parashikuar në preventivin fillestar), rezulton që të jetë shtuar fondi limit në vlerën 1,358,000 lekë pa TVSH, vlerë që përfaqëson përdorim të fondeve pa economicitet (*Trajtuar më hollësisht në pikën 4 faqe 111-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e hartimit të DT, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, në mënyrë që të bëhet llogaritja e fondit limit sipas çmimeve të manualeve të miratuara. Për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin më me economicitet të fondeve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përlllogaritjes së fondit limit (zërave të preventivit) rezultoi se në 5 raste, çmimet e përcaktuara në preventivin e punimeve nuk janë sipas përcaktimeve të VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e konkretisht në procedurat e prokurimit:

- “Mirëmbajtja, Sistemimi dhe Asfaltimi rrugëve rurale (rrugë komunale)”, me urdhër prokurimi nr. 13, datë 13.05.2020, me fond limit 255,465,090 lekë, në 2 raste sipas preventivit, nga ku rezulton se preventivi është rritur me 871,360 lekë më shumë;
- “Ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat Pllane, Markatomaj, Zejmen, Spiten dhe Tresh, Njësia Administrative Loti II”, me urdhër prokurimi nr. 50, datë 24.12.2020, me fond limit 134,000,937 në 5 raste sipas preventivit, nga ku rezulton se preventivi është rritur me 1,022,885 lekë më shumë;
- “Ndërtimi i ujësjellësit për zonat bregdetare të njësisë administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë”, me urdhër prokurimi nr. 48, datë 11.12.2020, me fond limit 664,404,502 në 1 rast sipas preventivit, nga ku rezulton se preventivi është rritur me 1,900,483 lekë më shumë;
- “Rikonstruksion i shkollës së Mesme të Bashkuar , “Ishull Lezhe “ dhe ndërtim palestere, Maj 2019”, me urdhër prokurimi nr. 34, datë 09.05.2019, me fond limit 67,642,272 në 1 rast sipas preventivit, nga ku rezulton se preventivi është rritur me 6,939 lekë më shumë;
- “Sistemim asfaltim i rrugës Tale 1- Aske – Tale 2”, me urdhër prokurimi nr. 21, datë 18.04.2019, me fond limit 67,642,272 në 2 raste sipas preventivit, nga ku rezulton se preventivi është rritur me 214,208 lekë më shumë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 114-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e hartimit të DT, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, në mënyrë që të bëhet llogaritja e fondit limit sipas çmimeve të manualeve të miratuara. Për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin më me economicitet të fondeve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102; Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 93, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Lezhë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e të ardhurave të munguara **në vlerën 7,330,140 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë (periudhën 2018-2021), u konstatua se në disa raste nga Bashkia Lezhë nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë. Sipas të dhënave të nxjerra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit rezulton se, për 9 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, Bashkia Lezhë ka lëshuar autorizime kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës të vlerës prej 200,000 lekë, pra 1/5 e tarifës së miratuar për licencim (prej 1,000,000 lekë), duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë në shumën prej 7,200,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 69-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Bashkia Lezhë, të arkëtojë vlerën në total prej **7,200,000 lekë** të krijuar nga 9 subjekte (me emra dhe vlerën për secilin) si rezultat i mos aplikimit të tarifës së plotë të taksës për rinovim licence/autorizimi të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre për periudhën 2018-2021.

Menjëherë

2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 2 kontratave të lidhura ish-Komuna Zejmen në vitet 2013-2015 për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme dhe të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit u konstatua se 2 qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet e kontratës për 4 vite (2018-2021), në kundërshtim me kontratat nr. prot. 537, datë 23.04.2013 dhe nr.prot.1091, datë 05.05.2015 përkatëse të lidhura me pasojë **efektin negativ në vlerën 130,140 lekë** për buxhetin e Bashkisë Lezhë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 72-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Bashkia Lezhë të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore në vlerën 130,140 lekë nga dy qiramarrësit e parcelave pyjore Zef Nika në vlerën **108,000 lekë** dhe Gjergj Marashi në vlerën **22,140 lekë**.

Menjëherë

E. MASAT DISIPLINORE.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.

- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në mos zbatimin e disa zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike për kontratat për punë publike të audituara dhe të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të auditimit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi” i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, Pika 3.2.

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; geramat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Lezhë të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për punonjësit e atakuar.**

Titulli i gjetjes: Bashkia Lezhë nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.

Situata: KLSH me Vendimin nr.88, datë 02.06.2022, ka rekomanduar 34 masa gjithsej, nga këto 23 masa organizative, 7 masa për shpërblim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 2 masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë, masat disiplinore janë lënë që të merren nga ana e Kryetarit të Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga KLSH. Nga verifikimi, konstatohet se me urdhrin nr. 351 prot., datë 10.06.2022, Kryetari i Bashkisë Lezhë ka ngritur grupin e punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk është zbatuar asnjë prej rekomandimeve.

Niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 23 masa organizative të rekomanduara, nuk janë zbatuar 23.

-Nga 7 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara, nuk janë zbatuar 7.

-Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara, nuk janë zbatuar 2.

-Nga 2 masa lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë, masat disiplinore janë lënë që të merren nga ana e Kryetarit të Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga KLSH, nuk janë zbatuar 2.

- Bashkia Lezhë, nuk ka respektuar afatet 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes në KLSH për zbatimin e rekomandimeve dhe mbi ecurinë e zbatimit të tyre, ende nuk ka asnjë korrespondencë për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me nenet 15 germa “j” dhe 30 pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- Bashkia Lezhë, nuk ka respektuar afatet 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes në KLSH për zbatimin e rekomandimeve.

- Bashkia Lezhë, nuk ka vepruar për zbatimin e rekomandimeve.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.

Ndikimi/efekti: Në përmirësimin e punës së Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Bashkia Lezhë nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

2.2. Auditim mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

2.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Infrimi dhe komonikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

2.2. Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

2.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Lezhë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Lezhë nuk ka Kod të Etikës, por në nenet 12 dhe 13 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë 17 rregulla të etikës, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojnë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregullore, ku një rregullore me datë 10.01.2020 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit në Bashkinë Lezhë” dhe me datë 29.11.2021 “Rregullore për hartimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”. Në Rregulloren e Brendshme në nenin 13 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Për shkeljet e administrative në lidhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik” në nenin 90 të Rregullores së Brendshme janë parashikuar përgjegjësia administrative dhe sanksionet. Për çdo vit është hartuar raporti i Njesisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me shkresat përkatëse, depozituar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e protokoll-arkivit), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, në strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat, strukturë e cila nuk është përcaktuar. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 31 të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat e dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6-mujore. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njesisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitet e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UK sha Lezhë, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen këshillit drejtues, pasi bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet

kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Lezhë me Vendimin e Kryetarit nr.209 datë 23.05.2018.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rrumbullakëta me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjuesat me publikun.

- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë.

- Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi për ndonjë funksion të ndryshuar apo të shtuar pranë Drejtorive mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë si: për Sektorin e Menaxhimit të Aseteve shtuar pranë Drejtorisë Juridike, ku në rregullore detyrat e pjeshme janë përcaktuar tek detyrat e tre specialistëve: i mjedisit, i pronave dhe i hartografisë pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve. Mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës Mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT.

- Mungojnë plan veprimet për menaxhimin financiar për periudhën objekt auditimi, viti 2021 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhej të përfshiheshin, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organograma e Bashkisë Lezhë është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 3 nën/Kryetarët dhe 11 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me 9 Administratorët e NJA e 5 Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në linjë horizontale, ndërsa nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori e specialistët llogaridhënia është në linjë vertikale.

Për vitin 2021 me Vendim të Kryetarit nr. 157 datë 06.04.2021“Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve organizative të Bashkisë Lezhë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2021” i ndryshuar me VKB nr. 401 datë 15.10.2021, me VKB nr. 459, datë 17.11.2021 me 756 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti, 14 Drejtori, 32 Sektorë, Klubi i Sportit dhe 9 NJA.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën

drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Lezhë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Në 3 raste të testuar të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Lezhë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila t’i dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojnë të dhënat për trajnime jashtë institucionit).

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. NA për çdo vit kanë nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcaktonse “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “ Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Në Rregulloren e Brendshme në pikën (5.2) të nenit 5 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore ”Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS. Per vitin 2021 për hartimin e PBA 2021-2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 20 anëtarë (1 anëtar pa të drejt vote) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 29 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.01, datë 06.01.2020.

Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS),për të cilin nuk përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk e kryer detyrat si:

- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

I. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Lezhë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësive të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Lezhë. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtura Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Lezhë ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por jo për të gjitha Drejtoritë janë evidentuar risqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut ,ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në

arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “ Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Lezhë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së sajka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t’i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

I. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “ Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohendhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte te zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë(NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 12 punonjës, 1 drejtor, 2përgjegjës Sektori.

- Për prokurimetnga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimitkomisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në nenet37-41 të Rregullores së Brendshme.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme në nenin 33 “Specialisti i Arshivës,” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohetdhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e drejtorisë Ekonomike nenet 43-49, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Lezhë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT, funksion i cili është i Sektorit të Programeve të Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës pranë Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës. Sipas të dhënave të siguruara nëpërmjet intervistës së bërë me specialistin e IT rezultojnë se ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterët e bashkisë. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, firewall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Lezhë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk kaplan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

- Në nenet 37-41 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

- Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transportit, Infrastrukturës dhe Mjedisit. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive në nenet 60 dhe 61 të rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësitë e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilzimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtoria. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditimi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtuesit në Bashkinë Lezhë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak. - Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetuar në fund të vitit 2021 është në vlerën 273,628 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

-Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Lezhë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program Excel dhe me program kontabiliteti “Alfa”, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Lezhë për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Ujësjiellësi, DRT, AKSHetj. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumente financiare dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrje jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 6 “Informimi publik”, neni 7 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së Bashkisë, neni 8 “Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak”, neni 9 “ Marrëdhëniet me institucionet e tjera” neni 10 “Bashkëpunimi me Njësitë e tjera të Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 “Marrëdhëniet me publikun, transparenca e njësive të vetëqeverisjes vendore”. Në rregulloren e brendshme në nenin 15 janë përcaktuar procedurat e komunikimit me median.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohet çdo 3 muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Lezhë janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë

informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Lezhë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

I. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave, , për vitin 2021 me shkresën nr.prot.2561, datë 27.02.2022, e cila i është dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Lezhë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Lezhë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Bashkinë Lezhë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën objekt auditimi
	<p>Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:</p> <p>“Mjedisi i kontrollit”</p> <p>-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e</p>

<p>Situata:</p>	<p>riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës “Sektorin e Menaxhimit të Aseteve”, “Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës” dhe të specialistit të IT. “Menaxhimi i Riskut”.</p> <p>Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimit e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.</p> <p>“Aktivitetet e Kontrollit”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Lezhë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB. <p>“Informimi dhe komunikimi”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. <p>“Monitorimi”- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.</p>
	<p>Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e</p>

Kriteri:	Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 dhe me Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Lezhë, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr.209 datë 23.05.2018.
Ndikimi / Efekti:	Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Shkaku:	Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.
Rëndësia:	<i>I mesëm</i>
Rekomandim:	Nga Titullari i Bashkisë Lezhë, të merren masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhet përmirësimi rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

➤ **Organizimi dhe Funkcionimi :** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik”, Bashkia Lezhe, ka ngritur NJAB. Për vitin 2021 NJAB me 1 drejtues dhe 2 punonjës, sipas strukturës organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me Vendimin nr. 901 datë 24.12.2020.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Administratës së Bashkisë Lezhe të miratuar me Vendimin e Titullarit nr.209 datë 23.05.2018 si edhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të NJAB të përcaktuar me shkresën nr.prot.15845 datë 18.09.2020.Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, pervoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

- Struktura e NJAB për vitin 2021 e në vazhdim paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Data e filimit	Pozicioni	Niveli i arsimit
1	B. Gj.	19.12.2019	Përgjegjës	UT, Dega Ekonomist per Industri
2	P. F.	13.01.2017	Audit	U Shkoder ega Finance
3	F. D.	01.03.2017	Audit	UT, fakulteti i Drejtesise

➤ **Komiteti i Auditit të Brendshëm:** Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se:“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshilldhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
- ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Financave.

➤ **Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik**

NJAB ne mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik” në Bashkinë Lezhë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.21, datë 06.02.2018.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentit “Karta e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik” konstatohet se nuk i përmbahet strukturës së përcaktuar në Formatin Standart 1 “Modeli i Kartës së Auditimit të Brendshëm” të kapitullit II të MAB i miratuar me urdhër të Ministrisë të Financave nr.100/2016, i nryshuar, pasi mungojnë në strukturë pjesa ku përshkruhet:

-Plani i auditimit të brendshëm

-Raportimi dhe monitorimi

-Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit.

Nuk është bërë përditësimi me strukturën e re të NJAB me 1 përgjegjës dhe 2 auditues të miratuar me Vendimin nr. 901 datë 24.12.2020 tek pjesa e statusit organizativ, e cila përkon me strukturën e vjetër me 1 përgjegjës dhe 4 inspektorë.

➤ **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikështë hartuar dhe miratuar plani strategjik:

Për vitin 2021 me shkresën nr.16377/1, datë 13.10.2021 është miratuar plani strategjik për vitet 2022 – 2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- **Konkluzion:** Nga vlerësimi i planeve strategjike dhe planeve vjetore të auditimit konstatohet se, NJAB nuk administron të plotësuar formatet nr.1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit” dhe nr.2 “Pyetësor për Planin Strategjik” si pjesë e procesit të planifikimit fillestar dhe për të kuptuar e vlerësuar riskun. Në këto plane nuk janë përfshirë dhe programuar për auditim për çdo vit subjektet, ku sistemet e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar me risk të lartë. NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve, konkretisht: - Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve e planifikuar në planin strategjik 2019-2021 dhe program auditimi në maj 2019, vlerësuar me risk të lartë, periudha e auditimit është përcaktuar 01.11.2017-30.04.2019 (pra mbi 1 vit.)

- Mospërfshirja në procesin e auditimit për periudhë deri 1 vit i subjekteve të vlerësuara me risk të lartë, të cilat NJAB ka detyrim për auditim është në kundërshtim me MAB pika 3.1.3

në të cilën përcaktohet se: “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t’u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet.”.

➤ **Realizimi i Planit Vjetor:**

Për vitin 2021 janë parashikuar gjithsej 16 auditime në Drejtori dhe NJA, ku sipas llojit janë 15 të përputhshmërisë dhe 1 të kombinuar. Sipas faktit janë realizuar 11 auditime, ku vetëm në 6 auditime është respektuar plani i angazhimeve vjetore, 1 auditim është kryer me kërkesë të Titullarit, 4 auditime të tjera janë zbatim rekomandimesh. Planin e angazhimeve në fillim të vitit nuk përputhet me realizimin e auditimeve në fakt si për nga numri, objekti dhe lloji. Planin e angazhimeve vjetore është realizuar në masën 33%. Për ndryshimet e ndodhura në lidhje me numrin, objektin e auditimit dhe për auditimet e shtuar me kërkesë të Titullarit, si dhe mosrealizimin e auditimeve në 10 subjekte të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi nga titullari i tij. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2021 paraqitet në tabelën e Aneksëve.

➤ **Gjetje-Rekomandimet**

- Për vitin 2021 nga auditimet janë evidentuar 36 gjetje, për të cilat janë dhënë 36 rekomandime të karakterit organizativ, ku nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve janë në proces zbatimi 36 rekomandime.
- Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB ka patur komunikim shkresor me njesitë e audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhes është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm është audituar nga Drejtorja e Harmonizimit të A.B pranë MFE -së vitin 2021 për aktivitetin e kësaj njësie për vitin 2019-2020, duke bërë vlerësimin e jashtëm të cilësisë të kësaj njësie.
- Drejtorja e A.B ka reflektuar dhe përmirësuar praktikën audituese nga rekomandimet e dhëna nga NJQHAB nga muaji nëntor 2021, këtë fakt e konfirmon dhe plan veprimi i këtij auditimi dhe komunikimi me këtë njesi qëndrore.

➤ **Raportimi:** Për veprimtarinë e NJAB të Bashkisë Lezhë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2021 me shkresën nr.prot 423, datë 27.02.2022.

Konkluzion: Për periudhën 2021 nga shqyrtimi i dokumentacionit të planifikimit dhe raportimit rezultoi se, në Planin Strategjik në përmbajtjen e tyre, mungojnë objektivat strategjikë, gjithashtu nuk është bërë përshkrimi i numrit të subjekteve që NJAB ka detyrimin për auditim si dhe identifikimin e fushave dhe sistemeve prioritare. Ndërsa në Planin vjetor mungonin rubrikat: zhvillimet aktuale të NJAB, prioritetet e auditimit për vitin, objektivat kryesore për vitin dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë. Planin e angazhimeve në fillim të vitit nuk përputhet me realizimin e auditimeve në fakt dhe llojin e auditimit. Pra realizimi i planit paraqitet në nivele të ulëta rreth 40%. NJAB nuk ka bërë një raportim të qartë dhe të saktë të numrit të angazhimeve të realizuar kundrejt planifikimit. Për ndryshimet e ndodhura në lidhje me objektin e auditimit në subjekte, për kërkesat e titullarit për auditime të pa planifikuara si dhe për mosrealizimin e auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi i tij nga titullari.

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2021 dosjet: Drejtoria Emergjencave Civile, Drejtoria e Bujqësisë, NJA Blinisht, NJA Kallmet, NJA Shengjin, Zbatim Rekomandimesh (Drejtoria Juridike), Zbatim rekomandimesh drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria Finances dhe Kontabilitetit (Magazina).

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;
b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;
c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i dryshuar me Urdhërin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm” pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, kështu:

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon Memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pratë kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe ;
- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe Formatin e përgjithshëm të riskut;
- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet, përlllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.
- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.
- Eksperienca dhe numri i audituesve;
- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;
- Kohëzgjatja (ose afatet kohore);
- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;
- Masat për sigurimin e cilësisë;

- Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë rregjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit. Dokumentet e punës audituese duhet të rregjistrojnë :

- Emrin e organizatës që auditohet;
- Sistemin/fushën që auditohet;
- Periudhën që mbulon ky auditim;
- Personin që kryen auditimin dhe datën e fillimit të punës;
- Testet individuale të audituesve;
- Personin që bën rishikimin e punës audituese dhe datën kur bëhet rishikimi;
- Një numër të veçantë reference për letrat e punës;
- Detajet e punës që është bërë, për shembull, objektivat dhe metodat;
- Rezultatet e punës; (gjetjet dhe rekomandimet); dhe
- Konkluzionet e nxjerra.

- Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07,2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.

- Llojet e shërbimit të sigurisë të përcaktuara në Programet e Angazhimit, nuk janë të njëjta me misionet e auditimit të planifikuara nga NjAB në planet vjetore dhe me ato të raportuar në Raportin Vjetor. Në programe mungojnë metodat e auditimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të angazhimit.

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky I nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

- Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Procedura e vlerësimit të brendshëm për çdo program angazhimi nuk kryhej, pasi nuk dokumentohej në asnjë nga dosjet e shqyrtuara, duke mos realizuar sigurimi i brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese. Pyetësi i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetësi nuk kthehej i plotësuar dhe nuk gjendej si pjesë e inventarit të çdo dosjeje. Në porogramin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Procesi i vetëvlerësimit periodik sipas MAB përfshin:

- Mbikëqyrjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm
- Përfundimin e listës së kontrolleve të përshkruara;
- Përpilimin e feedback-ut nga subjekti i audituar dhe palët e tjera të interesuara përmes
- intervistave dhe sondazheve;
- Përzgjedhjen e dokumenteve të punës për t’u rishikuar nga auditues të brendshëm që nuk kanë qenë përfshirë në atë angazhim auditimi;
- Rishikimin e projekt buxhetit, e afateve kohore dhe përfundimin e planit të auditimit;
- Analiza e performancës (për shembull; afati kohor dhe rekomandimet e dhëna dhe të pranuar);
- Referimi i praktikave aktuale të NjAB me praktikat më të mira të auditimit të brendshëm.

- Në programe dhe në raportet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim i vecantë e për pasojë nuk është bërë trajtimi si çështje më vete vlerësimi dhe analizimi e komponenteve të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinionin i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk ka dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kritereve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët). Opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë present si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi.

- Nga shqyrtimi i Raporteve evidentohet se, raportet për periudhen 3-mujori i katërt të vitit 2021 nuk janë në përputhje me formatin e ri të raportimit, sipas Urdhrit të Ministrit të MFE

nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016. Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime. Opinionin e përgjithshëm mbi funksionimin dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve të audituar nuk e kanë paraqitur në përmbledhjen ekzekutive.

- NjAB në fund të projektraportit dhe raportit final Subjekti i audituar ka bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet ligjore (e drejta e paraqitjes së observacioneve, reagimi në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në Projektraport, brenda 10 ditëve nga mbritja e Projektit dhe detyrimi i plotësimit dhe përcjelljes së planveprimit brenda periudhës 30 ditore nga marrja e Raportit) që ka ndaj grupit të auditimit, por në shkresat përcjellëse ato nuk janë evidentuar. Në disa raste nuk është përcaktuar saktë afati ligjor i kthimit të projekt-raportit, ku është përcaktuar afati i gabuar “brenda 5-ditëve” dhe në paraqitjen e plan-veprimeve është përcaktuar afati i gabuar “brenda 20-ditëve. Në disa praktika nuk administrohet shkresë përcjellëse e raporteve finale ose të projekt-raportit (si p.sh. misioni i anagazhimit pranë Drejtorisë së Financës dhe pranë Drejtorisë Juridike) në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 12, shkronja “d”, në shkresën përcjellëse të Raportit Final, dhe pikës 4.1.11 dhe 4.1.12 të MAB. Subjektin të audituar nuk i është kërkuar dërgimi pranë DAB Plani i Veprimit i miratuar, si dhe raportimi në mënyrë periodike mbi progresin e bërë për zbatimin e tyre.

- Projektrapoti i përcjellë subjektin të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

- Në të gjitha dosjet nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektin të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

- Në raporte është përfshirë rubrika “Masa Disiplinore”, duke u shprehur nëse rekomandojmë apo jo masa disiplinore edhe pse në fakt nuk janë rekomanduar masa disiplinore. Kjo rubrikë nuk duhet të jetë pjesë e raportit final apo e shkresave përcjellëse përkatëse, pasi është jashtë kompetencave NjAB sipas kuadrit ligjor në fushën e auditimit të brendshëm dhe standarteve të auditimit në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 16 pika (e). Nivelin, shkallën dhe llojin e masë disiplinore për çdo punonjës sipas Kodit të punës dhe ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil e përcakton eprori i drejtëpërdrejtë i punonjësit për të cilin auditimi i brendshëm ka dhënë opinionin dhe ka vlerësuar mos përmbushjen me korrektësi e saktësi të detyrave ligjore e funksionale, pasi dhënia e masa vedisiplinore është kompetencë e titullarit në bazë të ligjit për Shërbimin .

- Raportet nuk janë koncize në përmbajtjen e tyre ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të panevojshme, ka përshkrime të gjata, të tepërta, të detajuara dhe të parëndësishme që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinionin apo vlerësim përfundimtar.

- Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhen e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”

- Për vitin objekt auditimi nga NjAB është hartuar memo mbi gjetjet dhe konkluzionet, dokument i cili nuk faktin nëse është përcjelle tek Kryetari i Bashkisë. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Memove rezulton se janë tejet të gjata dhe nuk janë një përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar, nuk është e qartë se kur është dërguar titullarit para apo pas plan-veprimit të dërguar nga subjekti i audituar, nuk paraqet konkluzionet dhe rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituar, por vetëm gjetjet dhe rekomandimet e adresuara, si dhe i

mungon dhënia e opinionit mbi vlersimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

- Në verifikimin e kryer në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre.

- Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me me prioritet të lartë rrisht si: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin administrim dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare etj.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara në organizimin, funksionimin dhe aktivitetin e Auditit të Brendshëm.
Situata:	Dokumenti “Karta e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik” konstatohet se, nuk i përmbahet strukturës së përcaktuar në Formatin Standart 1 “Modeli i Kartës së Auditimit të Brendshëm”; Realizimi i planit nëkatër vitet është në masa të ulëta , gjë e cila nuk është e argumentuar. Për ndryshimet e ndodhura në lidhje me objektin e auditimit, llojet e auditimit, shtesat e auditimeve jashtë planit me kërkesë të Titullarit, si dhe për mosrealizimin e auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi nga titullari i tij, pasi raportimi i realizimit të angazhimeve të auditimi nuk përputhet me planin. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij;Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave për secilin anëtar të grupit të punës. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet. Raportet per vitin 2021 nuk janë në përputhje me formatin e ri të raportimit, nuk janë koncize duke përfshirë rubrika e përshkrime të panevojshme. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është e karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi. Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Projektrapoti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve; Pyetësori i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar. Mungojnë letrat e punës për secilin auditues;Në

	<p>shkresat përcjellëse të Projektraporteve dhe Raporteve, nuk është bërë me dije subjekti i audituar, mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore ndaj NJAB, por dhe kur janë vendosur afatet në fund të Projekt-raportit dhe Raportit Final janë vendosur jo sipas fateve ligjore të përcaktuara. Nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar. për periudhën objekt auditimi nga NJAB është hartuar Memo pa adresim mbi gjetjet dhe konkluzionet, dokument i cili nuk vërteton faktin nëse është përcjellë tek Kryetari i Bashkisë; Në auditimet e kryera për zbatim të rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit, dhe nuk përcaktohen masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë rrisku si: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin administrim dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare etj. Procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej, pasi nuk dokumentohej në asnjë nga dosjet e shqyrtuara me plotësimin e anekseve “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik”, duke mos realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese.</p>
Kriteri:	<p>Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm “pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”</p>
Ndikimi /Efekti:	<p>Mosrealizim dhe sigurim të cilësisë së veprimtarisë audituese të Auditit të Brendshëm.</p>
Shkaku:	<p>Mos ekzistenca e një stafi profesional të NJAB dhe realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuar.</p>
Rëndësia:	<p><i>I mesëm</i></p>
Rekomandim:	<p>Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve dhe formulimit</p>

	konkret të rekomandimeve, duke përcaktuar afatet e realizimit. NjAB të kryeje vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të kryhet një planifikim i auditimeve efektiv dhe i realizueshëm. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari, që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektive, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.
--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

2.3. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

3.1. Programimi i PBA dhe buxhetit vjetor për vitin 2021.

3.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve, bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

3.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

3.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve. (Faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me nr fature dhe datë krijimi sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë e linjës, etj)

3.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për auditimin e këtij drejtimi auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dokumenti i hartimit të PBA-së 2021-2023 dhe miratimi i tij dhe gjithë korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

-Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2021 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.

-Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Lezhë për shpenzimet dhe të ardhurat.

-Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.

-Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021.

-Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet dhe të ardhurat, etj).

-Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA-së dhe programimit të buxheteve vjetore

Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesëm

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së 2021-2023 rezultoi se, për realizimin e fazave të përgatitjes kanë dalë vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së e buxhetit vjetor dhe Urdhërat Titullarit të Institucionit për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP), dhe këto dokumente janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Urdhërat e Titullarit për ngritjen e GMS dhe EMP sipas viteve janë :

-Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2021;

Për vitin 2021 është miratuar Kalendarit i Përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit Vjetor me vendimin e këshillit bashkiak nr.124 , datë 26.12.2019.

Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e Grupit i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipit të Mena-xhimit të Programeve ;

Për vitin 2021, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 20 anëtarë (1 anëtar pa të drejtë vote) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 29 programe buxhetore sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.01, datë 06.01.2020.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak në fazën e parë të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat.

-Hartimi i PBA-së dhe Buxhetit Vjetor i përgatitur është miratuar në këshillin bashkiak në tre faza, faza e parë në muajin Qershor, faza e dytë në muajin shtator dhe faza e tretë në muajin dhjetor.

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA 2021-2023 rezultoi se, janë respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 27, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023".

Në këtë program risi është futja e Instrumentit të planifikimit financiar i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e konomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

Në dokumentin e PBA janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA 2021-2022-2023.

Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga Ministritë e linjës.

Për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetin vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollat përkatëse. Buxhetinuk është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrja e shërbimeve dhe ujesjellësi, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohet buxheti.

Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat etj. Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresat përkatëse.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje".

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2021

Për vitin 2021, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr.172, datë 2.11.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.1072/1, datë 14.12.2020, konkretisht pasqyra:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i viti 2021	
		Të Ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës	0	

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2021	
		Të Ardhurat	Shpenzime
2	Transferta pakush. trashëg.viti paraardhës	0	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	0	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	780,015	
5	Transferta e pakushtëzuar	329,841	
6	Transferta specifike	218,028	
7	Transferta e Kushtëzuar	91,755	
8	Paga (600)		437,571
9	Sigurime shoqërore (601)		73,073
10	Shpenzime operative (602)		381,469
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		9,992
12	Inv (230 +231) Të ardhurat e Tr. Pakush.		388,007
13	Investime nga FZhShdhe Min.e Linjës		91,755
14	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)		37,772
Totali i buxhetit		1,419,639	1,419,639

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2021 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, konkretisht:

- të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,419,639 lekë.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA-ja 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhur, grant i pakush. e spec.)	510,644	494,416	+ 16,228
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	429,233	396,975	+ 32,258
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	388,007	329,834	+58,173
4	Investime nga FZhSh	91,755	91,755	0
Total i planit fillestar		1,419,639	1,312,980	+ 106,659
Shtesat nga Pushteti Qendror		0	0	0
1	Investime grant i kushtëzuar	0	0	0
2	Shpenzime për pagat (600+601)	0	0	0
3	Shpenzime (602.604.609)	0	0	0
<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>		<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
Gjithsej		1,419,639	1,312,980	+ 106,659

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Në planin e buxhetit 2021, në krahasim me PBA 2021-2023, ka diferencë për shumën +106,659 mijë lekë, të cilat vijnë si rezultat i rritjes së të ardhurave vendore dhe grantit specifik në raport me para-shikimin e bërë në PBA-në 2021-2023. Shpenzimet për paga e sigurime janë rritur nga tavani i miratuar, si rezultat i rritjes së numrit të punonjës dhe nivelit të pagave në sektorin e arsimit (sipas VKM) në raport me parashikimin e bërë në PBA. Shpenzimet për artikullin 602 “mallra e shërbime” janë rritur për të mudësuar edhe likuidimin e detyrimeve kreditore të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme, ku një një pjesë tyre janë parashikuar të likujdohen gjatë këtij viti. Fondet e kushtëzuara nuk janë paraqitur pasi janë pjesë e PBA-së së Pushtetit Qendror.

- **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Lezhë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në

periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Lezhë. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Lezhë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, investime, QKB, shpërblime lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të Këshillit Bashkiak, e përcaktuar kjo në ligjin për buxhetin dhe udhëzimin e MFE.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak Lezhë.

Konkluzion: Referuar tabelës që paraqet vendimet për shtesat dhe pakësimet e kryera në buxhet gjatë vitit buxhetor, konstatojmë se janë kryer ndryshime të vazhdueshme për vitin 2021 janë bërë 52 ndryshime, nga të cilat 29 ndryshime janë reflektuar me VKB dhe 23 me Vendim Kryetari, të cilat tregojnë për planifikime optimiste, që nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve gjatë vitit ushtrimor, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit vjetor është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lezhë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Lezhë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendime të Këshillit Bashkiak, ose të diktuar nga Transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit, me rritjen e limit nga të ardhurat e realizuara. U konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	%
1	Paga 600	461,913.5	419,367.0	90.8
2	Sigurime shoqërore 601	76,861.9	69,169.6	90.0
3	Shp.Oper.602+F.Rezervë	517,155.4	365,760.2	70.7
4	Kredia+Interesi 166-651	11,425.8	11,186.2	97.9

Nr	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	%
4	K. Q Emergj Civile 604	17,968.0	3,798.7	21.1
5	Nd/Ekonom invalid 606	1,189,053.6	977,174.0	82.2
6	Mjete ne ruajtje 466	11,793.1	11,793.1	100
7	Investime 230-231	1,624,878.3	1,172,122.0	72.1
	Totali	3,911,049.6	3,030,370.8	77.5

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2021** janë realizuar 3,030,371 mijë lekë, nga 3,911,050 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.5%, kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Lezhë, si edhe në realizimin në këtë nivel ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

- a. Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 70.7%.
- b. Shpenzimet për investime llog.231 janë realizuar në masën 72.1%.

Këto mosrealizime kanë ardhur si rezultat i vonesave në prokurime dhe në lidhjen e kontratave, ose mosrealizime të të ardhurave të planifikuara, gjë që ka sjellë lënien e likujdimeve në fund të vitit, duke i bllokuar veprimet edhe nga MFE.

Konkluzion: Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

Miratimi i realizimit faktik të buxhetit.

Në fund të periudhave ushtrimore Bashkia Lezhë ka miratuar buxhetin faktik vjetor. Gjithashtu janë paraqitur dhe miratuar edhe buxhetet faktike përçdo 4 mujor, si dhe janë paraqitur informacionet mujore në këshill, për ecurinë e zbatimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor. Buxhetet faktike janë miratuar së bashku me analizat faktoriale për realizimin e fondeve, ku janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Këto veprime janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Kreu IX, neni 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, pika 4.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe i kontigjencës, konkretisht:

-Për **vitin 2021**, është miratuar në vlerën 9,992 mijë lekë, nga e cila: përdorur vlera 4,283.7 lekë, këto:

- për investime 1,477.2 mijë lekë.
- për mbulim shpenzime varrimi 416.5 mijë lekë.
- për mbulim shpenzime kadastrale 1,000 mijë lekë.
- për dhënie ndihma financiare të individëve në nevojë 240 mijë lekë.
- për dhënie ndihma ekonomike të familjeve në nevojë 1,150 mijë lekë.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikoje procedurat

e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të pa likujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2021, janë planifikuar dhe shlyer edhe detyrimet për fatura të pa likujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZSHH, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e papaguara të trashëguara nga vitet e kaluara në fund të vitit 2020 janë në vlerën 306,308,894 lekë dhe është planifikuar në buxhet vlera 118,000,000 lekë, për likuidimin pjesor të tyre.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, për vitin 2021 sipas llojit të detyrimit të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2021:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2020/lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2021/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021
					lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	113,767,429	68,407,510	182,174,939	96,844,454	85,330,485
Investime nga FZSHH	0		0		0
Mallra dhe shërbime	64,224,118	80,028,771	144,252,889	83,004,807	61,248,082
Vendime gjyqësore	2,290,260		2,290,260	1,268,096	1,022,164
Të tjera- shpronësime	126,027,087		126,027,087		126,027,087
Totali :	306,308,894	148,436,281	454,745,175	181,117,357	273,627,818

Burimi: Nga të dhënat sipas shkresave dërguar MFE.

Referuar shkresës nr.prot.1505/1 datë 18.03.2021 dhe shkresës nr.prot. 2125, datë 17.02.2022 të Bashkisë Lezhë dërguar në MFE të raportimit të detyrimeve të prapambetura për vitin 2020 dhe 2021 paraqitur në tabelën e mësipërme rezulton se detyrimet në mbyllje të vitit 2020 janë në shumën **306,308,894** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 janë në shumën **273,627,818** lekë. Pjesë e këtyre detyrimeve është edhe vlera e shpronësimeve prej 126,027,087 lekë, e krijuar para vitit 2018, vlerë e cila është evidentuar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, për të cilën ekziston një listë e emrave të individëve, por nuk disponohet dokumentacion ligjor për mbështetjen e këtyre shifrave. Analiza e detyrimeve për shpronësimet sipas objekteve dhe individëve privat paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Evidenca e shpronësimeve publike (detyrimi deri 31.12.2021)

Nr	Pershkrimi I objektit	Emer Mbiemer	Detyrimi Vlera Leke	Likujdimi			Detyrimi mbetur 2021
				2017	2018	2019	
1	Blloku 11.2 Ha Lagjia Beselidhja	M.D.	10,739,262	9,751,976	-	-	987,286
2	As.Rruga Koder Marlekaj	21 persona	5,844,588			5,274,351	570,237
3	Shpronësim tek Bregu I Drinit	17 persona	64,564,293				64,564,293
4	Shpronësim tek 11.2 Ha	4 persona	30,102,826	560,000	560,000		28,982,826
5	Shpronësim Rruga Kune, Shengjin	6 persona	2,688,556				2,688,556
6	Blloku 11.2 Ha Lagjia Beselidhja	11 persona	5,061,500				5,061,500
7	Rikonstrukcion Lagjia Skenderbeg	K.P.	546,642				546,642
8	Rruga Kune Shengjin	P.M.	961,800				961,800
9	Blloku 11.2 Ha Lagjia Beselidhja	Gj.N.	21,740,000				21,740,000
Totali			142,249,467	10,311,976	560,000	5,274,351	6,103,140

Në raportime nuk janë përfshirë detyrimet prapambetura për investime të pa financuara nga Ministrinë e linjës, pasi edhe operatorët ekonomikë që janë sipërmarrës të punimeve, pavarësisht se kanë përfunduar punimet në objektet e investimit, faturat i kanë prerë dhe sjellë pranë Bashkisë për likuidim në momentin e akordimit të fondeve nga pushteti qendror. Faturimi i situacioneve të punimeve me vonesë nga sipërmarrësi i punimeve është bërë për efekt të pagesës së TVSH-ës nga faturuesi në momentin kur lëvrohen fondet nga investitori. Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që, në fund të vitit 2021 janë të pa likujduara gjithsej **22** fatura me vlerë **239,992,868 lekë** dhe 23 fatura në vlerën 33,634,950 lekë, që i përkasin detyrimeve trashëguara në vitin 2015 nga ish-Komunat, të cilat janë krijuar nga viti 2015 e para tij. Për vlerën 33,634,950 lekë të detyrimeve të trashëguara nga ish-Komunat nuk ka të dhëna dhe mungon dokumentacioni ligjor e financiar mbështetës. Në fund të vitit 2021 nuk ka detyrime për vendime gjyqësore, pasi shlyerja e detyrimeve për to ka përfunduar gjatë vitit 2021. Detyrimet e prapambetura për fatura të pa likujduara, në mënyrë analitike paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Objekti	Kreditore	Numri i Faturave	Kreditor me dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.12.2020			
1	Furnizimi me uje deri Qershor 2019	Ujesjelles Sh.a	486	25,306,644		3,444,866	28,751,510
2	Sherbimi Postar deri Qershor 2019	Posta Lezhe	338	4,263,201	4,263,201		-
3	Materiale Ndertimi	S.Shpk	11	6,271,454		2,245,198	8,516,652
14	Krevate +karrige	E.L.	1	625,800	625,800		-
15	Sh Dezinfektim	H. E. G.	1	233,940	233,940		-
16	Automjete	T.SHPK	1	17,158,800	17,158,800		-
17	Kancelari	I. Office	1	490,935		45,757	536,692
18	Materi elektrike per ndricimin rrugor	D. A Shpk	5	2,573,185	2,573,185		-
22	Sherbim Autom. Policia Bashkiake	E. P.	2	590,880	590,880		-
23	Bllok fjetje ne hotel	Shtypshkr letra me vlere	1	720,000		64,500	784,500
24	Shpenzime gjyqesore	TT A.L.	-	1,371,429	1,371,429		-
25	Mb. Pun.Parki e Lulisht shesh perball shk Hydaje Lezha	I. D	1	34,800			34,800
26	Mbik pun Rivesh rrug Pran Shko 9 Vjec Marash Gjoni	I.D	1	117,277	117,277		-
27	Mb Pun Rr. Zalle Shenkoll +Mb. Pun. Asf Rr. Tale 1 Alk Tale 2+ Nd. Trot. Manati	P. C.	1	870,732	870,732		-
28	Mbikqyrje punimesh kanali vadites	N.M.	1	276,600	276,600		-
29	Mbikqyrje punimesh	R.-95 Shpk	1	554,004	554,004		-
30	Sherbim larje rruge	L. 2007 Shpk	1	568,435	568,435		-
31	Kryepleq viti 2016-2019	-	-	1,444,800	1,444,800		-
32	Pastrim NJA Daje Kallmet Blinisht Balldren	Nderkom. zadrimet	1	689,085	689,085		-
33	Shpronetime	-	-	126,103,140			126,103,140
34	Gaz	.&Co shpk	1	209,364			209,364
35	Tabela sinjalistike	S.-S.-Al	1				2,231,400
36	Ushqime	L.G.Shpk	3				914,464
37	Kancelari per zyrat	A. Shpk	1				2,676,328
38	Sherbim DDD	M.Shpk	1				209,758
39	Hartim PDV	UTS	1				11,932,200
40	Sist. Asf. Rr. varrezave Balldre	D. A Shpk	1	1,563,800	1,563,800		-
41	Rik. rrug Zall Shenkoll e rruges se varrezave	K. C.	2	3,537,148	3,537,148		-
42	Rruga Luigj Gurakuqi	A.B.Shpk	1	2,346,428			2,346,428
43	Rruga Superstrate Piraj	A.Co.	2	6,675,040			6,675,040
44	Sist. Asf. rruge brendsh FshatTroshan	Sh. 07 Shpk	2	2,088,200	2,088,200		-
45	Sist.Asf Rr. Qender- Rrabosh - Shkoll 9 vj	Sh.07 Shpk	2	3,993,600			3,993,600
46	Sist. Asf. Rr.te brendshme Fshati Gramsh	N.i Shpk	1	5,972,719			5,972,719
47	Sis. Asf. Rruges te brendshme Fshati Mabe	N. Shpk	2	10,279,300			10,279,300
48	Asf. Rr.Brend Tresh	D. A Shpk	1	4,662,700	4,662,700		-
49	Sist. Asf. Rr.Çameria	N. Shpk	1	9,688,352			9,688,352
50	Sistemim Asfaltim Blloku Lagjia Beselidhja	N.Shpk	1	3,259,808	3,259,808		-
51	Sist Asf Rrug Kakarriq –Gocaje Ndric Qend Kakarr	C. R. 2008	1	5,245,680			5,245,680
52	Sist Asf Rrug Kolin Gjoka nga Qend OLA te tunel	U.N. Shpk	1	5,409,250	5,409,250		-
53	Sist. Asf. Rr. e Varrezave Pllane	K. shpk	1	1,480,074	1,480,074		-
54	Nd.trotuari fshatin Manati	U. N. Shpk	1	1,390,724	1,390,724		-
55	Sherbim GPS	P.Shpk	1	88,048	88,048		-

56	Asf. Rr. Brend Lagjia e Pukjaneve	C. R.2008Shpk	1	5,912,173			5,912,173
57	Sist.Asf. Rr. Gjok Nika	N.Shpk	1	106,630			106,630
58	Sist. Rr. Hydajet Lezha Perballe Hotel Leti	N.Shpk	1	6,872,138			6,872,138
59	Sist. Asf. Bll. Lagjia Beselidhja tek DTT	N. Shpk	1	900,036	900,036		-
Shuma Bashkia deri 31.12.2020				271,946,353	55,717,956	5,800,321	239,992,868

Detyrimet e trashëguara nga ish-Komunat që nga viti 2015

Nr	Objekti	Kreditori	Numri Faturave	Kreditor me dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.07.2015			
Komunat				31.07.2015			
Komuna Shengjin							
1	Rikualifikim Urban Shetitorja Ëillson	F. shpk	3	17,495,807			17,495,807
2	Punime sherbimi pagese karte Telefonike	F. shpk	1	552,000			552,000
Komuna Dajç							
1	Pyllezim shega	4 A. Shpk	1	4,907,937			4,907,937
Komuna Kolsh							
1	Furnizimi me uje Kolsh Viti 2010-2016	Ujesjelles Sh.a	37	4,669,581	727,592		3,941,989
2	Sherbimi Postar Kolsh viti 2009-2013	Posta Lezhe	71	420,376			420,376
4	Mbikq Punime Ndert I Tregut Agroushqimor	L.B.	1	664,013			664,013
	Vendim gjykate tregu Kolsh		1	918,831			918,831
Komuna Balldren							
1	Sherbim Interneti	G.N.	1	150,000			150,000
2	Blerje Librash	A. D.	1	32,500			32,500
3	Blerje Naftë	V. shpk	1	112,000			112,000
4	Blerje shtypshkrimesh	Enti botues Gj. F.	2	12,240			12,240
5	Blerje Naftë	Gj.K.	1	350,000			350,000
6	Sistemim asfaltim rruga Malecaj/Balldre	B. shpk	1	1,008,228			1,008,228
7	Projekte(kontrate)	A. Xh.	-	1,100,000			1,100,000
8	Projektime(me kontrate)	A. S.	-	499,999			499,999
9	Punime shkolle	D. I.	1	374,400			374,400
10	Mbikqyrje punimesh	L. V.	1	14,280			14,280
11	Blerje Kancelarish	K.K.	1	63,700			63,700
12	Sherbim Interneti Janar Shkurt 2016	Z.M.	1	20,000			20,000
13	Sherbim Interneti	R. Com Shpk	1	163,550			163,550
14	Sherbim Interneti	R. Com Shpk	1	150,000			150,000
15	Mbikqyrje punimesh Rikonstr Rruga Balldren	N. M.	1	47,400			47,400
16	Flamu	E. C.	1	10,000			10,000
17	Kancelari	M.Z.	1	30,000			30,000
18	Pjese kembimi	B.P.	1	14,800			14,800
19	Dosje	K.K.	1	1,200			1,200
20	Kabull	L.c.	1	20,500			20,500
21	Pompe Uji	A.Z.	1	9,000			9,000
22	Riparim elektropompe	B. K.	1	30,000			30,000
23	Pjese kembimi	P.L.	1	520,200			520,200
Shuma ish-Komunat				34,362,542	727,592		33,634,950
Totali Bashkia + komunat				306,308,895	56,445,548	5,800,321	273,627,818

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, Bashkia Lezhë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 është në shumën prej **273,627,818** lekë.

Duke krahasuar me vitet në fund të periudhës ushtrimore **2021** rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura ka ardhur duke u ulur krahasuar me vitet e mëparshme, pasi në fund të **vitet 2018** këto detyrime janë në shumën **399,886,128** lekë, në fund të **vitet 2019** në shumën **310,486,424** lekë, në fund të **vitet 2020** vlera e detyrimeve është **306,308,895** lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2021 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit”. Nga analiza e detyrimeve ndaj të tretëve vihet re se, në vlerë të konsiderueshme janë detyrimet ndaj Ujësjetës Kanalizime SHA Lezhë, të cilat i përkasin faturave të akumuluar të pa likujduara që nga vitet 2015 e para tij në vlerën 28,041,464 lekë, detyrimet për vitin 2016 në vlerën 236,682 lekë, për vitin 2017 në vlerën 473,364 lekë.

Detyrimet në total në fund të vitit 2021 në vlerën **273,627,818** lekë, analizuar sipas viteve të krijimit janë: në vitin 2015 e para tij në vlerën 187,968,918 lekë, në vitin 2016 në vlerën 291,482

lekë, në vitin 2017 në vlerën 473,364 lekë, në vitin 2019 në vlerën 57, 092,060 lekë, në vitin 2020 në vlerën 12, 069,244 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 15,732,750 lekë. Për likuidimin e këtij detyrimi nga Bashkia nuk është lidhur një akt-marrëveshje me UK Lezhë, për likuidimin e tij me këste.

Vlen të theksohet se një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve e zënë edhe shpronësimet të cilët përlllogariten deri në fund të vitit 2021 si vlerë e mbetur e pa likuiduar prej 126,103,140 lekë. Gjithashtu detyrime që janë në proces të rregullt shlyerje është edhe vlera e kredisë së mbetur për tu shlyer në vitet në vazhdim prej 21,311,454.02 lekë. Pra, në fund të vitit 2021 rezultojnë detyrime ndaj të tretëve në vlerën totale prej 294,939,272 lekë.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara** (të akumuluar) në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën **294,939,272 lekë** (273,627,818 lekë detyrime për fatura, vendime gjyqësore dhe shpronësime + 21,311,454.02 lekë vlera e kredisë së mbetur) dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **2,721,996,000 lekë** (3,911,049,000 lekë totali i planifikuar - 1,189,053, 000 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet). Peshat specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 10.08 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Lezhë nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2021, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Detyrimet e krijuara nga huamarrja afatgjatë (Kredia) dhe procedurat e ndjekura për shlyerjen e saj.

Bashkia Lezhë në vitin 2011 ka kërkuar në bankat e nivelit të dytë një kredi në shumën prej 120,000,000 lekë për financimin e investimeve në infrastrukturë që janë realizuar gjatë viteve 2011-2014, si:

1. Sistemim, ndriçim, asfaltim e gjelbërim blloku “Besëlidhja” 11.2 ha, Faza I,II,III në vlerën 50,000,000 lekë
2. Sistemim, ndriçim, asfaltim e gjelbërim blloku “Besëlidhja” 11.2 ha, Faza IV në vlerën 20,000,000 lekë
3. Sistemim “Bregu i Lumit Drin”, Blloku I dhe II Faza e II në vlerën 10,000,000 lekë
4. Riparime në Rrjetin e Ujsjellësit në Bllokun e parë Bregu i Drinit në vlerën 10,000,000 lekë
5. Sistemim në “Lagjia Gurra” Faza e II në vlerën 10,000,000 lekë
6. Sistemim në “Lagjia e Spitalit” Faza e II në vlerën 10,000,000 lekë
7. Sistemim në “Lagjia Nënë Tereza” Faza e II në vlerën 10,000,000 lekë

Në fakt Bashkia ka përfituar nga Bankat e nivelit të dytë kredi afatgjatë në shumën 94,744,006.9 lekë, sipas kontratave së kreditimit (të noterizuar)të lidhura me Bankën R.nr.4683 Rep,nr.2071Kol, datë 25.11.2010 dhe me Bankën I. nr. 2051 Rep, nr.1480 Kol, datë 1206.2014. Ecuria e disbursimit dhe pagesës të kredisj sipas transheve të miratuara në kontraat me bankat paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Data	Disb Lekë	Nga banka		Likuiduar	Për tu likuiduar
28.04.2011	8,199,984.00	R.			
31.01.2011	8,199,780.00	R.			
28.02.2011	22,394,379.00	R.			
30.06.2014	17,316,288.00	S.P.	Nga R. te S. P.	12,663,103.96	26,131,039.04
31.07.2014	4,442,606.00	San Paolo			

31.08.2014	8,645,148.00	S.P.			
30.09.2014	4,459,338.00	S. P.			
31.12.2014	16,436,862.00	S. P.			
31.03.2015	2,772,005.90	S. P.			
30.04.2015	1,877,616.00	S.P.			
12/31/2021				73,432,552.88	21,311,454.02
TOTALI	94,744,006.90			73,432,552.88	21,311,454.02

Sipas tabelës së mësipërme rezulton se gjendja e stokut të borxhit të kredisë në datën 31.12.2021 është në vlerën 21,311,454.02 lekë. Nga Bashkia likujdimi është bërë në mënyrë të rregullt periodike (cdo 3-mujor) sipas kësteve të parashikuara për pagesë të principalit dhe interesit. Nga Bashkia është bërë rakordimi me degën e Thesarit Lezhë dhe është raportuar periodikisht cdo vit në MFE pranë Drejtorisë së Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit për detyrime të njisë për shpenzimet e shërbimit të borxhit të parashikuar në buxhetin e vitit ushtrimor, në zbatim të marrëveshjeve të huamarrjes vendore, raportimit për pagesat e kryera për të shërbyer borxhin gjatë vitit me të dhënat: shumën e shërbimit të borxhit të paguar (principal plus interes), lëvrimin e fondeve të huasë për llogari të hua për llogari të huamarrësit si dhe gjendjen e stokut të borxhit në fund të vitit ushtrimor, të rakorduar paraprakisht me bankën (huadhënësin). Kjo kredi është evidentuar në kontabilitet dhe gjendja e mbetur është paraqitur në Pasqyrat financiar për cdo vit në fund të periudhës ushtrimore.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investimeve përmes FZHR dhe ministrive të linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financim nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Lezhë, fondet FZSH, Ministrinë e Linjës, Ministria e Rindërtimit dhe Ministria e Financave.

- Për **vitin 2021** janë planifikuar fonde në vlerën 3,738,161,897 lekë për investime në 20 projekte, për të cilat janë kryer dhe procedurat e prokurimit. Nga këto janë lidhur kontrata për 17 projekte në vlerën prej 3,409,087,110 lekë dhe 3 projekte janë lidhur kontratat në janar të vitit 2022 në vlerën 329,074,787 lekë.

Nga 17 projekte janë kryer pagesa në vlerën 932,472,818 lekë, kanë mbetur për likujdim në vitin 2022 vlera prej 1,414,959,464 lekë, e cila i përket vlerës së kontratës të pa paguar dhe jo vlerës së faturave të mbërritura, pasi në disa raste punimet kanë zgjatur në 0-2 vite buxhetore dhe në disa raste të tjera nuk është prerë faturë nga operatori fitues.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me V.K.B për secilin rast.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likujdimet e tyre paraqiten në tabelën bashkëlidhur Aneksi Nr.1.

Nga dokumentacioni zyrtar i mbajtur nga Bashkia Lezhë për fondet akorduara për financimin e projekteve të investimeve rezulton se:

Për vitin 2021, janë financuar nga të ardhurat e Bashkisë edhe Transfertat e pakushtëzuar (grant) nga buxheti i shtetit 6 projekte në infrastrukture (sheshi lumi Drin), blerje automjete e pajisje zyrash. Ndërsa nga FZHR dhe Ministrinë e Linjës janë alokuar fonde për financim të 10 projekteve:

Nga Ministria e Infrastrukturës është financuar 1 projekt:

-Ndërtim Ujësjellësi në fshatrat Pllane, Markatomaj, Zejmen, Spiten, Tresh Loti i 2 me vlerë kontrate 162,855,662 lekë, me afat 18 muaj nga data 07.04.2021 e lidhjes së kontratës, paguar deri në fund të vitit 2021 në vlerën 103,309,046 lekë, mbetur pa likujduar vlera prej 59,546,616 lekë.

Nga Ministria e Rindërtimit janë financuar 8 projekte:

-Rikonstrukcion i Mjediseve në Bashkëpronësi ose të Përbashkëta në Ndërtesat Pallate të

prekura nga termetiloti i II-tëme vlerë kontrate 308,171,682 lekë, me afat 11 muaj nga data 18.02.2021 e lidhjes së kontratës, paguar deri në fund të vitit 2021 në vlerën 244,167,443 lekë, mbetur pa likujduar vlere prej 64,004,239 lekë.

-Ndërtim i Ujësjetllësit në zonën Bregdetare NJA Shenkoll në vlerën 791,056,514 lekë, me afat 48 muaj nga data 11.02.2021 e lidhjes së kontratës, paguar 189,954,061 lekë deri në fund të vitit 2021, mbetur pa likujduar vlere prej 601,102,453 lekë.

-Rindertimi i Konviktit të Shkollës Profesionale N. Gj. me vlerë kontrate 153,010,000 lekë, me afat 8 muaj nga data 24.12.2020 e lidhjes së kontratës, paguar deri në fund të vitit 2021 në vlerën 30,849,605 lekë, mbetur pa likujduar vlere prej 122,160,395 lekë.

-Hartim projekti për ndërhyrjen e rehabilitimit për kthimin e strukturës së objekteve të klasifikuara me demtime të mëdha strukturore dhe jostrukturore me vlerë kontrate 11,468,795 lekë, afati i përfundimit 15 ditë nga data 24.06.2021, paguar deri në fund të vitit 2021 në vlerën 9,748,476 lekë, mbetur pa likujduar vlere prej 1,720,319 lekë.

-Rindertimi i shkollës 9-vjecare At Zef Pllumbi - NJA Zejmen me vlerë kontrate 222,776,980 lekë, me afat 6 muaj nga data 16.02.2021 e lidhjes së kontratës, paguar deri në fund të vitit 2021 në vlerën 220,065,229 lekë, mbetur pa likujduar në vlerën 2,711,751 lekë.

-Hartimi i Planeve të Detajuara Vendore (PDV) në vlerën 11,932,200 lekë, afati i përfundimit ishte 45 ditë nga data 18.06.2021 e lidhjes së kontratës, nuk është likujduar deri në fund të vitit 2021.

-Riforcimi i pallateve me banesat individuale në kuadër të rindërtimit në territorin e Bashkisë Lezhë me vlerë kontrate 507,888,100 lekë, me afat 11 muaj nga data 19.04.2021 e lidhjes së kontratës, paguar në vlerën 103,503,780 lekë deri në fund të vitit 2021, mbetur pa u likujduar në vlerën 404,384,320 lekë.

-Rindërtimi i 40 njësive individuale banimi Bashkia Lezhë në vlerë kontrate 88,855,210 lekë e pa likujduar deri në fund të vitit 2021.

Nga Ministria e Financës me fondet e emergjencës (grandet sektoriale) është financuar Iprojekt:

-Rikonstruksioni e Rehabilitimi i Urave Malecaj, Lalm i RI, Kalivac, Kolsh, Ungrej me vlerë kontrate 8,061,907 lekë, datë e lidhjes së kontratës 30.12.2021, e pa likujduar deri në fund të vitit 2021.

Nga Bashkia me burim financimi të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar ndër të tjera ka financuar dhe projektet:

-Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurisë në shetitoren e Lumit Drin "2 Urat", me vlerë kontrate 38,618,939 lekë, me afat 6 muaj nga data 17.02.2021 e lidhjes së kontratës, paguar në vlerën 28,374,379 deri në fund të vitit 2021, mbetur pa u likujduar vlere prej 10,244,560 lekë.

-Rrethim e sistemim i varrezave të Njësive Administrative të Bashkisë Lezhë, me vlerë kontrate 28,384,894 lekë, datë e lidhjes së kontratës 05.11.2021, e palikujduar deri në fund të vitit 2021.

-Blerje automjet zjarifikës me vlerë kontrate 11,850,600 lekë, datë e lidhjes së kontratës 19.11.2021, e palikujduar deri në fund të vitit 2021.

Konkluzion: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 10 projekteve të investimeve me fondeve të akorduara nga Ministritë e Linjës dhe FZHR, si dhe fondeve të veta të vëna në dispozicion nga Bashkia Lezhë për vitin 2021, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Bashkia për këto investime ka marrë angazhime buxhetore një dhe disavjeçare, të cilat janë regjistruar kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim në sistemin Informatik financiar të Qeverisë nëpërmjet Degës së Thesarit Lezhë.

Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Lezhë. Kontratat janë regjistruar në afat, me vlerë të plotë në SIFQ

nga Dega e Thesarit Lezhë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në 3 vite sipas planifikimit në PBA. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj edhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit, është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite vlera për secilin vit.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor.

Realizimi i buxhetit për vitin 2021 sipas burimit të financimit paraqitet:

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	461,913.5	419,367.0	90.8
a	Grant i kushtëzuar	13,259.0	13,232.3	99.8
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	364,758.5	349,347.0	95.8
c	Të ardhurat vendore	83,896.0	56,787.7	67.7
2	Sigurime shoqërore 601	76,861.9	69,169.6	90.0
a	Grant i kushtëzuar	1,567.0	1,444.5	92.2
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	61,255.9	58,111.8	94.9
c	Të ardhurat vendore	14,039.0	9,613.3	68.5
3	Shpenz.operative 602+ F.Rezervë	517,155.4	365,760.2	70.7
a	Grant i kushtëzuar	129,045.6	67,857.3	52.6
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	45,784.3	42,213.5	92.2
c	Të ardhurat vendore	342,325.5	255,689.4	74.7
4	Kredia dhe Interesi 166-651	11,425.8	11,186.2	97.6
a	Të ardhurat vendore	11,455.5	11,186.2	97.6
5	K.Qarkut Emergj.civile 604	17,968.0	3,798.7	21.1
a	Grant i pakushtëzuar-specifikë	10,968.0	0.0	0.0
b	Të ardhurat vendore	7,000.0	3,798.7	54.3
c	Transferta nga Qeveria	0.0	0.0	0.0
6	Nd ekonomike dhe invalid 606	1,189,053.6	977,174.0	82.2
a	Grant i kushtëzuar	1,169,583.8	969,747.5	82.9
b	Grant i pakushtëzuar-specifikë	5,379.8	3,068.3	57.0
c	Të ardhurat vendore	14,090.0	4,358.2	30.9
7	Mjete në ruajtje 466	11,793.1	11,793.1	100.0
a	Grant i pakushtëzuar	11,793.1	11,793.1	100.0
b	Të ardhurat vendore	0.0	0.0	=
8	Investime 230-231	1,624,878.3	1,172,122.0	72.1
8.1	Buxheti i bashkisë	394,394.3	197,794.8	50.2
a	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	187,050.6	48,468.9	25.9
b	Të ardhurat vendore	207,343.7	149,325.9	72.0
8.2	Ministritë e linjës dhe FZHR	1,230,484.0	974,327.2	79.2
	TOTALI	3,911,049.6	3,030,370.8	77.5

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “Paga e shpërblime” për vitin 2021 në masën 13.5%.
 - Shpenzimet në artikullin 601 “Kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore”, për vitin 2021 në masën 13.9%..
 - Shpenzimet në artikullin 602 “Shpenzime operative-mallra e shërbime” për vitin 2021 në masën 69.9 %.
 - Shpenzimet në artikullin 230-231 “Investime” për vitin 2021 në masën 12.7%.
- Duke u nisur nga burimi i financimit shpenzimet buxhetore për vitin 2021, janë përballuar:
- nga të ardhurat e veta në shumën 490,759.4 mijë lekë, ose në masën 16.2%,
 - nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 513,002.6 mijë lekë ose në masën 16.9 %,
 - nga transferta e kushtëzuar në shumën 1,052,281.6 mijë lekë, ose në masën 34.7%,
 - nga FZHR dhe Ministritë e Linjës në shumën 974,327.2 lekë, ose në masën 32.2%.

Raportet e Monitorimit

Për vitin 2021, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin, objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësive të Qeverisjes vendore”.

Titulli gjetjes: Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2021

Situata: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2021, u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2021 është 3,030,371 mijë lekë nga 3,911,049.6 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.5%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 70.7% , pra konstatohet një planifikim me rezervë i tij dhe zëri 230-231 “Shpenzime për investime” realizuar në masën 72.1%.

b. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhet, ku për vitin 2021 janë kryer 56 ndryshime, gjë që tregon qartë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv.

c. Detyrimet e papaguara për vitin 2021 sipas bilancit janë në shumën **273,627,818** lekë, ose në masën 7.54 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat kanë ardhur duke u ulur, krahasuar me vitin 2020, ku detyrimet janë në shumë të konsiderueshme prej 306,308,895 lekë.

d. Të ardhurat janë realizuar në masën 76.1%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 83% nga Buxheti i Shtetit (transfera e pakushtëzuar, transfera e kushtëzuar, transfera specifike, FZHR e Ministrisë e Linjës) dhe 16.9% nga të ardhurat e veta.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42.

Udhëzim i MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Ndikimi/Efekti: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti si dhe realizimjo shumë të mirë të të ardhurave si dhe gjendje në vlera të konsiderueshme të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa mos likuidimi i detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme bazuar në treguesit e realizuar në periudhat e mëparshme, me qëllim që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë të argumentuara dhe

ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

- Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre.

Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në zbatim të programit të auditimit dhe këtij drejtimi auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021.
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.
- Dokumentacioni nga Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi DATECH i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranimit-faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren sipas Zonave dhe NJA.
- Akt-rakordimet për realizimin e të ardhurave në mes Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe listat e debitorëve të gjeneruara nga sistemi DATECH.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga inspektorët e borxhit shoqëruar me evidenca dhe korespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve.
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat.
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, si për taksat ashtu edhe për tarifave vendore, të mbajtura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2021.
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara.
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet nga palët, me thesarin, etj.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës - Buxhetit dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se rregullshmëria e veprimeve të kryera nga sektori i të ardhurave për vjeljen e taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera, paraqitet si më poshtë:

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2021, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 172, datë 27.11.2020, me ndryshime dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 901 datë 24.12.2020 “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e Bashkisë, të NJA, të institucioneve vartëse dhe punonjësve të njëjësive të shërbimeve për vitin 2021”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 22 punonjës, 1 drejtor dhe nga 3 sektorë si:

- Sektori i Rregjistrimit dhe Vlerësimit të Taksapaguesit me 7 punonjës, ku 1 është përgjegjës sektori, 4 specialist për taksat dhe tarifave të biznesit, 1 specialist për dhe tarifave të tokës bujqësore dhe truallit dhe 1 specialist për taksat dhe tarifave familjare.

- Sektori i Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit me 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist të mbledhjes së borxhit.

- Sektori i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren me 1 përgjegjës sektori dhe 10 specialist të kontrollit dhe verifikimit në terren.

Struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave pothuajse nuk ka ndryshuar gjatë periudhës objekt auditimi.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Nga të dhënat e paraqitura nga DTTV, Bashkia Lezhë në lidhje me strukturën e planifikimit dhe mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore u konstatua se DTTV, Bashkia Lezhë, planifikon dhe mbledh taksat dhe tarifave në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me agjent tatimorë.

Për vitin 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Lezhë është miratuar me me VKB nr. 46, datë 13.11.2019, “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, ndryshuar me VKB nr.76 datë 19.04.2021.

Referuar planit vjetor të buxhetit të miratuar dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Lezhë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2021			
		Plani Fillestar	Plani Rishikuar	Fakti	Në %
I	Të ardhurat nga taksat (I/a +I/b)	518,074	441,615.7	324,013.6	73.4
I/a	Vendore (1-6)	478,924	402,465.7	254,039.8	63.1
1	Taksa mbi pasurinë	95,515	95,515.0	99,604.0	104.3
1.1	Taksa mbi ndërtesat	70,122	70,122.0	78,661.3	112.2
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	10,064	10,064.0	5,105.0	50.7
1.3	Taksa mbi truallin	15,329	15,329.0	15,837.7	103.3
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	10,000	10,000.0	6,025.3	60.3
3	Taksa e ndikimit të infrastrukturës nga nd.reja	358,909	282,450.7	133,225.3	47.2
4	Taksa e tabelës dhe reklamës	4,000	4,000.0	5,114.5	127.9
5	Taksa e fjetjes në hotele	10,000	10,000.0	9,663.1	96.6
6	Taksa të tjera të përkohshme	500	500.0	407.6	81.5
-	Për infrastrukturën nëntokësore	0	0.0	35.2	=
-	Për infrastrukturën në arsim	500	500.0	372.4	74.5
I/b	E Ndara (1-5)	39,150	39,150.0	69,973.8	178.7
1	Taksa e kalimit të drejtës pronësisë P.Palujtshme	7,000	7,000.0	9,986.2	142.7
2	Taksa e regjistrimit të automjeteve	32,000	32,000.0	40,333.7	126.0
3	Taksa e rentës minerale	150	150.0	500.3	3.3 herë
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0.0	19,153.6	=
5	Taksa të tjera	0	0.0	0.0	0.0
II	Të Ardhurat Jotatimore (II/a + II/b + II/c)	261,941	261,941.0	211,100.3	80.6
II/a	Të ardhurat nga tarifave vendore	196,795	196,795.0	171,663.4	87.2
1	Tarifa shërbimi	99,352	99,352.0	98,369.4	99.0
-	Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeve	62,422	62,422.0	98,369.0	157.6
-	Tarifë ndriçimi publik	17,962	17,962.0	0.4	0.0
-	Tarifë gjelbërimi	18,968	18,968.0	0.0	0.0
2	Tarifë shërbimi veterinar	782	782.0	629.7	80.5
3	Tarifa të tjera (licence, leje, autorizime etj.)	2,000	2,000.0	2,000.0	100.0
4	Tarifë parkimi	4,500	4,500.0	7,890.8	175.4
5	Tarifë për kulturën	1,588	1,588.0	819.0	51.6
6	Tarifë për hapësirat publike	60,000	60,000.0	42,065.8	70.1
7	Të ardhura nga tarifave të Urbanistikës	10,000	10,000.0	9,741.6	97.4
8	Tarifë për shërbimet e MZSH	1,860	1,860.0	1,070.0	57.5
9	Tarifë leje transporti	1,319	1,319.0	898.9	68.1
10	Të ardhura nga tarifa e lëndëve drusore	489	489.0	57.4	11.7
11	Tarifa për shërbimet administrative	71	71.0	400.0	5.6 herë

12	Tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit	0	0.0	10.0	=
13	Pagesat nga Çerdhet	2,880	2,880.0	1,580.6	54.9
14	Pagesat nga Kopshtet	11,954	11,954.0	6,061.2	50.7
15	Pagesat nga nxënësit e Konviktit	0	0.0	69.0	=
16	Tarifa për sportet	0	0.0	0.0	0.0
II/b	Të ardhura nga shitja e pronës, dhënia me qira	8,030	8,030.0	8,787.5	109.4
1	Shitje ndërtese banimi	0	0.0	0.0	0.0
2	Shitje troje	0	0.0	1,183.1	=
3	Shitje prona të tjera (automjete dhe inv.ek.)	0	0.0	0.0	0.0
4	Qira mbi trojet	6,493	6,493.0	6,493.5	100.0
5	Qira tokë bujqësore	95	95.0	1,095.9	11.5 herë
6	Qira mbi ndërtesat ,pajsje etj.	1,442	1,442.	15.0	1.0
II/c	Të ardhura të tjera	57,116	57,116.0	30,649.4	53.7
1	Nga dhuratat dhe sponsorizimet etj.	50,996	50,996.0	18,767.0	36.8
2	Nga gjobat	5,970	5,970.0	10,499.6	175.9
3	Të ardhura të tjera (debitorë.ankande etj)	150	150.0	1,382.8	9.2 herë
GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II)		780,015	703,556.7	535,113.9	76.1

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se: *Për vitin 2021*, të ardhurat nga **703,557** mijë lekë të planifikuara janë realizuar **535,114** mijë lekë, me mosrealizim në shumën 168,443 mijë lekë ose në masën **76.1%**. Në këtë nivel realizimi të ardhurave kanë ndikuar realizimi i:

- **Taksës mbi pasurinë** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 99,604 mijë lekë nga 95,515 mijë lekë të planifikuar ose në masën 104.3%

- **Taksës mbi ndërtesat** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 78,661 mijë lekë nga 70,122 mijë lekë të planifikuar ose në masën 112.2%.

- **Taksës mbi tokën bujqësore** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%

- **Taksës mbi truallin** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 15,837.7 mijë lekë nga 15,329 mijë lekë të planifikuar ose në masën 103.3%

- **Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 6,025.3 mijë lekë nga 10,000 mijë lekë të planifikuar ose në masën 60.3%

- **Taksës së ndikimit të infrastrukturës nga ndërtime të reja** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 133,225.3 mijë lekë nga 282,450.7 mijë lekë të planifikuar ose në masën 47.2%.

- **Taksës së tabelës dhe reklamës** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 5,114.5 mijë lekë nga 4,000 mijë lekë të planifikuar ose në masën 127.9%.

- **Taksës së fjetjes në hotele** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 9,663.1 mijë lekë nga 10,000 mijë lekë të planifikuar ose në masën 96.6%.

- **Taksës së kalimit të drejtës pronësisë Pasurive të Paluajtshme** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 9,986.2 mijë lekë nga 7,000 mijë lekë të planifikuar ose në masën 142.7%.

- **Tarifës së pastrim-gjelbërim-ndricim** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 98,369.4 mijë lekë nga 99,352 mijë lekë të planifikuar ose në masën 99%.

- **Tarifës së shërbimit veterinar** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 629.7 mijë lekë nga 782 mijë lekë të planifikuar ose në masën 80.5%.

- **Tarifës së parkimit** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 7,890.8 mijë lekë nga 4,500 mijë lekë të planifikuar ose në masën 175.4%.

- **Tarifës për hapësirat publike** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 42,065.8 mijë lekë nga 60,000 mijë lekë të planifikuar ose në masën 70.1%.

- **Tarifës për leje transporti** për **vitin 2021** është realizuar në shumën 898.9 mijë lekë nga 1,319 mijë lekë të planifikuar ose në masën 68.1%.

Konkluzion: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pasi nuk është bazuar mbi një përcaktim real dhe të plotë të kapacitetit fiskal.

Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga DTTV Bashkia Lezhë në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për vitin 2021, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: janë **6078** subjekte biznesi, nga të cilat 5,049 subjekte të biznesit të vogël dhe 1029 subjekte të biznesit të madh. Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Lezhë në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të vitit	Biznese të palicencuar deri në fund të vitit ushtrimor
1		2021	4764	382	97	5,049	-
		2021	1025	4	0	1,029	-
		2021	5,789	386	97	6,078	-

Këto të dhëna nuk janë marrë nga rregjistrimi i bizneseve të DTTV Lezhë, të cilat kanë rezultuar nga numri egzistent, që në krijimin e këtij rregjistrimi në Sistemin Elektronik të taksave DATECH, duke bërë përditësimin në mënyrë periodike çdo muaj nga specialistët me të dhënat e QKR për mbylljet dhe hapjet e reja të aktiviteteve, por nuk ka një verifikim të statusit (aktiv, pasiv, crregjistruar) të të gjithë bizneseve, që ekzistojnë në rregjistrim.

Kjo vërteton mungesën e bashkëpunimit me institucionet dhe punën e pamjaftueshme të menaxhimit dhe punonjësve të DTTV-së Bashkisë Lezhë. (Në mënyrë të detajuar paraqiten në CD,)

Gjithashtu, ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV-ja nëpërmjet rregjistrimit në Excel të krijuar me raportet e gjeneruara nga sistemi DATECH në fund të periudhës ushtrimore 2021. Pra, mungojnë të dhënat e sakta, si për numrin e bizneseve me status aktiv ashtu edhe për numrin e vlerat e debitorëve.

Kjo procedurë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sitemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr. 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin nr. 41 “Idenfitikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregare pa u regjistruar”, nenin nr. 43 “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”. “Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Lezhë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”.

Titulli gjetjes: Programimi i të ardhurave sipas llojit dhe realizimi i treguesve kundrejt atyre të planifikuara dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit për vitin 2021.

Situata: Referuar akt-rakordimeve me Thesarin konstatohet se për vitin 2021, të ardhurat nga **703,556.7** mijë lekë të planifikuara janë realizuar **535,113.9** mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 168,442.8 mijë lekë, ose në masën **76.1%**.

Nga analiza e të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, me ndryshime të tilla realizimi edhe për të njëjtën taksë apo tarifë nga njëri vit në tjetrin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pasi nuk është bazuar mbi njëpërcaktim real dhe të plotë të kapacitetit fiskal.

Gjithashtu ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV-ja nëpërmjet regjistrit në Excel të krijuar me raportet e gjeneruara nga sistemi DATECH në fund të periudhës ushtrimore 2021. Pra akoma nuk administrohen të dhëna të sakta, si për numrin e bizneseve me status aktiv dhe për numrin e vlerat e debitorëve.

Kriteri: ligji nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” të ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54 “Raportimi financiar” nënpika c, Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave dhe realizim i tyre në vlera jo të kënaqshme si dhe evidentimi jo i saktë e taksapaguesve në numër dhe në vlerat e tyre debitore.

Shkaku: Punë e pamjaftueshme e strukturave përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera drejtuese, për arritjen e një planifikimi të plotë të të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore, të saktësojë treguesit e planit të ardhurave mbi baza reale, duke saktësuar regjistrin e taksapaguesve në lidhje me numrin e bizneseve (aktiv, pasiv e të pezulluar) nëpërmjet të dhënave nga QKR, DRTT e inspektimit në terren, për shfrytëzimin e plotë të kapacitetit fiskal.

-Niveli i lartë e debitorëve. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë, rezultoi se ka një numër të lartë debitorësh nga biznesi, të cilët nuk mund t’i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, por do t’i bashkëlidhen materialit në formë dixhitale, me CD. Niveli i lartë i **debitorëve nga biznesi** si në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifave vendore, është në masë të konsiderueshme, kështu në fund të **vitit 2021** numri i debitorëve është **4349** subjekte në vlerën **241,253,830 lekë**. Vlera progresive në fund të vitit 2021 prej **241,253,830 lekë**, përfaqëson taksat dhe tarifave vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Lezhë. Kjo vlerë nuk është e saktë, pasi ka dalë nga raportet e gjeneruar nga sistemi elektronik i taksave DATECH, i cili nuk është i saktë. Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Debitorët në mënyrë të përmbledhur për subjektet dhe institucionet viti 2021

LLOJI I BIZNESIT	Në datën 31.12.2021	
	NR	Vlerë
BIZNES I MADH	724	120,941,376
BIZNES I VOGEL	3370	110,169,493
INSTITUCIONE	7	2,892,100
	248	7,250,861
TOTALI	4349	241,253,830

Institucionet që nuk kanë paguar detyrimet për taksa dhe tarifa vendore paraqiten në mënyrë të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	NIPT	Lloji i Biznesit	Detyrimi Debitorë
	INSPEKTORIATI SHTETEROR I PUNES	K.....U	BM	40,000

	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT	L.....Q	BM	350,000
	DREJTORIA RAJONALE E SHENDETIT PUBLIK LEZHE	K.....T	BM	203,400.
	DREJTORIA VENDORE E POLICISE	J.....M	BM	1,535,600
	ALUIZNI QARKU LEZHË		BM	124,200.
	PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR LEZHE	K.....V	BM	372,800
	KËSHILLI I QARKUT LEZHË	K.....O	BM	266,100
	Shuma			2,892,100

Numri dhe vlera e subjekteve debitoare per vitin 2021, është deklaruar edhe tek Drejtoria e Finances dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhe për përfshirjen e tyre në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor.

Referuar tabelës së mësipërme dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV konstatohet se, nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve, që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave apo tarifave dhe kamatëvonesave të akumuluar, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018, duke filluar nga viti 2011 janë gjeneruar nga sistemi në listim subjektsh debitoare me shumë progresive të debisë, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për cdo subjekt.

Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore. Në lidhje me masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.

Referuar të dhënave në dispozicion të shkresave të protokolluara (fizikisht) në zyrën e sektorit të borxhit, rezultoi se:

Për vitin 2021(janar - dhjetor) janë bërë:

499 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë me vlere debitoare **49,500,223** lekë

190 masa shtërnguese- bllokime llogarie bankare bankare me vlere debitoare **87,497,393** lekë Gjithashtu janë nënshkruar **32** marrëveshje për likuidim me këste nga subjektet debitoare me vlere **26,068,589** lekë, nga të cilat janë arkëtuar brenda vitit 2021 në vlerë **20,601,727** lekë.

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimin të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, me ndryshime,nga ku rezultoi se:

- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të Detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër të parashikuar në përkatëse.

- Nga dosjet e zgjedhura për auditim, nuk gjen zbatim ndryshimi ligjore i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; “*Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit*”.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitoare strukturat e DTTV Bashkia Lezhë, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”.neni 93 dhe 94. Gjithashtu nga DTTV për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e

procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. ligjnr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”.

Planifikimi dhe realizimi jo i kënaqshëm i të ardhurave nga taksat dhe tarifat nga biznesi, institucionet dhe familjarët për taksat dhe tarrifat, numri dhe vlera e konsiderueshme e debitorëve si dhe mosevidentimi i plotë dhe i saktë i të dhënave tregon për një punë të pa mjaftueshme nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Bazuar në Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Lezhë të miratuar me Vendimin e Titullarit nr.209 datë 23.05.2018 nenet 51, 52, 53 dhe 54, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për mangësitë e për veprimet në mospërputhje me dispozitat ligjore të sipërpërmendura ngarkohen me përgjegjësi z.**A.B.** ish- Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, zj. **L.D.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Rregjistrimit dhe Vlerësimit të Tatimpaguesve (periudha 01.01.2020-06.01.2022), specialistët i rregjistrimit, vlerësimit, verifikimit e kontrollit në terren të tatimpaguesve: zj. **O. T.**(periudha 07.07.2016 e në vazhdim), z. **S. R.** (periudha 12.10.2011 e në vazhdim), z. **M. Z.** (periudha 30.01.2015 e në vazhdim), z. **E. Gj.** (periudha 04.05.2016-12.01.2022 larguar), z. **A. K.** (periudha 03.08.2017 e në vazhdim), z. **A. Z.** (periudha 20.08.2020 e në vazhdim), zj.**L. N.** (periudha 18.12.2019 e në vazhdim), z. **T. M.**(periudha 27.02.2020 e në vazhdim), z. **F. U.** (periudha 18.12.2019 e në vazhdim), z. **E. P.**(periudha 27.02.2020 e në vazhdim), z.**Denis Pervathi** (periudha 27.02.2020 e në vazhdim), zj. **R.Gj.**(periudha 18.12.2019 -06.01.2022), zj. **F. M.** (periudha 18.12.2019-06.01.2022), z. **T. Z.** (periudha 20.08.2020 e në vazhdim), zj. **K. N.** (periudha 20.08.2020 e në vazhdim) si dhe z.**E. P.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Borxhit (periudha 18.06.2018 –korrik 2021 leje lindje) dhe **K. S.** me detyrë specialist në Sektorin e Mbledhjes së Borxhit ((periudha 27.02.2020 e në vazhdim).

Titulli gjetjes: Evidentimi dhe vlerësimi i nivelit të detyrimeve debitorë, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor.

Situata: Në bazë të përpunimit të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV rezultoi se, ka një numër të lartë debitorësh nga biznesi, (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesë etj), ku nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2020** numri i debitorëve është **5451 subjekte** në vlerën prej **232,216,597 lekë** dhe në fund të **vitit 2021** numri i debitorëve është **44349 subjekte** në vlerën prej **241,253,830 lekë**. Për një pjesë të debitorëve konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta, që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave apo tarifave dhe kamatëvonesave të akumuluar, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018, duke filluar nga viti 2011 janë gjeneruar nga sistemi në listim subjektsh debitorë me shumë progresive të debisë, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Nga Sektori i Borxhit për vitin 2021 janë bërë 499 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 190 masa shtrënguese si dhe janë nënshkruar **32 marrëveshje** për likuidim me këste nga subjektet debitorë me vlerë **26,068,589 lekë**, nga të cilat janë arkëtuar brenda vitit 2021 në vlerë **20,601,727 lekë**. Ndërsa për 7 institucionet debitorë në vlerën **2,892,100 lekë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së njoftimit për pagesë të detyrimeve tatimore.**

Nga DTTV për subjektet debitorë në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar ditor si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë

dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite.

Kriteri: ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1. 3, neni 35, me ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, dhe ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme.

Shkaku: Punë e pamjaftueshme e strukturave përgjegjëse.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkinë Lezhë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **44349 subjekte** në vlerën prej **241,253,830 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, DPTTV të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana DTTV dhe Drejtoria Juridike Bashkia Lezhë, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- *Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

Për taksën e ndërtesës dhe tarifës së pastrim –gjelbërim-ndricimit për familjarët

Bashkia Lezhë, për mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi –gjelbërim-ndricimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Sha Lezhë në bazë të VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika II në të cilën përcaktohet: *“Të caktojë si Agjent Tatimor, për vjeljen e Taksës mbi “Ndërtesat për Qëllime Banimi” dhe “Tarifën për “Shërbimet Publike”, ndaj kategorisë së taksapaguesve si “Familjarë”, Drejtorinë e Sh.A. Ujësjellës Kanalizime Lezhë, për ato familje që kanë kontratë furnizimi me ujë.*

Nga Bashkia Lezhë nuk është lidhur akt-marrëveshje me Agjentin tatimor UK sha Lezhë në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 35 pika 2 e cila përcakton: *“Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendo për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcakton nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent. Në*

rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të”.

Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Lezhë nuk ka regjistruar të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familjet që nuk kanë kontratë me UK sha Lezhë për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Faturimi dhe realizimi i taksës së ndërtesës dhe tarifës pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët për vitin 2021, sipas akt-rakordimeve mes Bashkisë Lezhë dhe Agjentit Tatimor UKsha Lezhë paraqitet në tabelën mëposhtme:

Nr	Emertimi	Faturimi i taksave		Arketimi i taksave		Akt rakordim mes Bashkisë dhe UK sha për arketimin e taksave dhe tarifave	TAKSE BANESE	TARFË SHËRBIMIT (pastrim-gjelbërim-ndriçim)
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë			
1	Viti 2021	15,002	62,056,619	12,999	53,774,106	53,774,106	25,813,026	27,961,080

Debitore për **taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçim)** për vitin 2021, janë 2003 familje në vlerën 8,282,513 lekë. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2021 nuk janë planifikuar dhe realizuar të ardhura nga Taksa e ndërtesës dhe Tarifa e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për abonentët familjarë, të cilët **nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin** me ujë të pijshëm me UK Sh. A Lezhë.

Numri i banesave familjare për Bashkinë e Lezhës së bashku me Njësitë Administrative nga të dhënat e e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Lezhë dhe numri i familjeve që kanë paguar kontratën me UK sha Lezhë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Bashkia Lezhe	Viti 2021			
	Nr familjeve sipas Gj.Civile	Nr kontratave te perjashtuara nga taksat	Nr kontratave të faturuara	Mbetja pa kontrata edhe pa faturuar
Balldre	2906	126	910	1870
Blinisht	1547	158	770	619
Dajc	2107	95	385	1627
Kallmet	1976	111	716	1149
Lezhe	9682	1021	7578	1083
Shengjin	4038	305	4336	+603
Zejmen	2665	117	307	2241
Shënkoll	4709			4709
Kolsh	2319			2319
Ungrej				
Totali	31949	1933	15002	15014

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se numri i banesave familjare për Bashkinë Lezhë është më i madh se numri i kontratave të lidhura me UK sha Lezhë në shifra të konsiderueshme.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, UK sha dhe Administratorët e Njësite Administrative, nuk janë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos u përditësuar listat e familjarëve, që duhet të paguajnë taksën e banesës dhe tarifën e shërbimit. Vlera e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët pa kontratë me UK sha sipas paketave fiskale të përcaktuara për qytetin Lezhë dhe Njësitë Administrative dhe familjet pa kontratë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Njësitë Administrative	Viti 2020					Viti 2021		
	Taksa ndërtesë sipas VKB	Tarife Shërbimi (pastrim+gjelbërim+ndriçim)	Shuma Taksë Ndërtese	Nr familje	Vlera e të ardhurave	Taksë ndërtesë	Nr familje	Vlera e të ardhurave

	20 lekë/m2 Pa dokument hipoteke taksohet për 100m2	sipas VKB Zona A = 200 lekë/muaj Zona B = 100 lekë/muaj Zona C = 100 lekë/muaj	+ Tarifë Shërbimi	pa kontratë	të munguara	+ Tarife shërbimi	pa kontratë	të munguara
Balldre	2000	1200	3200	1876	6,003,200	3200	1876	6,003,200
Blinisht	2000	1200	3200	615	1,968,000	3200	615	1,980,800
Dajç	2000	1200	3200	1637	5,238,400	3200	1637	5,206,400
Kallmet	2000	1200	3200	1435	4,592,000	3200	1435	3,676,800
Lezhë	2000	2400	4400	1182	5,200,800	4400	1182	5,200,800
Shengjin	2000	2400	4400	+203		4400	+603	
Zejmen	2000	1200	3200	2239	7,154,800	3200	2239	7,164,800
Shënkoll	2000	2400	4400	4209	18,519,600	4400	4209	18,519,600
Kolsh	2000	1200	3200	2019	6,460,800	3200	2019	6,460,800
Ungrej	Nuk ofrohet shërbim							
				15212	55,137,600		15212	54,213,200
				-	-		- 603	-
				203	893,200			2,653,200
				15009	54,244,400		14639	51,560,000

Nga përlogaritjet e përafërta për vitin 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sha, **detyrimi i pa tarifuar dhe i paarkëtuar** për taksën e ndërtesës dhe **tarifën e pastrim-gjellërim-ndricimit** rezulton **në vlerën 51,560,000 lekë, që janë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Lezhë**.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 7 neni 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime dhe nenin 70, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, pika A.2.a “Taksa e ndërtesës”, Rubrika “Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve janë: “b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “familjarë”, që kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Sh.A.Lezhë, ndërsa për ato familjarë, që nuk kanë kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, atëherë strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësitë Administrative.”

Pika B.1 “Tarifa e Shërbimeve Publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, gjellërimin, ndriçimit dhe dekorit” në të cilën përcaktohet: “Kategoria A. “Familjarët”: Detyrimi paguhet me këste mujore të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, për klientët e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, ndërsa për ato familje, që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, detyrimet paguhen me një këst të vetëm, pranë Njësisë Administrative ku ato banojnë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës së Shërbimeve Publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.”

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B.me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Administratorët e Njësisë Administrative: **NJA Shënkoll-zj.L. G.**(periudha 2020-2021); **NJA Zejmen-z.Gj. M.** (periudha 2020-2021); **NJA Kolsh-F.N.**(periudha 01.01.2020-02.09.2020 larguar) dhe z. F. Z.(periudha 16.09.2020 e në vazhdim); **NJA Balldre-z. S. M.** (periudha 2020-2021); **NJA Blinisht-zj. L. M.** (periudha 2020-2021); **NJA Dajç zj.M.M.** (periudha 2020-2021); **NJA Kallmet z. B.S.** (periudha 2020-2021);

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura të arkëtimit të taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjellërim-ndriçimit nga abonentët familjar.

Situata: Referuar të dhënave të DTTV rezulton *setaksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit* (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për familjarët për vitin 2021 është realizuar 58,940 mijë lekë nga 54,900 mijë lekë e planifikuar ose në masën 107%. Kjo tregon për një planifikim jo real të bazuar vetëm në derdhjet e Agjentit tatimor UKsha Lezhë, duke përjashtuar në planifikim abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK sha.

Sipas akt-rakodimeve me UK sha debitorë për *taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit* (pastrim-gjelbërim-ndriçim) për **vitin 2021** janë 2003 familje në vlerën 8,282,513 lekë. Nga Bashkia Lezhë nuk është lidhur akt-marrëveshje me Agjentin tatimor UK sha Lezhë siç është e përcaktuar në dispozitat ligjore, në bazë të së cilës për mosrealizimet e taksës e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit nga ky agjent tatimor dhe pasi evidentondiferencat e pa mbledhura, i lind e drejta për gjobitjen e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Nga krahasimi i numrit të banesave familjare për Bashkinë e Lezhës së bashku me NJA sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke hequr numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë faturuar, si dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat, sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Lezhë rezulton se, për vitet 2020-2021 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga *taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit* për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Lezhë, pasi kanë munguar të dhënat nga DTTV dhe Administratorët e Njërive Administrative, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjiellësit, duke mos hartuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Nga përllogaritjet e përafërta për periudhën 202-2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sha, detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit rezulton ***në vlerën 105,804,400 lekë, që janë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Lezhë*** e ndarë: për **vitin 2020** për 15009 familje pa kontratë në vlerën 54,244,400 lekë dhe për **vitin 2021** për 14639 familje pa kontratë në vlerën 51,560,000 lekë

Kriteri: ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime, neni 4 pika 7, neni 35 pika 2, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 70, VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.a “Taksa e ndërtesës”.

Ndikimi/Efekti: Në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore vlera prej 20,332,301 lekë e debitorëve me kontratë dhe vlera e pa tarifuar prej 105,804,400 lekë, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore, si dhe nga DTTV e Administratorët e NJA nuk kanë marrë masa identifikimin e familjarëve taksapagues që nuk kanë kontratë me UKsha për faturimin e tyre dhe ndjekjen e arkëtimit të taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njërive Administrative, Bashkia Lezhë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartojë regjistrin përkatës me të dhënat dokumentare e të evidentuara në terren, të kryejë njoftimet për familjet taksapaguese si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Gjithashtu Bashkia Lezhë të lidhë kontratë dhe të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e **vlerës debitore prej 20,332,301 lekë** dhe nëse ka shmangie në

lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Taksa e tokës bujqësore për vitin 2021 është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve rezultojnë numri i familjeve të trajtuara me tokë është 14382 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14885.8 ha, të cilat të ndara sipas Njësive Administrative në mungesë të të dhënave të ndarjes sipas kategorisë së tokës paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela. Numri i familjeve të trajtuara me tokë

Nr.	Emërtimi i Njësive Administrative	Nr. i fshatrave	Sipërfaqja e tokës së ndarë (ha)	Sipërfaqja e tokës së dhënë me qera	Nr. i familjeve trajtuara me tokë sipas ligjit 7501	Nr. i familjeve që kanë marrë AMTP	Kategoritë e tokës sipas paketës fiskale	Niveli i taksës së tokës I përcaktuar sipas kategorive të tokës Lekë/ha/ në vit
1	BLINISHT	7	1800	0	1063		I	3920
2	KOLSH	9	1053.8	0	1211	1125	II	3430
3	KALLMET	4	1300	0	1193		III	2940
4	SHENKOLL	8	3128	0	3083		IV	2520
5	ZEJMEN	7	1811.4	6.6	1562		V	2100
6	DAJ Ç	7	1620	0	2300		VI	1680
7	SHËNGJIN	3	1445	0	1151		VII-X	1260
8	BALDRE	8	2477	0	1729			
9	UNGREJ	9	250.6	12.8	1090			
	Totali Bashkia Lezhë	62	14885.8	19.4	14382	1125		
<p>Nga përlogaritje të përafërta: 1-Nëse sipërfaqen e tokës së ndarë prej 14885.8 ha x 2100(taksa kategoria e V) = 31,260,180 lekë të pritshme- 5,105,000 lekë të realizuar në vitin 2021= 26,155,188 lekë të ardhura të munguara 2. Për vitin 2020 janë 26,680,180 lekë të ardhura të munguara nga taksa e tokës = 31,260,180 lekë të pritshme – realizimin prej 4,580,000 lekë Totali i të ardhurave të munguara për vitet 2020-2021 në vlerën 52,835,368 lekë</p>								

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë

Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, që janë sipërfaqet e tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere si në pronësi dhe në përdorim. Planifikimi nga NJA-të është totalisht i pasaktë, pasi përlogaritjet nuk janë bazuar në treguesit: sipërfaqja e ndarë, kategoria e tokës për të cilët mungojnë të dhënat në nivelin e taksës për kategori të përcaktuar në paketën fiskale.

Rregjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhornuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme (sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përlogaritjes, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me çfarë etj) si dhe nuk janë përditësuar sipas të dhënave që disponojnë Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve në Bashki (Sektori i Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastra), nga ZAMT në Qark apo nga ish-ZVRPP aktualisht ASHK Lezhë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës, për tokën në përdorim dhe për tokën në pronësi të specifikuar në kategori. NJA disponojnë evidenca të tokës gjithsej në ha, të ndarë sipas ligjit nr. 7501, normën për frymë në dynym, nr.e familjeve, sa tokë është fushë, sa tokë është kodër, sa tokë është mal, sa nga kjo tokë është ullishte, vreshtë, truall për m2, rrugë, parcela në ha, por toka nuk është e ndarë sipas kategorive të tokës bujqësore (I-VIII). Pra mungon baza e saktë e taksueshme për një planifikim real të taksës së tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24 dhe në pajtueshmëri me VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b “Taksa mbi tokën bujqësore”,

Për vitet 2020 dhe 2021 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Pra nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e evidentuar në rregjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim i të dhënave mbi bazën e të cilave janë përlllogaritur detyrimet, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, neni 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”

Meqenëse nuk ka rregjistra të saktë të familjeve fermere, që kanë detyrimin e pagesës së taksës së tokës bujqësore si dhe mos evidentimin nga specialistët e NJA të fermerëve që kanë paguar, dhe periudhën që kanë paguar, nga NJA dhe DTTV nuk disponohen të dhëna mbi debitorët dhe vlerën e detyrimit të pa paguar. Pra në këtë njësi vendore puna e DTTV e NJA-ve dhe e Sektorit të Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastra) nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës.

Sipas të dhënave, taksa e tokës bujqësore nuk është menaxhuar nga DTTV-ja si në aspektin e mbajtjes së rregjistrave, vlerësimit, njoftimit dhe ndjekjen për vjeljen e saj, si dhe kontabilizimit të saj, ndërkohë kur sipas paketës fiskale këtë taksë duhet ta ndjekë DTTV-ja. Pra specialistët e DTTV nuk kanë marrdhënie bashkëpunimi me NJA-të, pasi rregjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA-ve të Sektorit të Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastra) në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Faturimet për taksën e tokës bujqësore janë kryer nga specialistët e NJA-ve dhe pagesat e familjarëve janë derdhur pranë Bashkisë, duke u arkëtuar nga arkëtarja dhe kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV. Gjithashtu nuk është bërë kryqëzimi i rregjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b³ “Taksa mbi tokën bujqësore”, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. ligjnr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z.**A.B.** ish- Drejtor i Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, Drejtorët e Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Menaxhimit të Pyjeve z. **D. J.** (periudha 02.10.2019-01.06.2021 larguar) dhe z.**N. P.** me (periudha.02.06.2021 e në vazhdim), z.**Gj. M.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Dokumentave të Tokës

³ **Baza e taksës:** Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë. Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e katëgorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Ngarkohet sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Regjistrimit të Pronave, të saktësojë Aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme dhe ia percjell këtë informacion Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për llogaritjen e detyrimit.

Afati e pagesës : Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit të pronave, sqarojmë se për personat, që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyres së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive, sipas ligjeve në fuqi.

Përfundime nga pagesa e taksës: Përfundohen nga pagesa e taksës mbi tokën bujqësore, ato që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes

dhe Pronave (Kadastra) (periudha 22.07.2020 e në vazhdim), Administratorët e Njësite Administrative: **NJA Shënkoll**-zj.L.G. (periudha 2020-2021); **NJA Zejmen**-z.Gj. M.(periudha 2020-2021); **NJA Kolsh**- F.N. (periudha 01.01.2020-02.09.2020 larguar) dhe z. F. Z. (periudha 16.09.2020 e në vazhdim); **NJA Balldre**-z. S. M. (periudha 2020-2021); **NJA Blinisht**-zj. L. M. (periudha 2020-2021); **NJA Dajç** zj.M.M. (periudha 2020-2021); **NJA Kallmet** (periudha 2020-2021); **NJA Ungrej** z. G.K. (periudha 01.01.2020-15.07.2021 larguar) dhe z. A.Z. (periudha 21.07.2021 e në vazhdim); **NJA Kallmet** z. B. S.(periudha 2020-2021); **NJA Shëngjin** z. G. M. (periudha 01.01.2020-26.05.2021) dhe z. B. M.(periudha 27.05.2020 e në vazhdim).

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura të planifikimit dhe të arkëtimit të taksës së tokës.

Situata:*Taksa e tokës bujqësore për vitin 2021* është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%. Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhurnuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme,(sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përllogaritur, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me cfarë etj)

Për vitin 2021 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i rregjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në rregjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të të dhënave mbi bazën e të cilave janë përllogaritur detyrimet.

Referuar të dhënave që disponojnë NJA-të, të cilat janë të pa përditësuara, nga përllogaritjet e përafërta për 14665.8 ha të ndarë në 14382 familje fermere me ligjin 7501 shumëzuar me vlerën vjetore të taksës së tokës të kategorisë V-së prej 2100 lekë/ha, duke zbritur të ardhurat e realizuara rezulton vlera prej **26,680,180 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.**

Kriteri: ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24, VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b “Taksa mbi tokën bujqësore”, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 26,680,180 lekë** nga mos faturimi dhe mos arkëtimi i fermerëve për tokën e ndarë në pronësi dhe në përdorim, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Mos organizimi i mirë i punës nga menaxhimi i lartë dhe mos marrja e masave të plota për menaxhimin e taksës së tokës nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: *E lartë*

Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e rregjistrat të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke

verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK dhe Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjetnjoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Agjentët tatimorë

Në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

a. UK sha Lezhë është përcaktuar si Agjent Tatimor sipas VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, ku Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është ngarkuar për vjeljen e Tarifës së Sherbimeve Publike, ndërsa Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë rakordimin e arkëtimeve për taksat e kategorisë “familjarë” për “taksën e ndërtesës” dhe “tarifën e pastrim-gjelbërim-ndricimit” të realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit. Nga Bashkia Lezhë nuk është lidhur kontratë me këtë Agjent Tatimor në mospërputhje me VKB për miratimet e paketave fiskale. Taksa e banesës për banim është përcaktuar sipas VKM nr.132, date 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”. Duhet theksuar se Bashkia Lezhë, nuk ka krijuar një bazë të dhënash për banesat, (qoftë edhe duke përdorur bazën e të dhënave të UKsha Lezhë) apo edhe duke detyruar ZVRPP-në apo sot ASHK-ën për vënien në dispozicion të regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme sipas dispozitave të nenit 20 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nga ku të evidentoheshin personat/familjet të cilët zotërojnë 1 banesë ose më shumë se një ndërtesë banimi, pasi niveli i taksës së ndërtesave të banimit është dyfishi i nivelit të taksës për kategorinë e cila ka vetëm një banesë.

b. Për taksën e rregjistrimit të automjeteve, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRTRR)”

Nga rakordimet e bëra të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit me degën e Thesarit për derdhjet e bëra nga DRTRR Lezhë rezulton se, realizimi i të ardhurave nga taksa e rregjistrimit të automjeteve për **vitin 2020** është realizuar 36,760.9 mijë lekë nga 30,004 mijë lekë të planifikuara ose në masën 122.5 % të planit 12 mujor dhe për **vitin 2021** është realizuar 40,333.7 mijë lekë nga 32,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 126 % e planit 12 mujor. Planifikimi dhe realizimi i taksës së rregjistrimit të automjeteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2020	30,004	36,760.9	122.5
2019	32,000	40,333.7	126

c. Për tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë (DRT)”, në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të

biznesit të vogël”, i ndryshuar.

Parashikimi dhe realizimi në vlerë dhe në përqindje i të ardhurave të realizuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vite 2020-2021, referuar rakordimit të kryer nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me Degën e Thesarit, për derdhjet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë (DRT)” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2020	7,981	9,667	121.1
2021	10,000	6,025.3	60.3

Nga të dhënat e realizimi dhe planifikimit për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ku për vitin 2020 realizimi është në masën 121% dhe për vitin 2021 është në masën 60.3% , tregon për një planifikim jo real të këtij tatimi.

d. Për taksën e kalimit e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, nga *Agjenti Tatimor “Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Lezhë”(ASHK) ose ish-ZVRPP Lezhë*, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar dhe VKB nr.100, datë 22.12.2017, i ndryshuar dhe VKB nr. nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar. Nga rakordimet e bëra nga Sektori i Agjentëve Tatimorë me ASHK -në Lezhë, realizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2020 është realizuar 7,705.7 mijë lekë nga 10,003 mijë lekëtë planifikuara ose në masën 77% të planit 12 mujor dhe për vitin 2021 është realizuar 9,986.2 mijë lekë nga 7,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 142.7 % të planit 12 mujor, të paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2020	10,003	7,705.7	77
2021	7,000	9,986.2	142.7

e. Për rentën minerare, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Financave Vendore” në MFE Derdhja nga Drejtoria e Financave Vendore” në MFE e pjesës takuese të taksës kombëtare “rentë minerare”, që rezulton nga veprimtaria e guroreve në territorin e Bashkisë Lezhë në bazë të nenit 4 pika 4 të ligjit 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, të Udhezimit nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”. Realizimi i të ardhurave nga renta minerare për vitin 2020 është realizuar në shumën 249.6 mijë lekë nga 349 mijë lekë të planifikuara ose në masën 71.5% dhe për vitin 2021 është realizuar në shumën 500.3 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara e paraqitur kjo edhe në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2020	349	249.6	71.5
2021	150	500.3	333

Në lidhje me procedurën e mbajtjes së akteve të rakordimit me agjentët tatimorë, u konstatuan sa më poshtë:

Akt-rakordimet janë mbajtur vetëm me UKsha Lezhë sipas formatit të miratuar, por nuk janë protokolluar. Rakordimet japin informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve dhe përqindjen përkatëse, pa patur asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjiellës-Kanalizime, i cili vjel taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas bashkëpunimit me

Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Bashkia Lezhë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë në favor të Bashkisë Lezhë, nuk janë marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Ndërsa me asnjë nga agjentët e tjerë tatimorë nuk janë mbajtur akte rakordimi, pasi derdhjet nga këta institucione bëhen nëpërmjet Degës së Thesarit.

Nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë nuk disponohet asnjë e dhënë statistikore për sasinë e subjekteve tatimpaguese dhe detaje të tjera në lidhje me kategoritë e tatimpaguesve, në mënyrë që jo vetëm të llogariten detyrimet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, por këto të dhëna të përdoren për planifikimin real të këtyre të ardhurave si dhe për llogaritjen dhe evidentimin e detyrimeve të tjera respektive për subjektet/individët tatimpagues të shmangur nga agjentët tatimorë. Mungesa e të dhënave ka sjellë pamundësinë e kontrollit të taksave/tarifave, të cilat mbliidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, rrjedhimisht mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lezhë. Nga Bashkisë Lezhë, nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të njoftuar subjektet/individët debitorë dhe për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara. Kjo situatë ka ardhur si mungesë e bashkërendimit të punës ndërmjet institucioneve dhe Bashkisë Lezhë.

Mbi të ardhurat e realizuara nga zbatimi i kontratave të lidhura për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit:dhe pagesa e detyrimeve të subjekteve.

Për vitet 2020 dhe 2021 referuar VKM nr. 424 datë 27.05.2020 “Për një shtesë në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST), organ i ngritur sipas kësaj VKM-je, i cili ka miratuar hartën së përgjithshme për plazhet e lejuara sipas koordinatave të përcaktuara. Subjektet e interesuar kanë aplikuar në sistem elektronik të krijuar nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit, ku aplikimet janë shqyrtuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA). Subjektet e kualifikuara kanë lidhur kontrata me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkinë Lezhë, duke u pajisur me certifikatat e përdorimit të stacioneve të plazheve, ku sipas pikës 12⁴ të nenit të 14 të ndryshuar me VKM nr.424 datë 27.05.2020 përcakohet se përfitues i tarifës së qirasë nga kontrata e lidhura janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Lezhë për dhenien në shfrytëzim të hapësirave publike të plazhit kundrejt tarifave të miratuara rezultoi se ishin respektuar kërkesat e dispozitave ligjore të sipërpërmendura, kështu:

Nga Agjencia e Bregdetit dërgohen zyrtarisht pranë Bashkisë të dhëna të përditësuara për subjektet e kualifikuara paraprakisht për marrjen e stacionit të plazhit në shfrytëzim. Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban (DPTZHU) në Bashki bën konfirmimin e një kopje të dokumentacionit teknik të cdo aplikuesi si dhe përcaktimin e planvendosjes të stacionit

⁴ 12. Kontrata për dhënien në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë stacion plazhi bëhet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, me përfitues njësinë e vetëqeverisjesvendore përkatëse, sipas modelit tip, të përcaktuar në shtojcën 8, bashkëlidhur kësajrregullorejeje, dhe kanë afat 1-vjeçar, të vlefshme vetëm për sezonin turistik 202

të plazhit referuar hartës hartës së përgjithshme të miratuar për plazhet e lejuara, duke përcaktuar zonën, kategorinë dhe nivelin e tarifës sipas paketës fiskale. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pas marrjes e të dhënave nga DPTZHU bën vlerësim-njoftimin e subjektit për të gjitha detyrimet për taksa e tarifa vendore, si dhe bën faturimin e vlerës për arkëtimin e tarifës për zënien e hapësirës publike të plazhit. Pas derdhjes së tarifës nga subjektet aplikues, bëhet konfirmimi në sistemin elektronik. Pas pagesës Agjencia e Bregdetit dërgon pranë Bashkisë kontratën e lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike të plazhit me subjektet aplikues, e cila shqyrtohet nga Drejtoria Juridike dhe në fund nënshkruhet nga Titullari i Institucionit si palë e tretë e kontratës. Drejtoria Juridike mbi bazën e informacionit ka hartuar databazen me të dhënat e kontratave për cdo subjekt të certifikuar si stacion plazhi, për ndjekjen e plotësimit të detyrimeve, që lindin nga kontrata si dhe vjeljen e tarifës së qirasë në favor të Bashkisë. Sipas kësaj databaze të vënë në dispozicion rezulton se:

Për **vitin 2020** janë lidhur 86 kontrata 1-vjeçare me subjektet që u është dhënë e drejta për shfrytëzimin e hapësirave publike në zonën e plazhit prej 86320.665 m² kundrejt pagesës së tarifës së qirasë të miratuar në paketën fiskale në zonat: "Zona 1, në veri nga Rëra e Hedhur deri në jug te zona Ushtarake", "Zona 2, në veri nga Porti Shëngjin deri në jug subjekti Ara, përfshirë" "Zona 3, në veri nga subjekti Ara deri në jug Rruga e Knallës" dhe "Zona 4, në veri nga rruga e Knallës deri në jug te Kunja e vogël". Sipas të dhënave të databazes detyrimi i evidentuar është në vlerën 41,406,333 lekë dhe pagesat e kryera janë në vlerën prej 41,406,333 lekë, pasi një nga kushtet për finalizimin e kërkesave të aplikuesve për qiramërrje në lidhje kontrate është, që pas njoftimit paraprak për kualifikim nga procesi i shqyrtimit të kontratave, aplikuesi duhet të kryejë pagesën në bazë të faturimit nga njëësia vendore si dhe gjenerimin në sistem *on-line* nga subjekti të konfirmës bankare për likuidimin e kryer.

Për **vitin 2021** janë arkëtuar të ardhura në vlerën 53,020,300 lekë nga 125 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit në 4 zonat e miratuara në hartën e plazhit, mbi bazë kontratash të lidhura 1-5-vjeçare nga Agjencia e Bregdetit dhe Bashkisë Lezhë, duke aplikuar tarifën sipas zonave të zënies së hapësirave publike të plazhit të miratuar në paketën fiskale.

Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Lezhë.

Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë (periudhën 2018-2021), u konstatua se në disa raste nga Bashkia Lezhë nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë në 9 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, pasi nga Bashkia Lezhë janë lëshuar autorizime për licencim apo rinovim licence kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës në vlerën 200,000 lekë, pra në masën prej 1/5 e tarifës së miratuar për licencim prej 1,000,000 lekë, duke sjellë të ***ardhura të munguara në shumën prej 7,200,000 lekë***. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e mos aplikimit të tarifës së miratuar të licencimit prej 1,000,000 lekë në kundërshtim me pikën 9⁵ të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin

⁵ - *Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

"9. Paga për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

10. Paga për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera."

e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti	Adresa	Njesia Administrative	Fillon	pagesa	vlera	detyrimi
1	VA&VA-G	Rruga e Shtrausit, Lagje Gurra	LEZHË	16.09.2019	18.09.2019	1,000,000	
2	L.80	Rruga nacionale Lezhë - Tiranë, km-3	SHËNKOLL	16.07.2021	28.07.2021	200,000	800,000
3	A.	Rruga "Sokol Olldashi", Tale, Shënkoll	SHËNKOLL	26.10.2021	26.10.2021	1,000,000	
4	R.	Rruga nacionale Lezhë - Tiranë, km-6	ZEJMEN	14.01.2022	12.01.2022	200,000	800,000
5	P.	Rruga nacionale Lezhë - Tiranë, km-12	ZEJMEN	04.11.2021	04.11.2021	200,000	800,000
6	K.	Rruga nacionale Lezhë - Shkodër, km-9	BLINISHT	15.11.2021	16.11.2021	200,000	800,000
7	K.	Rruga nacionale Lezhë - Shkodër, km-5	BALLDRE	15.11.2021	16.11.2021	200,000	800,000
8	K.	Rruga nacionale Lezhë - Tiranë, km-0	LEZHË	15.11.2021	16.11.2021	200,000	800,000
9	G. C. GKG	Rruga "Vëllezërit Coku", Ishull-Lezhë	SHËNGJIN	14.01.2022	17.01.2022	200,000	800,000
10	G.C. GKG	Rruga nacionale Lezhë - Tiranë, km-1	LEZHË	14.01.2022	17.01.2022	200,000	800,000
11	G. C. GKG	Rruga nacionale Lezhë - Shkodër, km-1	LEZHË	14.01.2022	17.01.2022	200,000	800,000
					Shuma	3,800,000	7,200,000

Në lidhje me aplikimin pjesor të tarifës së lejes/autorizimit subjekteve private për ushtrim aktiviteti si stacione shitjeje të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, që operojnë në Bashkinë Lezhë, sipas informacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kjo procedurë është ndjekur me pretendimin se, këto pika karburanti janë në rrugë nacionale dhe në dokumentacionin e tyre mungon leja nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSH) për hyrje-daljet në rrugë nacionale, pasi do të bëhet rikonstruksion i autostradës Milot-Balldren nga koncensionar privat në vitet e ardhshme dhe nuk dihet ecuria e këtyre pikave të karburantit për afate deri në 5 vjet.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mbajtur për këto subjekte rezulton se nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit nuk është ushtruar asnjëherë kontroll në pikat e shitjeve të hidrokarbureve dhe derivateve të tij për periudhën 2018-2021, për verifikimin nëse ka pika karburanti, që ushtrojnë aktivitet pa u licencuar, si dhe nëse subjektet e licencuara që ushtrojnë aktivitet për shitjen e karburantit dhe derivateve të tij të licencuar plotësojnë kushtet për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. E. Z. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit.

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Lezhë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë (periudhën 2018-2021), u konstatua se në disa raste nga Bashkia Lezhë nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë. Sipas të dhënave të nxjerra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit rezulton se, për 9 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, Bashkia Lezhë ka lëshuar autorizime kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës të vlerës prej 200,000 lekë, pra 1/5 e tarifës së miratuar për licencim (prej 1,000,000 lekë), duke sjellë të **ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë në shumën prej 7,200,000 lekë.**

Kriteri: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 7,200,000 lekë** nga mos pagesa e plotë e tarifës së liçencë/autorizimit prej 1,000,000 lekë nga subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve.

Shkaku: Faturim i gabuar nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë për licencimin e 9 subjekteve që janë pajisë me liçencë/autorizimet, që ushtrojnë aktivitet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre

Rëndësia: *E lartë*

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, të marrë masa që të arkëtojë tarifën e plota për 9 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me liçencë/autorizimet që ushtrojnë aktivitet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, për diferencën debitore prej 7,200,000 lekë sipas tabelës së mësipërme. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Procedurat e ndjekura për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi.

Taksa e ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet e reja me leje dhe nga legalizimet e ndërtimeve informale, ku për vitin 2020 është realizuar në shumën 31,269.8 mijë lekë nga 166,337 mijë lekë të planifikuara ose në masën 18.8 %, për vitin 2021 është realizuar në shumën 133,225.3 mijë lekë nga 282,450.7 mijë lekë të planifikuara ose në masën 47.2%,

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, u auditua korespondenca shkresore e Bashkisë Lezhë me ish-ALUIZNI-in apo aktualisht ASHK, Drejtoria Lezhë, ku për vitet 2018-2021 deri me datën 30.03.2022 janë vënë në dispozicion Bashkisë Lezhë informacion me të dhënat për lejet e legalizimit të dhëna për këtë periudhë. Sipas database-s të vënë në dispozicion për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), pranë Bashkisë Lezhë sipas shkresave periodike të dërguara nga ish-ALUIZNI apo sot ASHK, Drejtoria Rajonale Lezhë rezulton se:

Janë identifikuar 1125 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit, ku për 691 legalizime ka të dhëna për detyrimet, ndërsa për 434 legalizime nuk disponohen të dhëna për sipërfaqen dhe për detyrimin. Nga 691 legalizimet e identifikuar me të dhëna, vlera e detyrimit është 26,504,380 lekë, ku nga këto kanë paguar 407 subjekte vlerën prej 18,375,997 l lekë, ***duke mbetur pa shlyer nga 284 posedues të lejeve të legalizimit për taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 8,128,383 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë, pa llogariur 434 legalizimet për të cilat nuk disponohen të dhëna dhe nuk përllogaritet dot evazioni fiskal i shkaktuar nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.***

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të nuk ka patur komunikim me ZVRPP Lezhë sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Lezhë (perfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për t'i propozuar për lidhjen e një aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe ASHK Rajonale Lezhë, me qëllim që ky institucion të bëhet barrikadë për mosdhënie të legalizimeve dhe certifikatave të pronësisë subjekteve private pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: "*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"* dhe neni 35, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të

zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe me VKB nr.46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar pika A.4.⁶ “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” nënpika 4.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z.Nik Leka me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (për periudhën shtator 2019-janar 2021) dhe z. A.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (për periudhën janar 2021 e në vazhdim).

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura të për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Lezhë.

Situata: Sipas listave të vënë në dispozicion për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), pranë Bashkisë Lezhë sipas shkresave periodike të dërguara nga ish-ALUIZNI apo sot ASHK, Drejtoria Rajonale Lezhë rezulton se:

Janë identifikuar 1125 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit, ku për 691 legalizime ka të dhëna për detyrimet, ndërsa për 434 legalizime nuk disponohen të dhëna për sipërfaqen dhe për detyrimin. Nga 691 legalizimet e identifikuar me të dhëna, vlera e detyrimit është 26,504,380 lekë, ku nga këto kanë paguar 407 subjekte vlerën prej 18,375,997 lekë, *duke mbetur pa shlyer nga 284 posedues të lejeve të legalizimit për taksën së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 8,128,383lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë, pa llogaritur 434 legalizimet për të cilat nuk disponohen të dhëna dhe rastet e tjera të paidentifikuara fare në vite, për të cilat nuk përlllogaritet dot evazioni fiskal i shkaktuar nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të nuk ka patur komunikim me ZVRPP Lezhë sot ASHK, Drejtoria Lezhë (përfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për të bashkëpunuar për arkëtimin e kësaj takse nga individët që tashmë kanë kryer legalizime dhe janë debitorë ndaj Bashkisë.

Kriteri: ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, dhe neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, VKB nr.46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar pika A.4. “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” nënpika 4.

Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 8,128,383lekë** nga mos pagesa e plotë e taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) nga individët që kanë legalizuar ndërtime informale.

Shkaku: Mos menaxhimi dhe mosndjekja e arkëtimin të taksës nga strukturatpërgjegjëse si dhe mos bashkëpunimi i fortë me ASHK, Drejtoria Lezhës dhe mos marrja e masave përevidentimin e plotë dhe parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e

⁶ Niveli i taksës: sipas kategorive dhe nën kategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë; *nënpika 4 Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi në masën 0.5% Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.*

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës : Struktura e ngarkuar përlllogaritjen dhe lëshimin e faturës për pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, pranë Bashkisë Lezhë

ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Lezhë nga subjektet private e individ për objektet në proces legalizimi.

Rëndësia: *E lartë*

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK, Drejtoria Lezhë që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Lezhë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi.

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa për evidentimin e plotë të individëve të pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale që nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për gjithë periudhën e shtrirjes së procesit të legalizimit në Shqipëri, duke hartuar një databazë të plotë me të gjitha të dhënat. Në bazë të këtij databaze të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.

Mbi të ardhurat e krijuara nga kontratat e dhenies me qira parcelave nga fondi pyjor

Nga Bashkia Lezhë lista e pronave pyje e kullota me sipërfaqe totale prej 22939 ha nuk është kryer asnjë veprim për regjistrimin dhe inventarizimin e tyre, në referencë të nenit 7, të ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007 “Për fondin kullor”, si dhe administrimi sipas rregullave, mungon inventarizimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrin e fondit kullor, në referencë të nenit 9, të ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007, i ndryshuar.

Nuk është kryer inventarizim kadastrale pyjor me synim evidentimin e përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), veprime në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

Njësia Administrative Zejmen, nga informacioni i dhënë me shkresë nr. 141/1, datë 30.03.20118, ish- Komuna Zejmen sot Njësia Administrative Zejmen ka lidhur 2 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, referuar bazës ligjore (të cituar në kontrata): ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pikat 4, 6, 7, 8, 13, 15, 16, 17, 19, 21. VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe sipas VKK të ish Komunës Zejmen.

Nga auditimi dhe të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit u konstatua se 2 qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet e kontratës për 4 vite (2018-2021), ***në vlerën 260,280 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm në buxhetin e Bashkisë Lezhë.*** Përlllogaritja e detyrimit është bërë sipas të dhënave të tabelës të paraqitur më poshtë:

Nr	Emër Mbiemri	Kontrata		Vendimi Këshillit Komunës		Sip. ha	Afati	Vlera kontratës	Pa likuiduar 2018-2021 (4 vjet)
		Nr	Datë	nr.	date				
2	Gj.M.	1091	05.05.15	47	22.12.14	0.615	10	11,070	22,140
Shuma						1.615			130,140

Nga Drejtoria e bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve në bashkëpunim me Njësinë Administrative Zejmen nuk kanë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.

Gjithashtu nga informacioni i marrë, rezulton se për sipërfaqen prej 110.677 ha nga fondi pyjor dhe kulloror ish-Komuna Zejmen e ka dhënë në përdorim 61 personave, me të cilët nuk janë lidhur kontrata qiraje në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kulloror”, ligjit nr.10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve METN”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për gjuetinë” dhe VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” dhe VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. Të dhënat për 7 kontrata për dhenien në përdorim të sipërfaqes prej 58.49 ha të cila janë akoma në fuqi paraqiten në tabelën e mëposhtme, ndërsa 54 kontratat e lidhura për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 110.618 ha janë të përfunduara, pasi afati i tyre ishte 10 vjet 2011-2020.

Nr	Emri Mbiemri	Vendimi i Këshillit të Komunës Nr.	Data Vendimit	Afati në vite	Sipërfaqe Ha
1	Gj.N Gj.	17	09.03.2010	30 vite	3.5
2	Gj. Ll. K.	18	09.03.2010	30 vite	2
3	N.P.J.	19	09.03.2010	30 vite	49.3
4	Gj.Z Gj.	20	09.03.2010	30 vite	1
5	N. J Gj.	21	09.03.2010	30 vite	1.1
6	E.N.D.	29	16.04.2010	30 vite	0.77
7	B.P.N.	30	16.04.2010	30 vite	0.82
					58.49 ha

Nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes,dhe Administrimit të Pyjeve dhe Njësia Administrative Zejmen nuk disponohej informacion në lidhje me qëllimin e dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore në zbatim të kërkesave të ligjit për mbarështimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. nuk është ushtruar kontroll për zbatimin e kushteve të kontratës si dhe nuk janë mbajtur akt rakordimi për kontrata e lidhura për sipërfaqet që kanë pastruar, sa dru zjarri kanë marrë për nevojat e veta etj.

Njësia Administrative Kolsh, nga informacioni i dhënë me shkresë nr. 94/1, datë 29.03.20118, ish Komuna Kolsh sot Njësia Administrative Kolsh ka lidhur 38 kontrata të panoterizuara dhe pa vlerë, me afat 10-vjecar për dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjor dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera. Nga këto 32 kontrata kanë përfunduar ndërsa 6 kontrata përfundojnë në vitin 2022-2023. Gjithashtu në vitin 2021 janë lidhur 2 kontrata për vendosje antene. Të dhënat e tyre, përlllogaritjet e detyrimeve për këto 8 kontrata, pagesat e kryera si dhe vlera debitore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti	Ekonomia Pyjore	Nr Kont rates	Data e Kontrates	Sip. Ha	Afati vjet	Vlera e kontratës e përlllogaritur sipas VKM 1064 18000 lekë/ha/nëvit	Likujduar			Debitor deri me 2021	Aktiviteti	Njoftime me shkresat
								2019	2020	2021			
1	G.L.	Molung	120	27.03.2013	2.5	10	44,280	44,280	44,280	44,280	132,840	Permiresim	21.03.2019
2	Gj.P.	Molung	109	17.02.2012	0.8	10	14,580	14,580	14,580	14,580	43,740	Permiresim	21.03.2019
3	N. N.	Molung	325/1	20.12.2012	0.2	10	4,320	4,320	4,320	4,320	12,960	Permiresim	21.03.2019
4	A. P.	Molung	235	23.04.2012	2.5	10	45000	45000	45000	45000	135000	Permiresim	21.03.2019
5	N. V.	Molung	212	11.04.2012	2	10	36,000	36,000	36,000	36,000	108,000	Permiresim	21.03.2019
6	A. V.	Molung	211	11.04.2013	2.3	10	41,400	41,400	41,400	41,400	124,200	Permiresim	21.03.2019
7	G. 2	Mal Rrenc	13392/1	02.12.2021	9.8	2					po	Reha ruge	

8	K.O.	Brinjat e Kreshtes e Hajmel	16348/3	01.10.2021	2	2				po		Vendosje anemometri
										Shuma	556,740	

Referuar tabelës së mësipërme se rezulton se për 6 fermerët, që kanë lidhur kontrata pa vlerë për shfrytëzimin e parcelave nga fondi pyjor-kullor **detyrimet e papaguara për vitet 2019-2020-2021 është në vlerën 556,740 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë**, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriteve të administrimit të pyllit komunal” detyrimet e 38 kontratave për sipërfaqen 86.92 ha të llogaritura sipas VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”i ndryshuar, neni 446.

Për të gjitha kontratat për dhënien në përdorim si ato të përfunduar dhe ato akoma në fuqi Bashkia Lezhë nëpërmjet Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve dhe Rregjistrimit të Pronave në Drejtorinë Juridike nuk ka kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), veprime në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Drejtorët e Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Menaxhimit të Pyjeve z. **D. J.** (periudha 02.10.2019-01.06.2021 larguar) dhe z.**N.P.**me (periudha.02.06.2021 e në vazhdim), z.**Gj. M.**me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Dokumenteve të Tokës dhe Pronave (Kadastra) (periudha 22.07.2020 e në vazhdim), **kryetarët e Njësi Administrative Zejmen**-z.Gj. M. (periudha 2020-2021); **NJA Kolsh**- F. N.(periudha 01.01.2020-02.09.2020 larguar) dhe z. F.Z. (periudha 16.09.2020 e në vazhdim);

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga qiramarrja e parcelave nga fondi pyjor, pronë e Bashkisë Lezhë

Situata: Nga auditimi i 2 kontratave të lidhura ish-Komuna Zejmen në vitet 2013-2015 për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme dhe të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit u konstatua se 2 qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet e kontratës për 4 vite (2018-2021), **në vlerën 260,280 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm nëbuxhetin e Bashkisë Lezhë**. Gjithashtu nga ish-Komuna Zejmen në vitin 2020 ka lidhur 7 kontrata jashtë formatit tip të kontratës, me afat 30 vjet për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 58.49 ha nga fondi pyjor dhe kullor, të cilave u mungon vlera të tarifës së qirasë, si dhe qëllimi i dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore. Nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqeje Bashkia nuk arkëton të ardhura, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë i cili është i pallogaritshëm. Nga ish-komuna Kolsh dhe sot NjA Kolsh janë lidhur 8 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjor dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera si dhe vendosje antene. Nga këto 6 kontrata janë lidhur në vitet 2012-2013, me afat 10 vite dhe pa vlerë, për të cilat është përlllogaritur për 4 vitet (2018-2019-2020-2021) **një vlerë debitore prej 556,740 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Lezhë**. Ndërsa 2 kontrata janë lidhur në vitin 2021 me afat 2 vjet, të cilat kanë likuiduar detyrimet kontraktore. Për të gjitha fermerët që kanë në përdorim parcela pyjore si për ato raste që u ka përfunduar afati dhe për ato kontrata akoma në fuqi, por nuk paguajnë nga Bashkia Lezhë nuk është kryer asnjë procedurë administrative apo ligjore për detyrimin e pagesës apo marrjen mbrapsht të parcelave, duke anuluar VKK apo kontratat.

Kriteri: Nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, Manuali i Mbarështimit të Pyjeve, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”.

Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për qiradhënie të parcelave nga fondi pyjor

Shkaku: Puna e pa mjaftueshme e strukturave përgjegjëse.

Rëndësia: *E lartë*

Rekomandim: Bashkia Lezhë, të ngrejë një grup pune për verifikimin e parcelave nga fondi pyjor dhënë në përdorim nëpërmjet VKK apo kontratave individëve të ndryshëm, të bëjë saktësimin e të dhënave për sipërfaqet dhe të dhënave të tjera kadastrale, si dhe të identifikojë se për çfarë qëllimi përdoren. Të rishikojë akt-marrëveshjet dhe kontratat në fuqi dhe të negociohet për ndryshimin e kushteve nëpërmjet amendimit të kontratave fillestare. Për kontratat e përfunduara të kryhen veprimet për marrjen në dorëzim të parcelave pyjore, pas detyrimit të individëve që i kanë patur në shfrytëzim të kthimit të sipërfaqeve në gjendjen fillestare.

Rekomandim: Bashkia Lezhë të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore në vlerën 260,280 lekë nga dy qiramarrësit e parcelave pyjore Z. N. në vlerën 108,000 lekë dhe Gj. M. në vlerën 22,140 lekë

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Drejtorët e Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Menaxhimit të Pyjeve z. **D. J.** (periudha 02.10.2019-01.06.2021 larguar) dhe z.**N.P.** me (periudha.02.06.2021 e në vazhdim), z.**Gj. M.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastra) (periudha 22.07.2020 e në vazhdim), **kryetarët e Njësisë Administrative Zejmen**-z.Gj. M. (periudha 2020-2021); **NJA Kolsh**-F.N. (periudha 01.01.2020-02.09.2020 larguar) dhe z. F. Z. (periudha 16.09.2020 e në vazhdim);

2.4. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.

4.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

4.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;

4.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të vitit 2021 të shoqëruar me formatet 1-9.

-Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

- Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2021, libri i aktiveve.

- Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2021

- Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Lezhe në mbyllje të vitit buxhetor 2021.

-Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet,per ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Lezhë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur ne ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e MFE nr. 46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2021”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Lezhë, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Lezhë për vitin 2021 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi përveç Bashkisë Lezhë ka në varësi njësinë shpenzuese Shoqërinë Publike të Klubit të Sportit “Besëlidhja” me nipt të vecantë e cila, i depoziton PF në Degën e Thesarit Lezhë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 103.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Lezhë për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr.prot.4355 datë 31.03.2022. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Finances. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të këtyre detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Alpha web ”
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përkrahja me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Konkluzion: Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditaret në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **pika 2.2** “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik”, ku ndër të tjera theksohet se: “....- *Libra kontabiliteti, ditare kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.- Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme*” Kreu III, **pika 3.2** “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësisë të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon: **Nënpika 43.** Fillimisht, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditaret përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore. **Nënpika 44.** Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”. **Nënpika 45.** Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i*

pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.

Titulli gjetjes: *Mbi mbajtjen e librave kontabël për evidentimin e veprimeve kontabël nga ditarët në bilanc.*

Situata: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Kriteri: Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45.

Impakti: Pasaktësi në nxjerrjen e gjendjeve dhe pozicionimi i llogarive të bilancit.

Shkaku: Nga drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk është kryer procedurë e plotë në mbajtjen e kontabilitetit dhe të gjithë librave kontabël që të evidentojnë në cdo fazë këtë procedurë.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Lezhë të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, dhe në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Lezhë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.3 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2021”.

A.Totali i Aktivit për vitin 2020 është në vlerën 9,636,212,715 lekë dhe për vitin 2021 është 10,523,408,890 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	10,523,408,890	9,636,212,715
2		I.Aktivët Afat shkurtër	2,163,894,354	2,097,497,242
3		1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	799,097,875	726,146,560
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	798,481,575	721,232,243
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera	616,300	4,914,317
9	54	Akreditiva dhe parashenja		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	77,938,943	68,723,511
12	31	Materiale	10,002,698	13,181,235.75
13	32	Inventar i imet	67,936,245	55,542,275
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbritura, ose pranë të treta		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	1,013,229,718	996,318,277
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, parashenja, deficite, gjoha		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetore		
29	437,438,	Organizma të tjera shtetore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitore të ndryshëm	923,488,685	896,803,545
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	89,741,032.8	99,514,732.48
34	45	Mardhenie midis institucion apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlersim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	273,627,818	306,308,894
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shperndare në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	273,627,818	306,308,894
42		II.Aktivët Afat gjatë	8,359,514,536	7,538,715,472
43	20	1.Aktive Afatgjatë jo materiale	16,496,609	19,407,775
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	16,496,609	19,407,775
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjatë materiale	6,211,259,116	6,304,659,182
48	210	Toka, T,roje, Terene	1,085,472,103	1,085,472,103
49	211	Pyje, Plantacione	33,419,030.95	35,177,926.95
50	212	Ndertesë e Konstruksione	3,138,308,660	3,204,084,931
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,843,984,301.9	1,831,990,172.90
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	14,186,538.8	17,019,015.8
53	215	Mjete Transporti	22,397,031.8	27,126,288.80
54	216	Rezerva Shtetore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	73,491,450	103,788,744
57	24	Aktive afatgjatë të demtuara		
58	28	Katime të Aktiveve Afatgjatë		
59	25-26	3.Aktive Afatgjatë Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet		
62		4.Investime	2,131,758,811	1,214,648,515
63	230	Per Aktive Afatgjatë jo materiale	85,041,663	65,785,632
64	231	Per Aktive Afatgjatë materiale	2,046,717,148	1,148,862,883

B. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 726,146,560 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 799,097,875 leke.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 721,232,243 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është 798,481,575 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 616,300 lekë. Këto gjendje përfaqësojnë vlerën e letrave me vlerë gjendje ne arke, ku përfshihen biletat e memorialit te policise bashkiake, pullat e gjendjes civile etj . Këto letra me vlerë janë bërë hyrje në arkë me çmim shitje dhe janë kryer veprimet kontabël, ku për hyrjet në arkë nga blerjet është debituar llog 532 “Vlera të tjera” në kredi të llog 63 “Ndryshim i gjendjeve” dhe për arkëtimet është debituar llog. 531 “Arka” në kredi të llogarive të klasës 7. Gjendja e letrave me vlerë ne 31.12.2021 është 616,300 leke, e cila paraqitet ne llogarine 480 ne pasiv, e analizuar si me poshtë:

Emërtimi	Nr. blloqesh	Nr.fletesh/bllok	Cmimi/flete	Vlera ne leke
Bileta memoriali		1,017	200	203,400
		1,111	100	111,100
Gjoha Policia Bashkiake		480	14	6,720
		400	28.8	11,520
Pulla takse		180	200	36,000
		4500	50	225,000
Vertetim Pyjet.pub.		240	56	13,440
Vertetim pyjet privat		120	76	9,120
Shuma				616,300

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 68,723,511 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 77,938,943 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 9,215,432 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi I gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 13,181,235.75 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 10,002,698 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 3,178,537.75 lekë, e cila përfaqëson ulje te gjendjes se mallrave ne fund te vitit 2021. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2021 në shumën 10,002,698 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 55,542,275 lekë dhenë mbyllje të vitit ushtrimor 2021 me vlerë 67,936,245 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 12,393,970 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imët per vitin 2021.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 996,318,277 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2021 me vlerë 1,013,229,718 lekë, gjendje e cila ka pësuar rritje në vlerën 16,911,441 lekë krahasuar me vitin paraardhës. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve të papaguara nga bizneset për taksat dhe tarifat vendore.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 896,803,545 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 923,488,685 lekë. Vlera e debitorëve ne vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje prej 26,685,140 lekë, në të cilën ka ndikuar rritja e debitorëve të taksave. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarisë 468“Debitore te ndryshëm” me date 31.12.2021

Nr	Emërtimi	Vlera në lekë	Nr	Emërtimi	Vlera në lekë	Nr	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Debitore te ndryshe	-523,156	48	Pr. M. (urbanistika)	55,000.00	95	"N."sh.p.k	681,184.00
2	Gj. J.	247,256.00	49	N.T.	55,000.00	96	"G.-AL" sh.p.k	7,557,482.00
3	A. B.	56,235.00	50	A. L.	35,400.00	97	A.D.	1,345,200.00
4	M. L.	3,000.00	51	A. S.	2,754,000.00	98	V. B.	1,345,200.00
5	Gj. D.	14,000.00	52	P.Gj.	295,030.00	99	P. L.	363,050.00
6	F. K.	14,000.00	53	P.G.	80,410.00	100	E.M.	363,050.00
7	Gj.P.	14,000.00	54	M.T.	367,580.00	101	"K." sh.p.k	560,448.00
8	F.B.	28,620.00	55	D. A.	91,494.00	102	M.P.	3,665,615.00
9	E.B.	6,000.00	56	E.Sh.	46,754.00	103	"A." sh.p.k	201,705.00
10	Rr. M.	1,500.00	57	P. C.	264,943.00	104	V.N.	277,974.00
11	P. Gj.	18,217.00	58	S. H.	78,666.00	105	"A." sh.p.k	1,210,543.00
12	Gj. B.	4,768.00	59	T. K.	15,000.00	106	"U. L."shpk nga KLSH	15,609,000.00
13	M.Nd.	27,457.00	60	N.LI.	489,480.00	107	"A. Vizion Konstruks	9,747,743.00
14	V.Xh.	9,310.00	61	M. D.	734,994.00	108	N. C.	80,000.00
15	A. N.	19,366.00	62	Z.N.	3,000.00	109	T.M.	150,000.00
16	G. C.	8,770.00	63	A.D. "D."sh.p.k	717,370.00	110	Nj.Ad.Zejmen debi biznesi	3,303,375.00
17	Rr.T.	346.00	64	D.H.S."sh.p.k.	341,000.00	111	Njv. Shenkoll	5,975,406.00
18	I.L.	400.00	65	Rr.P."G."sh.p.k	136,905.00	112	Nj.Ad.Shenk debi biznesi	5,649,500.00
19	L. L.	528.00	66	D.M."J..sh.p.k	4,360,355.00	113	Njv. Shengjin	53,159,675.00
20	A. H.	150.00	67	P.P."M." sh.p.k	708,530.00	114	Njv. Kolsh	2,745,188.00
21	N. P.	1,200.00	68	B. B.gjobe APP	50,846.00	115	Nj.Ad.Kolsh debit biznesi	270,368.00
22	B. A.	339,900.00	69	P.M. gjobe APP	80,000.00	116	Njv.Balldre	5,625,768.00
23	M.S.	108,800.00	70	P.S. gjobe APP	80,000.00	117	Nj.Ad.Blinisht debi biznesi	1,485,253.00
24	N. M.	142,200.00	71	P. Sh.	52,773.00	118	Colacem-Alb.Balldre KLSH	423,235,000.00
25	V. , Z. V.	10,000.00	72	P. P.	58,387.00	119	Debitor Njv. Kallmet	182,054.00
26	A.e G.Nd.	1,165,321.00	73	T.T.A.A.-Lam	4,113,386.00	120	Nj.Ad.Kallmet debi biznesi	41,000.00
27	S.M.	6,306,881.00	74	L. "80"	40,074.00	121	Nj.Ad.Dajc debitor biznesi	134,793.00
28	K. I.	913,100.00	75	Televizioni Lezha	2,494,800.00	122	Debitor Bisnesi i Vogel	110,169,492.90
29	N. Sh.	989,200.00	76	D. J.	30,000.00	123	Debitor Bisnesi i Madh	120,941,375.50
30	A. L.	121,800.00	77	Z. I Klubi Ekologjik	50,400.00	124	Debitor Kopeshti Gurra	137,893
31	A. V.	224,800.00	78	E. Nd.	33,600.00	125	Debitor Kopesht Skenderbeg	9,675
32	P.P.	1,239,000.00	79	N. K.	489,480.00	126	Debitor Kopeshti Beslidhja	677,958
33	D.K.	136,600.00	80	N. P.	489,480.00	127	Debitor Çerdhja	136,105
34	Xh.M.	28,100.00	81	V. G.	100,000.00	128	Prokuria (akt-ekspertize)	2,975,000.00
35	LI. Gj..	37,400.00	82	I. D.	50,000.00	129	J. Zhupa	100,000.00
36	A.P.	43,600.00	83	Zh. K.	50,000.00	130	N. K.	150,000.00
37	A.M.	60,400.00	84	I. & K.	91,217.00	131	F.M.	150,000.00
38	" M. " SH.P.K	5,263,900.00	85	A. P.	100,000.00	132	S.L.	150,000.00
39	L.D.	225,300.00	86	V.L.-Kallmet	33,605.00	133	E. O.	150,000.00
40	Gj.M.	123,900.00	87	A.D.	40,000.00	134	N. LI.	150,000.00
41	P. L.	97,700.00	88	E. H.	30,000.00	135	N. Z.	50,000.00
42	B.D.	115,800.00	89	R. B.	50,000.00	136	D. M.	50,000.00
43	T. P.	32,100.00	90	T.N.	165,000.00	137	R.Gj.	20,000.00
44	K.P.	61,200.00	91	Gjoba inpektoriat. ndertimi.	86,498,780	138	Gj. P.	20,000.00
45	F.T.	4,592,900.00	92	A. & E.-G Shpk	235,410.00	139	L.Shpk	20,000.00
46	P. Gj.- KLSH.	114,100.00	93	"L. 2007" shpk nga KLSH	744,000.00	140	E.N.	20,000.00
47	V. V.	44,400.00	94	"S.E.P GJ." sh.p.k KLSH	305,415.00	141	Debitor Institucione	4,331,150
	Shuma	22,490,369		Shuma	108,187,564		Shuma	785,374,223.40

Shtesa debitorësh për vitin 2021

Nr	Emërtimi	Vlera në lekë	Nr	Emërtimi	Vlera në lekë	Nr	Emërtimi	Vlera në lekë
142	Debitor pronar biznesi per taksat	7,250,861.5	144	Debitor sherbimi social D. M. D.	26,400	146	Debitor sherbimi social E. P. Ç	7,200
143	Debitor sherbimi social A. F. H.	20,460	145	Debitor sherbimi social K. T. U.	3,600	147	Debitor Konvikti	128.007
	Shuma	7,271,321.5		Shuma	30,000		Shuma	135,207
							TOTALI	923,488,684.9

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 “ Debitorë të ndryshëm” të paraqitur në fund të vitit 2021 në vlerë progresive prej 923,488,684.9 lekë konstatohet se, pjesa më e madhe e debitorëve është krijuar në vite të hershme, kë në fund të vitit 2020 është në vlerën 785,374,223 lekë dhe shtesë për vitin 2021 është në vlerën 7,436,528 lekë, ku 7,250,861 lekë janë debitorë nga taksat dhe tarifat vendore dhe 165,207 lekë janë debitorë të që vijnë nga shërbimi social dhe konvikti i shkollës. Për pjesën më të madhe të debitorëve të evidentuar në kontabilitet në periudhën para vitit 2020, megjithëse vërehen vlera të konsiderueshme për

individë dhe për subjekte private nuk disponohen të dhëna të sakta se nga janë krijuar, se për çfarë janë debitorë, pasi nuk disponohet dokumentacion. Nga këto, vetëm një pjesë dihet objekti i debisë si:

1. Debitorët e institucioneve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 4,331,150 lekë.
2. Gjobat e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 86,498,780 lekë.
3. Debitorë të ndryshëm në vlerën 54,212,264 lekë, të krijuara para vitit 2009 të lëna si detyrime nga auditi i jashtëm, për të cilat nuk disponohet dokumentacion.
4. Debitorë biznesi i madh në vlerën 120,941,375.50 lekë
5. Debitorë biznesi i vogël në vlerën 110,169,492.90 lekë

- Shoqëria "C. –A." shpk ish-Komunën Balldren, detyrim në vlerën 423,235,000 lekë i lënë nga KLSH në auditimin e kryer në vitin 2016 për periudhën e vitit 2015 e para tij në lidhje me qirdhënien e aseteve, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka pushuar çështjen, duke e vlerësuar se nuk ka dëm ekonomik. Ndërsa Avokatura e Shtetit nuk ka ofruar ndihmë sipas rekomandimit fillestar nga KLSH dhe për këtë arsye në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të ushtruar në vitin 2019, nga KLSH ky rekomandim është vlerësuar i pa zbatueshëm. Nga Bashkia Lezhë nuk është vepruar ligjërisht për reflektimin e veprimeve në kontabilitet.

Për një pjesë të madhe të këtyre debitorëve nuk disponohet dokumentacion, por nga të dhënat verbale këto detyrime debitorë janë detyrime të lëna nga rekomandimet e auditëve të jashtëm në vite.

Vlera progresive prej **923,488,684.9** lekë e debitorëve në fund të vitit 2021 është një vlerë e konsiderueshme, e cila kërkon një klasifikim të tyre në debitorë pa shpresë arkëtimi dhe debitor të arkëtueshëm, ku për këto të fundit të merren masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e tyre. Për debitorët nga taksat dhe tarifën për biznesin dhe familjarët nuk disponohen të dhënatë sakta, pasi nuk disponohen të dhëna që nga fillimi e deri më tani të krijimit të debive të tyre me të dhënat se për çfarë lloje taksash dhe tarifash janë debitorë. Gjithashtu raportet e gjeneruara nga pogrami ku mbahet sistemi i taksave dhe tarifave nuk ka funksionuar dhe nuk ka saktësi. Mossaktësia e evidentimit dhe mungesa e dokumentacionit mbështetës mbi të cilat është kryer kontabilizimi i këtyre debitorëve e për rrjedhim mungesa e një analize të tyre si dhe për çfarë janë krijuar janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pikat 3.3 dhe 4.2.

Titulli gjetjes: Mbi saktësinë e evidentimit të debitorëve në llog. " *Debitorë të ndryshëm* "

Situata: Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 468 " Debitorë të ndryshëm" të paraqitur në fund të vitit 2021 në vlerë progresive prej 923,488,684.9 lekë konstatohet se, pjesa më e madhe e debitorëve është krijuar në vite të hershme, kë në fund të vitit 2020 është në vlerën 785,374,223 lekë dhe shtesë për vitin 2021 është në vlerën 7,436,528 lekë, ku 7,250,861 lekë janë debitorë nga taksat dhe tarifën vendore dhe 165,207 lekë janë debitorë që vijnë nga shërbimi social dhe konvikti i shkollës. Për pjesën më të madhe të debitorëve të evidentuar në kontabilitet në periudhën para vitit 2020, megjithëse vërehen vlera të konsiderueshme për individë dhe për subjekte private nuk disponohen të dhëna të sakta dhe se nga janë krijuar, se për çfarë janë debitorë, pasi nuk disponohet dokumentacion. Nga këto, vetëm një pjesë dihet objekti i debisë si:

1. Debitorët e institucioneve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 4,331,150 lekë.
2. Gjobat e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 86,498,780 lekë.

3. Debitorë të ndryshëm në vlerën 54,212,264 lekë, të krijuara para vitit 2009 të lëna si detyrime nga auditi i jashtëm në vite, për të cilat nuk disponohet dokumentacion.

4. Debitorë biznesi i madh në vlerën 120,941,375.50 lekë

5. Debitorë biznesi i vogël në vlerën 110,169,492.90 lekë

- Shoqëria "C.-A." shpk ish-Komunën Balldren, detyrim në vlerën 423,235,000 lekë i lënë nga KLSH në auditimin e kryer në vitin 2016 për periudhën viti 2015 e para tij në lidhje me qirdhënien e aseteve, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka pushuar çështjen, duke e vlerësuar se nuk ka dëm ekonomik. Ndërsa Avokatura e Shtetit nuk ka ofruar ndihmë sipas rekomandimit fillestar nga KLSH dhe për këtë arsye në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të ushtruar në vitin 2019, nga KLSH ky rekomandim është vlerësuar i pa zbatueshëm. Nga Bashkia Lezhë nuk është vepruar ligjërisht për reflektimin e veprimeve në kontabilitet.

Vlera progresive prej **923,488,684.9** lekë e debitorëve në fund të vitit 2021 është një vlerë e konsiderueshme, e cila kërkon një klasifikim të tyre në debitorë pa shpresë arkëtimi dhe debitor të arkëtueshëm, ku për këto të fundit të merren masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e tyre. Për debitorët nga taksat dhe tarifatat për biznesin dhe familjarët nuk disponohen të dhëna të sakta, pasi nuk disponohen të dhëna që nga fillimi e deri më tani të krijimit të debiteve të tyre me të dhënat se për çfarë lloje taksash dhe tarifash janë debitorë. Gjithashtu raportet e gjeneruara nga programi ku mbahet sistemi i taksave dhe tarifave nuk ka funksionuar dhe nuk ka saktësi.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 3.3" Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën pika 8 dhe i llogarive të klasës 5.

Impakti: Moskontabilizimi i saktë i vlerës së debitorëve të taksave dhe tarifave vendore ndikon në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, duke paraqitur risk në besueshmërinë e tyre.

Vlerat e konsiderueshme të debitorëve, e sidomos të debitorëve të tjerë të krijuar para shumë viteve dhe pa shpresë arkëtimi kanë rënduar llogaritë e arkëtueshme të bilancit.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara si dhe nuk janë marrë masa për klasifikimin e debitorëve në kohë dhe dokumentacion, duke përjashtuar debitorët e taksave dhe tarifave vendore, në debitorë pa shpresë arkëtimi dhe në debitorë të arkëtueshëm dhe ndjekjen e procedurave ligjore për parashkrimin e tyre.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Rekomandim: Strukturat Drejtuese nëpërmjet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të marrë masa për klasifikimin e debitorëve të tjerë referuar kohës së krijimit dhe ekzistencës së dokumentacionit ligjor shoqëruar, në debitorë pa shpresë arkëtimi (mbi 10 vjet) dhe në debitorë të arkëtueshëm. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të paraqiten në Këshillin bashkiak, duke ndjekur procedurat ligjore për parashkrimin e tyre dhe më pas kryerjen e

veprimeve kontabël përkatës. Ndërsa për debitorët e klasifikuar të arkëtueshëm të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjorë për arkëtimin e detyrimeve nga të tretët.

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 89,741,032.8 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021, që trashëgohen në vitin 2022. Kjo gjendje në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 28,060,688 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,654,833 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 8,224,529 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 1,141,769 lekë dhe llog.437 “Sigurime suplementare” për vlerën 93,437 lekë, llog. 401 “Furnitore”ne vleren 50,565,776.8 leke dhe llogaria 404 “Furnitore per investime”ne vleren 0 leke”.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 306,308,894 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 273,627,818 lekë. Gjendja e kësaj llogarije rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti në pasiv të bilancit 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuarra dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçodon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuarra;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjatë**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe (gjendjen e llog 23I “Investime”). Gjendja në total paraqitet në në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 6,304,659,182 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,211,259,116 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 8,071,572,441 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,295,518,753 lekë, të cilat janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjatë jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **19,407,775** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **16,496,609** lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhenë mbyllje të vitit në vlerën 38,396,671 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

	Llogaria 202		Gjendja me 31.12.2020	Shtesa	Gjendja me 31.12.2020
1	Studim projektme gjendje nga viti 2009	Studim projektim	2,130,600	-	2,130,600
2	Ministria e mjedisit (sherbim per leje)	Studim projektim	50,000	-	50,000
3	Sherbimi Gjeologjik Tirane	Studim projektim	95,530	-	95,530
4	IEUM Tirane Studim (fature sherbimi)	Studim projektim	48,580	-	48,580
5	OSSH ZONA Shkoder	Studim projektim	3,600	-	3,600
6	OSSH tarife per leje ndertimi	Studim projektim	3,600	-	3,600
7	Drejtoria e sherbimit publik	Studim projektim	18,000	-	18,000
8	MMOAU Tirane autorizim	Studim projektim	40,000	-	40,000
9	A.P.(matje topog)	Studim projektim	30,000	-	30,000
10	K. "SHPK"	Studim projektim	2,988,000	-	2,988,000
11	G. SHPK	Studim projektim	192,000	-	192,000
12	Regjistrim Komuna Zejmen	Studim projektim	831,000	-	831,000
13	Regjistrim Bilanci komuna Shenkoll	Studim projektim	1,053,000	-	1,053,000
14	Regjistrim Bilanci Komuna Shengjin	Studim projektim	16,572,417	-	16,572,417
15	Regjistrim Bilanci Komuna Balldre	Studim projektim	8,739,637	-	8,739,637
16	Regjistrim Bilanci Komuna Kallmet	Studim projektim	123,500	-	123,500
17	Regjistrim Bilanci Komuna Daje	Studim projektim	2,576,021	-	2,576,021
18	Hyrjet mag. Industriale	Studim projektim	1,321,586	-	1,321,586
19	A.shpk Projekte per rikonstrukcion	Studim projektim	1,169,600	-	1,169,600
20	Hartim projekti MZSH /Stacioni	Studim projektim	410,000	-	410,000
	Gjendja		38,396,671	-	38,396,671

Inventari kontabël i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” me date 31.12.2021

Konkluzion: Referuar analizës së llog.202 “Studime dhe kërkime” rezulton se, në gjendjen e saj prej 38,396,671 lekë është përfshirë një vlerë prej 2,130,600 lekë e emërtuar studim-projektme gjendje nga viti 2009, për të cilën nuk disponohen të dhëna se për çfarë projekt-studimesh bëhet fjalë. Gjithashtu në këtë llogari janë përfshirë aktive jo materiale, të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarije, pasi nga përshkrimi i shpenzimit ato janë blerje shërbimesh apo mallrash. Pra kontabilizimi i këtyre transaksioneve financiare në llog. 202 “Studime dhe kërkime” është i pasaktë, veprime kontabël këto të trashëguara nga vitet 2009-2010-2011, të cilat në mungesë të dhënave e dokumentacionit nuk janë kryer veprime rregulluese në kontabilitet. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, Klasa 2 “Aktivët Afatgjatë” (Përbërja dhe trajtimi kontabël), Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nën-pika 62. Nënpika “Aktivët afatgjatë

jomateriale” përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licensat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM ashtu edhe të AAGJ/JM. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM nëse është pjesë përbërëse e paisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM. Trajtimet kontabël për AAGJM, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit si dhe vlerësimin e mëpasshëm: a) Njohja fillestare - AAGJM duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë: • Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit; 35 • Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementëve të aktivitetit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementëve të aktivitetit, materiale të përdorura për këta elementë, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi, etj).

Nënpika 62 ndër të tjera përcakton: “Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivitet afatgjatë, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: • Nënrubrika e aktiveve afatgjatë jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;...”

Titulli gjetjes: Mbi saktësinë e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, veprimet kontabël të kryera në këtë llogari dhe analiza e saj.

Situata: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto prej 16,496,609 lekë. Referuar analizës së llog.202 “Studime dhe kërkime” rezulton se, në gjendjen e saj prej 38,396,671 lekë është përfshirë një vlerë prej 2,130,600 lekë e emërtuar studim-projektme gjendje nga viti 2009, për të cilën nuk disponohen të dhëna se për çfarë projekt-studimesh bëhet fjalë. Gjithashtu në këtë llogari janë përfshirë aktive jo materiale, të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie, pasi nga përshkrimi i shpenzimit ato janë blerje shërbimesh apo mallrash. Pra kontabilizimi i këtyre transaksioneve financiare në llog. 202 “Studime dhe kërkime” është i pasaktë, veprime kontabël këto të trashëguara nga vitet 2009-2010-2011, për të cilat në mungesë të dhënave e dokumentacionit nuk janë kryer veprime rregulluese në kontabilitet.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjatë” (Përbërja dhe trajtimi kontabël), Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. nënpika “Aktivet afatgjatë jomateriale”.

Ndikimi/Efekt: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjatë dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjatë Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës nuk është kryer e mjaftueshme për kryerjen e veprimeve rregulluese të kësaj llogarie.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të identifikojë nëse është e mundur projektet që i përkasin vlerës së pa analizuar prej 2,130,600 lekë dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektmeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse. Gjithashtu të kryejë veprimet sistemuese kontabël për aktivitetet e klasifikuara gabim në gjendjen e kësaj llogarie, duke i kaluar me artikull kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve që u takojnë.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2021.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 6,211,259,116 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **8,295,518,753**. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja ellog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 dhe 2021 në shumën totale prej 1,085,472,103 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 1,085,472,103 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2021

Nr.	Emertimi I Aktiveve	Vlera 31.12.2020	Shtesa 2021	Pakesime 2021	Vlera 31.12.2021
1	Toka e troje	1,050,872,186			1,050,872,186
2	Sist. Blloku Lumi Drin	17,901,249			17,901,249
3	Ndertim Trotuari Lagjia Gurra	838,782			838,782
4	Sist. Blloku Sh. Ushatarakeve	1,802,938			1,802,938
5	Sist. Blloku Lagjia Gurra	7,959,448			7,959,448
	Shuma Toka Troje 210 Bashkia	1,079,374,603	-	-	1,079,374,603
6	Kend sp+rrreth shkoll	599,500			599,500
7	" " ' K. Vog.	600,000			600,000
	Totali Kallmet	1,199,500			1,199,500
8	Toka Varreza	1,998,000			1,998,000
	Shuma Toka 210 Kolsh	1,998,000			1,998,000
9	Toke Varreza	2,900,000			2,900,000
	Totali Llogaria 210 Shenkoll	2,900,000			2,900,000
	Totali Bashki +Nj. Adm 210	1,085,472,103	-	-	1,085,472,103

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 1,085,472,103 lekë në fund të vitit 2021, konstatohet se përfshihet një vlerë prej 1,050,872,186 lekë e cila nuk është e detajuar dhe mungojnë të dhënat se çfarë përfaqëson në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në mbyllje të vitit 2020 në vlerën neto prej 35,177,926.95 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerë 33,419,030.95 lekë. Ndërsa, sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 56,275,100 lekë. Për këto aktive nuk është kryer inventar për verifikimin dhe krahasimin me inventarin kontabël. Analiza e gjendjes së kësaj llogarije paraqitet në tabelën e mëposhtme

Nr.	Emertimi I Aktiveve	Gjendje	Shtesa	Paksime	Gjendje
		31.12.2020	v.2021	v.2021	31.12.2021
1	Plantacione(Peme)	3,029,000	-	-	3,029,000
	Shuma Plantacione 211 Bashkia	3,029,000	-	-	3,029,000
2	Mbjellje pisha	1,216,502			1,216,502
	Totali Plant.211 Kallmet	1,216,502	-	-	1,216,502
3	Pyllezim me shega	40,049,692			40,049,692
4	Peme e shkurre Sheshi Gjader	317,060			317,060
5	Peme e shkurre Shkolla Dajc	170,562			170,562
6	Peme e shkurre Shkolla Mabe	221,120			221,120
	Shuma Plantacione 211 Dajc	40,758,434	-	-	40,758,434
7	Plantacion peme	633,600			633,600
	Shuma Plantacione 211 Zejmen	633,600	-	-	633,600
8	Plantacione	2,116,284			2,116,284

	<i>Shuma peme plantacione 211 Balldre</i>	2,116,284	-	-	2,116,284
9	Pyllëzim me arra	7,166,880			7,166,880
10	Pyllëzim Gjëlberim	1,354,400			1,354,400
	Totali llogaria 211 Ungrej	8,521,280	-	-	8,521,280
	Totali	56,275,100	-	-	56,275,100

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimet në llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe analiza e saj, si dhe nentarin e llog 211 "Pyje, Plantacione".

Situata: Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 1,085,472,103 lekë (kosto historike)". Referuar analizës së gjendjes të llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" konstatohet se, përfshihet një vlerë prej 1,050,872,186 lekë, e cila nuk është e detajuar dhe mungojnë të dhënat se çfarë përfaqëson.

Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 56,275,100 lekë (kosto historike)". Për këto aktive nuk është kryer inventar për verifikimin dhe krahasimin me inventarin kontabël.

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Impakti: Mungesa e analizës për vlerën 1,050,872,186 lekë të llogarisë së aktiveve 210 "Toka, Troje, Terrene" si dhe mos inventarizimi fizik i aktive në llog. 211 "Pyje, Plantacione" me vlerë 56,275,100 lekë ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin, inventarizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lezhë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe në llog. 211 "Pyje, Plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 3,204,084,931 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerë 3,138,308,660 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 4,168,768,455 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerë 4,293,453,722 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 124,685,267 lekë, që i perket vlerës së ndërtesave të reja që janë kapitalizuar si aktiv. Analiza e inventarit kontabël në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabel i llogarisë 212 "Ndërtesa " me 31.12.20201

Nr.	Emertimi i Aktiveve	Gjendje	Shtesa	Paksime	Gjendje	Nr.	Emertimi i Aktiveve	Gjendje	Shtesa	Paksime	Gjendje
		31.12.2020	v.2021	v.2021	31.12.2021			31.12.2020	v.2021	v.2021	31.12.2021
1	Zyrat e Bashkise	124,175,805			124,175,805	10	Ndertim 2 qend. Sport	19,809,782			19,809,782
2	Rik Zyrat e bashkise	3,136,756			3,136,756	11	Rikos. Obj. 4 kat.qytet.	11,164,598			11,164,598
3	Zy. Perkrahtjes Sociale	7,830,000			7,830,000	12	Rik. 36 shtepive Rome	9,573,247			9,573,247
4	Zy. Gjendjes Civile	6,600,000			6,600,000	13	Banesa Sociale	4,218,246			
5	Zy. e Ish N. R. Sherbim.	14,000,000			14,000,000	VI	ndertes. Social-Kultur	762,626,185	68,014,828	-	830,641,013
6	Zy.Ish Raif. Banke	4,310,000			4,310,000	1	Ambulanca L. Skendeb.	750,000			750,000
7	Librari Kuvendi	-			-	2	Qend. Shendet K.Marl.	578,953			578,953
						3	Riparim muri I kalase	0	16,446,000		16,446,000
8	Kioska cope	1,188,000			1,188,000	VII	Ndertesha Shendetsore	1,328,953		-	1,328,953

9	Zyre Pyjore Ungrej	1,500,000			1,500,000	1	Lulishte perb.Stadiumit	43,700,000			43,700,000
	Sh. Ndert.										
III	Administrativ	162,740,561	-	-	162,740,561	2	" 11.2 ha Sheshi Bes.	230,000,000			230,000,000
IV	Konvikti I Nxenseve					3	" lagje Beselidhja	202,675,046			202,675,046
1	Shkolla Kosova	37,000,000			37,000,000	4	" Lagje beslidhja	52,500,000			52,500,000
2	Shkoll Mesme. "K.Gjoka"	135,000,000			135,000,000	5	". Bes. jug te Shkoll.	206,000,000			206,000,000
3	Sh. Mes. Pergjithshme	145,400,604			145,400,604	6	" Lagje Skenderbeg	136,000,000			136,000,000
4	Sh. 9 vjeçare Gj Kastrioti	85,773,660			85,773,660	7	" " " Skenderbeg	15,000,000			15,000,000
5	Shk. 9 Vj. Gjergj Fishta	72,000,000			72,000,000	8	"Para Bashkise	370,733,660			370,733,660
6	Shk. E Re K. Marlekaj	53,278,248			53,278,248	9	" pran ish D.ushtarake	181,000,000			181,000,000
7	Shk. Gjimm Ri Hyda Lezha	189,712,054			189,712,054	VIII	Shuma Lulishte	1,437,608,706	-	-	1,437,608,706
8	Shk. E re 9vj. Beslidhja	229,753,185			229,753,185	IX	Varrezat e Qytetit	195,700			195,700
9	Muri rrethues i shkollave	5,470,000			5,470,000	X	Pritat mbrojte malore	11,000,000			11,000,000
10	Kopsht Qytet (Beselidhja)	27,481,848			27,481,848	XI	Te tjera ndertime	5,874,204			5,874,204
11	Shkoll Mabe Mbikq pun.	436,000			436,000		SHuma e Aparatit	3,362,679,908	68,014,828		3,430,694,736
V	Shuma Nder. Shkollore	981,305,599	-	-	981,305,599		NJA Kallmet	72.542.345	-	-	72.542.345
1	Pallati i Kultures	278,000,000			278,000,000		NJA Dajc	143.728.489			143.728.489
2	Shtepia a Pioneerit	142,926,557			142,926,557		NJA Zejmen	57.569.875	44.923.261		102.493.136
3	Çerdhe Beselidhja	60,000,000			60,000,000		NJA Kolsh	141.607.455			141.607.455
4	Kopeshti Skenderbeg	15,500,000			15,500,000		NJA Balldren	147.668.350	11.747.178		159.415.528
5	Kopeshti Beselidhja	33,000,000			33,000,000		NJA Blinisht	62.771.328			62.771.328
6	Kopeshti Gurra	36,000,000	18,179,024		54,179,024		NJA Ungrej	35.443.585			35.443.585
7	Kopes Beselidh Pa dreke	60,000,000	51,568,828		111,568,828		NJA Shëngjin	49.086.938			49.086.938
8	Biblioteka e Qytetit	70,000,000			70,000,000		NJA Shënkoll	95.670.182	-		95.670.182
9	Qendra e rick. te mbet.	4,254,731			4,254,731		Shuma e NJA	861.254.259	56.670.439	55.165.712	806.088.547
							Totali i Bashkisë	4,168,768,455	124,685,267		4,293,453,722

- **Gjendja e Llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,831,990,172.90 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerë 1,843,984,301.9 lekë.. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,399,231,649lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerë 2,508,277,558 lekë. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 rezulton se janë kryer 109,045,909 lekë, shtesa që i përkasin: Sistemim asfaltimi rruges K. Gj. nga Qendra Ola-Tuneli Lagjia Nene Tereza ne vlere 14,098,500 lekë. Rehabilitim i kanaleve vaditese Kv12, K46, KV269, KV284 në vlerën 24,789,781 lekë. Sistemim asfaltim i rruges se varrezave Zojs Mabe në vlerë 5,159,280lekë.Riko. rruga Dajc Fshati Koterr në vlerë 20,038,632lekë. Sistemim-Ndricim i rruges Dajc + sistemim Kanal Kullues 5,038,848 lekë. Sistemim asfaltim i rruges se brendshme fshati Treshnë vlerë 7,262,700 lekë.Rikonstruksion rruga Barbulloje në vlerë 12,890,724 lekë. Ndricim i rruges Shengjin Kune në vlerë 4,166,196lekë. Rikonstruksion i rruges Zall Shenkoll dhe sistemi asfaltim rruga e varrezave në vlerë 8,537,448 lekë. Për këtë gjendje ekziston analiza e aktiveve të përfshira sipas inventarit kontabël.

- **Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në shumën 17,019,015.80 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 14,186,538.80 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto)paraqitet në mbyllje e në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 58,639,900 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 57,805,682 lekë për të cilat ka inventar fizik lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqitet si me poshtë:

Inventari kontabel i llog. 214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"

Emertimi i aktiveve	Gjendja me 31.12.2021	Emertimi i aktiveve	Gjendja me 31.12.2021
Aparati i Bashkisë		Njesia Administrative Zejmen	
Rimorkio bujqesor	2,684,220	Pompe uji	538,800
Pirun automatik Sherbimet	3,839,542	Miniskavator katerpilar	2,222,600
		Njesia Administrative Kolsh	
Makine pastrimi rere	1,500,000	Kamerat ne godinat e shkollave	96,876
Kontinjer Nderrmarrja e Sherbimeve	22,725,154	Njesia Administrative Balldre	
Pajisje Nderrmarrja e Sherbimeve	2,237,400	Pajisje informatike	4,082,255
Trau elektronik parkimi sheshi Gjergj Kastrioti	1,824,000	Pompe uji viti 2013	52,000
Mbrojtja kunder zjarrit paisjet	1,214,332	Pompe uji viti 2013	300,000

Kamerat ne shkollat e Bashkise	961,524	Paisje te tjera viti 2013	112,500
Kosha +mbajtese kazanash pa pagese gjendje ne magazine	10,036	Kamerat ne godinat e shkollave	188,304
Pajisje vegla pune sherbimet	1,210,576	Njesia Administrative Blinisht	
Shuma e Aparatit	38,206,784	Pompe uji Blinisht	467,204
		Pompe uji Piraj	467,204
Njesite Administrative		Kamerat ne godinat e shkollave	95,112
Njesia Administrative Kallmet		Njesia Administrative Shengjin	
Pajisje informatike	155,124	Kamerat ne godinat e shkollave	132,816
Njesia Administrative Dajc		Paisje	4,498,399
Kazene Mbeturinash	2,916,000	Njesia Administrative Shenkoll	
Pajisje ujesjellsi	2,650,580	Kamerat ne godinat e shkollave	289,428
Kamerat ne godinat e shkollave	333,696	Shuma Njesite administrative	19,598,898
		Shuma Bashkia +NJA	57,805,682

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 27,126,288.80 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 22,397,031.80lekë . Ndërsa sipas Formatit nr.7/A "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 66,022,238lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 66,892,238 lekë, vlera e amortizimit te akumuluar është 44,495,206 leke.Gjatë vitit 2021 është blerë një autoveture MAZDA me vlerë prej 870,000 lekë . Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti " me datë 31.12.2021

Nr	Emertimi I mjetit	Targa	Cope	Çmimi	Vlera	Posedon	Nga
1	Autobuz	LE8863A	1	900,000	900,000	Me kontrat	Bashkia
2	Iveko	-	1	370,000	370,000	Njoftim	Prokuroria
3	Komjon Transporti	MR1681A	1	2,822,960	2,822,960	Sek.rrug	M.Rruga
4	Autoveture Jeep	AA073DL	1	399,000	399,000	D.Bujq	Shengjini
5	Autoveture	AA740GD	1	1,959,999	1,959,999	Zv.Kryetari	Shengjini
6	Benz ML	AA452CN	1	1,950,000	1,950,000	Agj.Pyjore	Balldreni
7	Autoveture	LE8441A	1	999,000	999,000	P.Bashkise	Kallmeti
8	Ekskavatore Atlas	-	1	2,976,000	2,976,000	D.Bujqes	Shengjini
9	Fadrome	-	1	2,397,600	2,397,600	Parku	Shengjini
10	Ëolëagen Bora	AA782 NJ	1	103,400	103,400	Sherbimet	Dhurate
11	Autoveture 6+1,Volsëagen Touran	AA882XC	1	1,400,000	1,400,000	Pol.Bashk.	Blerje
12	Autoveture 6+1,Volsëagen Touran	AA621XI	1	1,400,000	1,400,000	IVMT	Blerje
13	Autoveture 6+1,Volsëagen Touran	AA331XD	1	1,400,000	1,400,000	Taksat	Blerje
14	Fuoristrade 4+1,Volsëagen Touareg	AA881XC	1	3,216,000	3,216,000	Kryetari	Blerje
15	Renault /Biblioteka e qytetit	AA688JT	1	299,999	299,999	Biblioteka	Blere 2017
16	Kamion	AA876AG	1	183,840	183,840	Sherbimet	Dhurate 2019
17	Kamion	AA385XA	1	122,560	122,560	Sherbimet	Dhurate 2019
	Shuma 215				22,900,358		
18	Kamjon Benz Vetshk.	-	1	2,400,000	2,400,000	D.Bujqes	Blere 2017
19	Kamjon Benz ATP	-	1	1,320,000	1,320,000	D.Bujqes	Blere 2017
20	Eskavator Volvo	-	1	9,055,196	9,055,196	D.Bujqes	Blere 2017
	Shuma2150				12,775,196		
21	Autoveture	-	1	464,250	464,250	Blinisht	"
	Shuma				464,250		
22	Automjete Zjarrfikese	-	8	-	8,131,234	MNZ	te vetat
	Totali				44,271,038		
Totali Llogaria 215 viti 2019					44,271,038		
23	Fadrome me gome	AGMT90	1	3,690,000	3,690,000	Sherbimet	Blerje 2020
24	Makine me Kosh	AB731AE	1	2,214,000	2,214,000	Sherbimet	Blerje 2020
25	Fadrome e vogel	AGMT91	1	1,771,200	1,771,200	Sherbimet	Blerje 2020
26	Kamion Fshirese	AB732AE	1	2,673,600	2,673,600	Sherbimet	Blerje 2020
27	Ekskavator me zinxhir	EC210BCL	1	5,701,200	5,701,200	D.Bujqes	Blerje 2020
28	Ekskavator me zinxhir	EC140DCL	1	5,701,200	5,701,200	D.Bujqes	Blerje 2020
29	Autoveture Mazda	AB692DR	1	870,000	870,000	Bashkia	Blerje 2021
	Totali Llogaria 215 viti 2021				66,892,238		

- **Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 103,788,744 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 73,491,450 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit të vitit 2020 në vlerën kontabel 237,162,996 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021

në vlerën 227,342,350 lekë. Ka patur nje rënie të inventarit ekonomik nga viti 2020 në vitin 2021 për arsye të nxjerrjeve jashtë përdorimit.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF praqitet më poshtë:

Nr. Refer	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
Llog b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	38,396,671	18,988,896	19,407,775	0	2,911,166	0	0	38,396,671	21,900,062	16,496,609
201	Prime emision e rimburs hua	0	0	0					0	0	0
202	Studime dhe kerkime	38,396,671	18,988,896	19,407,775	0	2,911,166	0	0	38,396,671	21,900,062	16,496,609
203	Koncesione, patenta,licenca	0	0	0					0	0	0
21	II. AAGJ/ MATERIALE	8,071,572,441	1,766,913,259	6,304,659,182	251,816,250	318,549,716	27,869,938	1,203,338	8,295,518,753	2,084,259,637	6,211,259,116
210	Toka,troje, Terene	1,085,472,103	0	1,085,472,103.00					1,085,472,103	0	1,085,472,103
211	Pyje, Kullota Plantacione	56,275,100	21,097,173	35,177,926.95	0	1,758,896			56,275,100	22,856,069	33,419,030.95
212	Ndertime e Konstruksione	4,168,768,455	964,683,524	3,204,084,931.00	124,685,267	190,461,538			4,293,453,722	1,155,145,062	3,138,308,660
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,399,231,649	567,241,476	1,831,990,172.90	109,045,909	97,051,780			2,508,277,558	664,293,256	1,843,984,301.9
214	Instali tekni,maki,paisj,vegla	58,639,900	41,620,884	17,019,015.80	1,961,542	3,201,597	2,795,760	1,203,338	57,805,682	43,619,143	14,186,538.80
215	Mjete transporti	66,022,238	38,895,949	27,126,288.80	870,000	5,599,257			66,892,238	44,495,206	22,397,031.80
216	Rezerva shtetore	0	0	0.00							
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0.00							
218	Inventar ekonomik	237,162,996	133,374,252	103,788,743.97	15,253,532	20,074,178	25,074,178		227,342,350.40	153,850,900.40	73,491,450
24	Aktive Qend.trupez te demtu	0	0	0.00							
28	Caktime	0	0	0.00							
	T O T A L I (I + II)	8,109,969,112	1,785,902,155	6,324,066,957	251,816,250	321,460,882	27,869,938	1,203,338	8,333,915,424	2,106,159,699	6,227,755,725

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Lezhe

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2021 për Bashkinë Lezhe dhe Njësitë Administrative ne varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2021 ka dalë urdhrat nr.808 dhe nr 809 datë 13.11.2021 “Per Inventarizimin e aktiveve per vitin 2021” në të cilat janë përcaktuar 7 komisione me nga tre punonjës për kryerjen e inventarizimit. Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, 2 magazinave dhe në NJA, në 6 shkolla,3 kopshte, 1 cerdhe , konvikti i shkollës profesionale, Bibliotekë, Muzeu, Pallati i Kulturës, Qendrës Kulturore të Fëmijve dhe Qendrës së Zjarrfikëses. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastete e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Për konstatimet në mungesa dhe teprica në fizik të aktiveve është prerë fletë kontabilizimi përmbledhës, ku janë prekur llogaritë përkatëse, duke kryer kontabilizimet sistemuese. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021. Nuk është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit. Nga komisionet janë mbajtur procesverbale për propozim per nxjerrjen jashtë përdorimit te aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Per vleresimin e aktiveve te propozuaranga komisioni i mesiperm per jashte perdorimi eshte ngritur komisioni i vleresimit nr.297 datë 18.05.2022 “ Per ngritjen e komisionit të vlerësimit, seleksionimit te aktiveve te propozuara per dalje nga perdorimi” si dhe jane mbajtur proces verbalet perkatese. Komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës për mbledhjen e aktiveve jashtë përdorimi nga subjektet e inventarizimit dhe argumentimin e vlerësimit të tyre jashtë përdorimi.

Me urdhrinnr.392, datë 07.07.2022 është bërë miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimi i matrialeve të vlerësuar jashtë përdorimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Sipas këtij miratimi

rezultoni se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive në vlerën 9,487,267 lekë, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

- Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 8,171,252 lekë.
- Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 0 lekë.
- Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 1,316,015 lekë.

Konkluzion: Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me Urdher nr.577, datë 26.10.2022 “ Per ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimi nga komisioni i vlerësimit” prej 9 vetësh, i cili kabërë shpërbërjen e aktiveve pa vlerë përdorimi dhe i ka mbledhur pranë magazinës, por nuk ka kryer procesin e asgjësimit të tyre. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk është bërë magazinimi i tyre nëpërmjet prerjes së fletë-hyrjes si dhe ka kryer veprime kontabël për zbritjen e vlerës së aktiveve jashtë përdorimi pa kryer asgjësimin. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

- **Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale”** paraqitet në bilanc në vlerën 2,106,159,699 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36. Për llogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit dhe jo aktiv për aktiv, kur në fakt secili aktiv brenda një klasifikimi (grup aktivesh).

- Gjendja e **llog. 230 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 është në vlerën 65,785,632 lekë dhe me datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 85,041,663 lekë. Analiza e kësaj llogarije paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

	Emertim i Aktiveve jo materiale (projektme-studime)	Vlera
1	Studim Projektim Kanale Ujitese	2.760.000
2	Hartim i projektit të nderhyrjeve rehabilituese për obj.e demtuara nga termeti I dt 26.12.2019-ARENA	16.162.843
3	Hartim i projektit të nderhyrjeve rehabilituese për obj.e demtuara nga termeti I dt 26.12.2019-NGS	37.713.301
4	Studim projektim Ujesjellesi Zejmen	5.964.000
5	Oponence Teknike	305.488
6	Stud. Projek.Rind.Shkolla Shengjin	1.920.000
7	Stud. Projek.Rind.Shkolla Ishull Shengjin	960.000
8	Hartim i projektit të nderhyrjeve rehabilituese përshatase të nevojshme për kthimin e struktureve të objekteve që janë klasifikuar si objekt me demtime të mëdha -NET GROUP	9.748.476
9	Hartim projekti për nderhyrjet rehabilituese për obj.e demtuara nga termeti	2.852.267
10	Hartim projekti për nderhyrjet rehabilituese për obj.e dala nga termeti	6.655.288
	Totali	85.041.663

- Gjendja e **llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 1,148,862,883 lekë dhe me datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 2,046,717,148 lekë. Analiza e kësaj llogarije paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Emertimi i aktivitetit (investimit kapital)	Vlera	Nr	Emertimi i aktivitetit (investimit kapital)	Vlera
2	Shp për rritjen e aktiveve të qendruara në truëzuar	5,583,951	45	kons. rrugë A. I.G. C.	13,906,992
3	ndertesa shkollorë K.C.	23,008,427	46	kons. të rrugëve P. G. shpk	172,929,240
4	ndertesa shkollorë MCE Shpk	246,750	47	konstr të rrjetëve Sh.shpk	34,356,144
5	L.-C. o.	4,280,000	48	konstr rrjete GPG C. SHPK	24,525,526
6	varrezat	60,081,810	49	konstr rrjete N.	15,878,382
7	ndertim e mure rrethuese J. Sh.p.k	13,948,133	50	konstru të rrjetëve XH&M. SHPK	629,949
8	të tjera ndertimore O.shpk	40,004,466	51	konstruk vepra ujore M. Sh.p.k	1,011,062
9	të tjera ndertimore D.shpk	2,009,175	52	konstruk të veprave ujore F.Sh.Zh	20,338,374
10	të tjera ndertimore B.Th.shpk	1,459,200	53	konstr rrugë, ura, rrjete T.T-A.LAM	1,715,403
11	konstruk të rrugë N.Sh.p.k	35,624,270	54	konstru rrugë, ura, rrjete Uleza Ndertim	136,095,954

12	konstru te rruge Shtjefen Zefi	780,315	55	konstr rruge, ura, rrjete ALF Tiefbau	86,086,458
13	konstruk te rruge K. Sh.p.k	17,998,446	56	G. L. PF	100,000
14	konstr te rrugeve 4 A-M shpk	185,964,812	57	Paisje sigurojne energji A. L.	37,938,000
15	konstruksione te rrugeve B. P.	99,280	58	paisje qe sigurojne energji M.A.K STUDIO	76,277
16	konstruk te rruge C. shpk	8,622,372	59	makin print graf Enti Botue Gj F.	72,331
17	konstruk te rruge A. Ko.	25,398,800	60	Rikon i Mjedisve ne bashkepronesi -LOTI II -RSM ^HIDRO	30,972,899
18	konstruk te rruge Gj. shpk	40,589,100	61	Rik i Mjedis ne Bashkepronene ndertesa Pallat LOTII II -MCE	1,015,000
19	konstr te rruge N. shpk	11,714,000	62		
20	konstr te rruge F.shpk	65,081,870	63	Mbikqyrje:Rindertim i Konviktit Kolin Gjoka -MCE	302,000
21	konstr te rruge K.C.	3,537,148	64	Rindert i Konviktit te shkollës së mesme Profesionale Kolin Gjoka	30,547,605
22	konstrrruge C. R.2008 shpk	8,311,000	65	Permiresimi i Infrastruktur dhe i sigurise mbi Lumin Drin-Pirraci	5,633,282
23	konstruk te rrugeve Gj.shpk	837,600	66	Mbikq:Permires i infrastruktr dhe sigurise mbi Lumin Drin-M.A.K	207,762
24	konstruk te rruge K.Sh.p.k	8,859,868	67	Riforcim i Njesi te banimit ne ndertesat pallat+individuale ne kuader te rindertimit-LODI	51,746,796
25	konstruk te rrug Sh.07 shpk	15,360,000	68	Rikon i Mjedis ne bashkepronesi ose te perbashketa -Loti I UDHA	159,438,108
26	konstr te rrugeve M. K.	880,132	69	Sherb Mbikq -Rikon.i Mjedisve ne bashkepronesi Loti I HE&SK	493,000
27	konstr te rrugeve P.	401,983	70	Mbikqyrje punimesh:Rruges Ruale "Tower"	600,874
28	konstruks te rrugeve . Shpk	510,700	71	Sist i rrug Lagjia e Pukjan -Kakarriq Gocaj rruga e varrez Pllane	554,004
29	konstruk te rrugeve L. C.	239,224	72	Mbikqyrje punimesh -Kanalet	850,075
30	konstruks te rrugeve V. G.	90,000	73	Rehabilitim i Kanalit Ujites Koterr -Rrabishte NG Structures	18,656,724
31	konstruks te rrugeve Zh.K.	28,800	74	Rehab kanal uji Koterr -Rrabisht-Koter-Nnenshat-Piraj-Rrabisht	12,439,816
32	konstr rruge S. E. shpk	109,061	75	Rikonstruksion i KU Koterr-Kakarriq-K.	327,599
33	konstruk te rrugeve Zh.A.	46,252	76	Ndertim Ujesjellesi ne 5 fshatra -NG LOTI I	11,312,654
34	konstruk te rruge Z. shpk	4,759,200	77	Ndertim Ujesjellesi ne 5 fshatrat -GPG LOTI I	27,050,908
35	konstruk te rruge D. A	6,226,500	78	Nertim ujesjellesi nj Ad.Zejmen-- Shendelli	81,846,437
36	konstruk te rruge R. G.	225,295	79	Ndertim Ujesjellesi ne 5 fshatrat Nj.Ad.Zejmen -NG -LOTI II	50,773,583
37	konstruk te rruge A. B.	41,633	80	Ndertim Ujesjellesi Zejmen Lotii II-SHENDELLI	16,176,544
38	konstr rruge Gj.&Co shpk	770,102	81	Ndertim Ujesjellesi Nj Adm.Shenkoll-A.N.K SHPK	188,378,404
39	konstruk te rruge B. F.	277,680	82	Mbikq -Ndert Ujesjel Nj.Ad. Zejmen-LOTI II A.SH Engineering	702,000
40	konstruk te rruge A.P.	1,487,848	83	Mbikq :Ndertim Ujesjellesi neNj.Ad.Zejmen -XH&MILLER	800,000
41	konstr te rruge P. C.	2,023,941	84	Mbikq :Ndert Ujesjell neNj.Ad.Shenkoll -A.E ENGINEERING	2,022,576
42	konstruks te rrugeve Gj.Shpk	9,786,046	85	N.C. 2012	218,049,815
43	konstruk te rrugeve M. B.	268,740	86	KKG-Mbikqyrje At Zef Pllumbi	2,015,414
44	konstr te rrugeve N. K.	96,000			2,046,717,148
				Totali	8

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

Nr rreshti	Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	1,390,151,180	1,376,135,320
66		I.Pasivet Afat shkurtra	1,370,772,907	1,346,579,330
67		I. Llogari te Pagushme	1,370,156,606.70	984,105,907
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	50,565,776.80	59,867,477.10
69	42	Detyrime ndaj personelit	28,060,688	28,519,893.00
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,654,833	1,569,182.00
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	8,224,529	8,302,215.00
76	436	Sigurime Shendetore	1,141,769	1,153,013.00
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore	93,437	102,952.00
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	83,299,077	39,037,847.00
82	467	Kreditore te ndryshem	273,627,813	306,308,894.00
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	923,488,684.90	539,244,434.00
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	616,300	362,473,420
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		357,559,110
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar	616,300	4,914,317.00
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	19,378,273	29,555,990
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata	19,378,272.90	29,555,989.90

94		Provizionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	9,133,257,710.53	8,260,077,389.84
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	9,133,257,710.53	8,260,077,390.24
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	6,314,910,100.70	6,389,164,989.00
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	705,967,071.77	685,819,876.20
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	2,112,380,538.08	1,185,092,525.08
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI PASIVEVE(B+C)	10,523,408,890.00	9,636,212,713.00

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,376,135,325 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,390,151,180 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 59,867,477.12 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 50,565,776.80 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rënie me një ulje në shumën 9,301,700.32 lekë krahasuar me vitin 2020. Në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Llogaria 401 “Furnitorë për mallra”		
Nr	Emer subjekti	Vlera e palikujduar
1	E.B..	23,040
2	I.	536,681.7
3	L. 80shpk	2,079,371.04
4	A.	2,676,328.8
5	S. shpk	8,516,652
6	S. &Co	209,364
7	Shtypshkronja letra vlere	784,500
8	D. A shpk	24,684,616.8
9	L. G. Sh.p.k	3,130,835.14
10	S.-S.-AL shpk	2,231,400
11	T. K.	55,199.32
12	S.T.	3,969,787.20
	Totali	50,565,776.80

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 28,060,688 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël 1,654,833 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 8,224,529 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël 1,141,769 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlere 570,884.5lekë

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlere 570,884.5 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 437 “Organizma të tjerë shtetëror”** në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël 93,437 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 539,244,434 lekë dhe në mbyllje të viti 2021 në vlerën 923,488,684.9 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarive 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqesin në mënyrë të plotë dhe reale detyrimet e të tretëve ndaj institucionit ose të drejtat e konstatuara.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 39,037,847 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 83,299,071 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Lezhe në mënyrë analitike, duke rakorduar periodikisht për lëvizjet deri në fund të vitit ushtrimor.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 306,308,894 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 273,627,818 lekë. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti	Kreditori	Numri i Fatura	Kreditor me dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.12.2020			
1	Furnizimi me uje deri Qershor 2019	U. Sh.a	486	25,306,644		3,444,866	28,751,510
2	Sherbimi Postar deri Qershor 2019	Posta Lezhe	338	4,263,201	4,263,201		-
3	Materiale Ndertimi	St.Shpk	11	6,271,454		2,245,198	8,516,652
14	Krevate +karrige	E. L.	1	625,800	625,800		-
15	Sh Dezinfektim	H. E.G.	1	233,940	233,940		-
16	Automjete	T. SHPK	1	17,158,800	17,158,800		-
17	Kancelari	I. O.	1	490,935		45,757	536,692
18	Materi elektrike per ndricimin rrugor	D.A Shpk	5	2,573,185	2,573,185		-
22	Sherbim Autom. Policia Bashkiake	E. P.	2	590,880	590,880		-
23	Bllok fjetje ne hotel	Shtypshk letra me vlere	1	720,000		64,500	784,500
24	Shpenzime gjyqesore	TT A. L.	-	1,371,429	1,371,429		-
25	Mb. Pun.Parkë e Lulisht shesh perball shk Hydaj Lezha	I. D	1	34,800			34,800
26	Mbik pun Rivesh rrug Pran Shko 9 Vjec Marash Gjoni	I. D	1	117,277	117,277		-
27	Mb Pun Rr. Zalle Shenkoll +Mb. Pun. Asf Rr. Tale 1 Alk Tale 2+ Nd. Trot. Manati	P.C.	1	870,732	870,732		-
28	Mbikqyrje punimesh kanali vadites	N.M.	1	276,600	276,600		-
29	Mbikqyrje punimesh	R.-95 Shpk	1	554,004	554,004		-
30	Sherbim larje rruge	L. 2007 Shpk	1	568,435	568,435		-
31	Kryepaq viti 2016-2019	-	-	1,444,800	1,444,800		-
32	Pastrim NJA Dajc Kallmet Blinisht Balldren	Nderkom. zadrimë	1	689,085	689,085		-
33	Shpronësime	-	-	126,103,140			126,103,140
34	Gaz	S.&Co shpk	1	209,364			209,364
35	Tabela sinjalistike	S.S.-Al	1				2,231,400
36	Ushqime	L. Gr. Shpk	3				914,464
37	Kancelari per zyrat	A.Shpk	1				2,676,328
38	Sherbim DDD	M.Shpk	1				209,758
39	Hartim PDV	UTS	1				11,932,200
40	Sist. Asf. Rr. varrezave Balldre	D. A Shpk	1	1,563,800	1,563,800		-
41	Rik. rrug Zall Shenkoll e rruges se varrezave	K.C.	2	3,537,148	3,537,148		-
42	Rruga Luigj Gurakuqi	A.B. Shpk	1	2,346,428			2,346,428
43	Rruga Superstrate Piraj	A. C.	2	6,675,040			6,675,040
44	Sist. Asf. rruge brendsh FshatTroshan	Sh. 07 Shpk	2	2,088,200	2,088,200		-
45	Sist.Asf Rr. Qender- Rrabosh - Shkoll 9 vj	Sh. 07 Shpk	2	3,993,600			3,993,600
46	Sist. Asf. Rr.te brendshme Fshati Gramsh	N.Shpk	1	5,972,719			5,972,719
47	Sis. Asf. Rruge te brendshme Fshati Mabe	N. Shpk	2	10,279,300			10,279,300
48	Asf. Rr.Brend Tresh	D. A Shpk	1	4,662,700	4,662,700		-
49	Sist. Asf. Rr.Çameria	N. Shpk	1	9,688,352			9,688,352
50	Sistemim Asfaltim Blloku Lagjia Beselidhja	N.Shpk	1	3,259,808	3,259,808		-
51	Sist Asf Rrug Kakarriq –Gocaje Ndric Qend Kakarr	C. R. 2008	1	5,245,680			5,245,680
52	Sist Asf Rrug Kolin Gjoka nga Qend OLA te tunel	U. N.Shpk	1	5,409,250	5,409,250		-
53	Sist. Asf. Rr. e Varrezave Pllane	K.shpk	1	1,480,074	1,480,074		-
54	Nd.trotuari fshatin Manati	U. N. Shpk	1	1,390,724	1,390,724		-
55	Sherbim GPS	P. Shpk	1	88,048	88,048		-
56	Asf. Rr. Brend Lagjia e Pukjaneve	C. R.2008Shpk	1	5,912,173			5,912,173
57	Sist.Asf. Rr. Gjok Nika	N. Shpk	1	106,630			106,630
58	Sist. Rr. Hydajet Lezha Perballe Hotel L.	N. Shpk	1	6,872,138			6,872,138

59	Sist. Asf. Bil. Lagjia Beselidhja tek DTT	N. Shpk	1	900,036	900,036		-
	Shuma Bashkia deri 31.12.2020			271,946,353	55,717,956	5,800,321	239,992,868

Detyrimet e trashëguara nga ish-Komunat që nga viti 2015

Nr	Objekti	Kreditore	Numri Faturave	Kreditor me dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.07.2015			
Komunat				31.07.2015			
Komuna Shengjin							
1	Rikualifikim Urban Shetitorja Willson	F.shpk	3	17,495,807			17,495,807
2	Punime sherbimi pagese karte Telefonike	F.shpk	1	552,000			552,000
Komuna Dajç							
1	Pyllezim shoga	4 A. Shpk	1	4,907,937			4,907,937
Komuna Kolsh							
1	Furnizimi me uje Kolsh Viti 2010-2016	U. Sh.a	37	4,669,581	727,592		3,941,989
2	Sherbimi Postar Kolsh viti 2009-2013	Posta Lezhe	71	420,376			420,376
4	Mbikq Punime Ndert I Tregut Agroushqimor	L. B.	1	664,013			664,013
	Vendim gjykate tregu Kolsh		1	918,831			918,831
Komuna Ballëdren							
1	Sherbim Interneti	G. N.	1	150,000			150,000
2	Blerje Librash	A. D.	1	32,500			32,500
3	Blerje Naftë	V. shpk	1	112,000			112,000
4	Blerje shtypshkrimesh	Enti botues Gj. F.	2	12,240			12,240
5	Blerje Naftë	Gj. K.	1	350,000			350,000
6	Sistemim asfaltim rruga Malecaj/Balldre	B.shpk	1	1,008,228			1,008,228
7	Projekte(kontrate)	A. Xh.	-	1,100,000			1,100,000
8	Projektme(me kontrate)	A. S.	-	499,999			499,999
9	Punime shkolle	D.I.	1	374,400			374,400
10	Mbikqyrje punimesh	L. V.	1	14,280			14,280
11	Blerje Kancelarish	Kancelari K.	1	63,700			63,700
12	Sherbim Interneti Janar Shkurt 2016	Z.M.	1	20,000			20,000
13	Sherbim Interneti	R. C.Shpk	1	163,550			163,550
14	Sherbim Interneti	R. C. Shpk	1	150,000			150,000
15	Mbikqyrje punimesh Rikonstr Rruga Ballëdren	N. M.	1	47,400			47,400
16	Flamuj	E. C.	1	10,000			10,000
17	Kancelari	M.Z.	1	30,000			30,000
18	Pjese kembimi	B.P.	1	14,800			14,800
19	Dosje	Kancelari K.	1	1,200			1,200
20	Kabull	L. C.	1	20,500			20,500
21	Pompe Uji	A. Z.	1	9,000			9,000
22	Riparim elektropompe	B. K.	1	30,000			30,000
23	Pjese kembimi	P. L.	1	520,200			520,200
Shuma ish-Komunat				34,362,542	727,592		33,634,950
Totali Bashkia + komunat				306,308,895	56,445,548	5,800,321	273,627,818

-Gjendja e llogarisë 475 “Te ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 357,559,111 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë .

- Gjendja e llogarisë 480 “Të ardhura për t’u klasifikuar ose rregulluar” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 4,914,317 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 616,300 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llogarisë kundërpanti në aktiv të bilancit 532 “Vlera të tjera” dhe përfaqëson vlerën e letrave me vlerë gjendje ne arke, ku përfshihen biletat e memorialit, te policise bashkiake, pullat e gjendjes civile etj.

- Gjendja e llogarisë 105 “Teprica e Granteve kapitale te Brendshme” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,185,092,525.08 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 2,112,380,538.08 lekë. Llogaria 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet, kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces ne grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën, kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

- Gjendje e llogarisë 16 “Huatë Afatgjatë” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 29,555,989.92 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,378,272.92 lekë, gjendje që tregon

vlerën akoma të pashlyer të huasë të marrë nga Bashkia lezhë për financimin e investimeve në vitin 2010-2011.

Llogaritë në pasiv të bilancit 105 “Teprica e Granteve kapitale te Brendshme” dhe 16 “Huatë Afatgjatë” të marra së bashku kuadrojnë me llogaritë kundraparti në aktiv të bilancit 230 “Aktive Afatgjatë në proces të trupëzuar” dhe 231 “Aktive Afatgjatë në proces të Trupëzuar” të marra së bashku.

➤ **Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2021 paraqitet më poshtë:

Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”

NE / LEKE				
Nr.	Nr.		VITI	VITI
rresh	Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	USHTRIMOR	I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	2,523,946,621.52	2,468,996,556.48
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	318,930,892.48	178,922,582.41
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	6,025,321.00	8,866,992.00
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	6,025,321.00	8,866,992.00
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	93,752,517.58	66,809,109.41
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	93,752,517.58	66,809,109.41
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	219,153,053.90	103,246,481.00
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	219,153,053.90	103,246,481.00
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE		0
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	133,948,030.36	95,180,605.15
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	6,551,703.80	7,818,465.00
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	6,551,703.80	7,818,465.00
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	127,396,326.56	87,362,140.15
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	99,336,891.84	72,146,056.65
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	11,118,768.00	7,663,752.00
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		751,000.00
44	7114	Te ardhura nga biletat	1,070,000.00	2,672,850.00
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestre e zhdemtime	5,371,100.00	4,128,481.50
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
53	72	V.GRANTE KORENTE	2,071,067,698.68	2,194,893,368.92
54	720	1.Grant korent I Brendshem	2,060,948,309.88	2,194,893,368.92
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	1,992,312,288.88	2,110,442,925.76
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	48,604,446.00	51,442,911.00
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti		21,573,666
	7204	Pjesmarje e institucioneve ne tatime nacionale	19,153,575.00	
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	878,000.00	11,433,866.16
	721	2.Grant korent I Huaj	10,119,388.80	
		Nga Qeveri te Huaja	10,119,388.80	
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	1,817,979,549.75	1,783,176,680.28
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	418,025,948.00	391,062,362.00
76	6001	Paga, personel I perhershem	418,025,948.00	391,062,362.00
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	68,943,944.00	64,549,653.00
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	68,943,944.00	64,549,653.00
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	358,608,764.00	241,251,544.91
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,251,735.00	9,773,705.00
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	18,397,272.00	48,969,299.00
87	6022	Sherbime nga te trete	139,894,116.00	113,775,756.91
88	6023	Shpenzime transporti	60,979,447.00	25,855,674.00
89	6024	Shpenzime udhetimi	631,038.00	106,430.00
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	37,422,833.00	10,333,766.00
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	11,638,489.00	8,644,523.00
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	6,886,429.00	11,557,928.00
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	2,084,023.00	0.00
94	6029	Shpenzime te tjera operative	79,423,382.00	12,234,463.00

101		V.TRANSFERIME KORENTE	980,607,827.00	1,081,507,641.00
102	604	1.Transferime korente te brendshme	60,203.00	324,759,990.00
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	60,203.00	324,759,990.00
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	980,547,624.00	756,747,651.00
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	980,547,624.00	756,747,651.00
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
115		VL.SHPENZIME FINANCIARE	1,008,499.00	1,179,999.13
116	65	1.ShpENZIME Financiare te brendshme	1,008,499.00	1,179,999.13
	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme	1,008,499.00	1,179,999.13
125		VIL.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-9,215,432.25	3,625,480.24
131		IX.SHPENZIME TE TJERA		
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDES	705,967,071.77	685,819,876.20

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 2,523,946,621.52 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Lezhe paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 2,523,946,621.52 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 6,025,321 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 93,752,517.58 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 219,153,053.90 lekë e cila përfshin *taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.*

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 133,948,030.36 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 6,551,703.80 lekë, e cila përfshin *taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet*, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 127,396,326.56 lekë e cila përfshin *tarifat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj.* Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën e gabuar prej 21,573,666 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 0 lekë. E cila për vitin 2021 nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Te drejta)”, që është në vlerën 89,741,032.8 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 3.2** “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësitë të qeverisjes së përgjithshme”, **nënpika 59** e cila përcakton: “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në rastet kur është e nevojshme, duhet të regjistrojnë në kontabilitetin e vitit ushtrimor edhe marrëdhëniet e tyre me shtetin, për të drejta të konstatuara sipas rrethanave të ndryshme.

a) Në rastin e një të drejte të njësisë ndaj shtetit, regjistrimi në kontabilitet bëhet me artikullin kontabël si më poshtë:

• Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”; dhe

• **Kreditohet llogaria 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti”.**

Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qënë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të përealizuar të vitit ushtrimor raportues. Në asnjë rast, njësia e qeverisjes së përgjithshme nuk duhet të raportojë në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, si detyrim të shtetit ndaj saj, shuma për të cilat ajo ka kryer prokurime, shpenzime apo investime, pa patur më parë fonde të siguruar nga granti buxhetor, donatorë të tjerë apo nga burimet e veta.”

Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” në rubrikën “Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin” e cili përcakton: “Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

-Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;

-Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimet në llogarinë e fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Situata: Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** paraqitet në mbyllje të vitit në vlerën 0 lekë, e cila për vitin 2021 nuk rakordon me gjendjen në vlerën 89,741,032.8 lekë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” të bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk psqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3, nënpika 59.

Impakti: Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i i detyrimeve ndaj shtetit.

Shkaku: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë kontabilizim të gabuar të detyrimeve ndaj shtetit.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 1,817,979,549.75 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 418,025,948 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 418,025,948 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 68,943,944 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 68,943,944 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 358,608,764 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 358,608,764 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 60,203 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 60,203 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 980,547,624 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Per vitin 2021 totali i te ardhurave ne vlere është 2,523,946,621.52 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 1,817,979,549.75 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 705,967,071.77 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2021 është në vlerën -9,215,432.25 lekë.

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 2,131,758,811 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 2,112,380,538 lekë fonde të akorduara per investime, vlera prej 19,378,273 lekë huamarrje e brendshme afatgjate.

- Zëri “**Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale**” formati 6 e plotësuar për shumën 2,046,717,148 lekë në analizë rakordon me pasqyrën FI, llogaria 231 “ Investime per aktive afatgjata materiale.

Nga testi kontrollit për vitin 2021 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative si dhe per gjobat nga policia Bashkiake. Për të gjitha arkëtimit ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 gerrat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën dhe administrimi i karburantit.

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbjajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to në përputhje UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi zj. B. V. me detyrë Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe të hartueses së Pasqyrave Financiare.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nën pikat 43,44,45. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 87-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit, në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerë progresive prej 923,488,684.9 lekë, ku vetëm shtesë për vitin 2021 është në vlerën 7,436,528 lekë, nga të cilat 7,250,861 lekë janë debitorë nga taksat dhe tarifat vendore dhe

165,207 lekë janë debitorë që vijnë nga shërbimi social dhe konvikti i shkollës. Referuar analizës së kësaj gjendje vërehen vlera të konsiderueshme për individë dhe për subjekte private për të cilët nuk disponohen të dhëna të sakta dhe se nga janë krijuar, se për çfarë janë debitorë, pasi nuk disponohet dokumentacion. Nga këto, vetëm për një pjesë dihet objekti i debisë si:

- a. Debitorët e institucioneve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 4,331,150 lekë
- b. Gjobat e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 86,498,780 lekë
- c. Debitorë të ndryshëm në vlerën 54,212,264 lekë, të krijuara para vitit 2009 të lëna si detyrime nga auditi i jashtëm në vite, për të cilat nuk disponohet dokumentacion.
- d. Debitorë biznesi i madh në vlerën 120,941,375.50 lekë
- e. Debitorë biznesi i vogël në vlerën 110,169,492.90 lekë
- f. Shoqëria "C. -Alb" shpk ish-Komunën Balldren, detyrim në vlerën 423,235,000 lekë i lënë nga KLSH në auditimin e kryer në vitin 2016 për periudhën viti 2015 e para tij në lidhje me qiradhënien e aseteve, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka pushuar çështjen, duke e vlerësuar se nuk ka dëm ekonomik. Ndërsa Avokatura e Shtetit nuk ka ofruar ndihmë sipas rekomandimit fillestar nga KLSH dhe për këtë arsye në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të ushtruar në vitin 2019, nga KLSH ky rekomandim është vlerësuar i pa zbatueshëm. Nga Bashkia Lezhë nuk është vepruar ligjërisht për reflektimin e veprimeve në kontabilitet.

Për debitorët nga taksat dhe tarifat për biznesin dhe familjarët nuk disponohen të dhëna të sakta se për çfarë lloje taksash dhe tarifash janë debitorë. Gjithashtu raportet e gjeneruara nga programi, ku mbahet sistemi i taksave dhe tarifave nuk ka funksionuar dhe nuk ka saktësi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 15/b,59 /a,Kreu III. pika 32, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik "pika 3.3" Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 dhe i llogarive të klasës 5 (Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 87-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime t'i kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri më 31.03.2023

3. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto prej 16,496,609 lekë. Referuar analizës së llog.202 "Studime dhe kërkime" rezulton se, në gjendjen e saj prej 38,396,671 lekë (kosto historike) është përfshirë një vlerë prej 2,130,600 lekë e emërtuar studim-projektme gjendje nga viti 2009, për të cilën nuk disponohen të dhëna se për çfarë projekt-studimesh bëhet fjalë. Gjithashtu në këtë llogari janë përfshirë aktive jo materiale, të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie, pasi nga përshkrimi i shpenzimit ato janë blerje shërbimesh apo mallrash. Pra kontabilizimi i këtyre transakcioneve financiare në llog. 202 "Studime dhe kërkime" është i pasaktë, veprime kontabël këto të trashëguara nga vitet 2009-2010-2011, për të cilat në mungesë të dhënave e dokumentacionit nuk janë kryer veprime rregulluese në kontabilitet. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" "Aneksi 1. "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" pika 2,Klasa 2 "Aktivet Afatgjata" (Përbërja dhe trajtimi kontabël),Pika 3.3 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika

“Aktivet afatgjata jo materiale” (Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 87-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të identifikojë projektet që i përkasin vlerës së pa analizuar prej 2,130,600 lekë dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse. Gjithashtu të kryejë veprimet sistemuere kontabël për aktivet e klasifikuara gabim në gjendjen e kësaj llogarie, duke i kaluar me artikull kontabël në llogaritë përkatëse të aktive që u takojnë.

Deri më 31.03.2023

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,085,472,103 lekë (kosto historike). Referuar analizës së gjendjes të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” konstatohet se, përfshihet një vlerë prej 1,050,872,186 lekë, e cila nuk është e detajuar dhe mungojnë të dhënat se çfarë përfaqëson.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 56,275,100 lekë (kosto historike). Për këto aktive nuk është kryer inventar për verifikimin dhe krahasimin me inventarin kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 (Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 87-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lezhë të ngrrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më 31.03.2023

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 89,741,032.8 lekë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” të bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3, nënpika 59 (Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 87-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Lezhë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri më 31.03.2023

6. Gjetje nga auditimi: KLSH në auditimin e mëparshëm, me vendimin nr.88, datë 02.06.2022, për përmirësimin e gjendjes, i ka rekomanduar Bashkisë Lezhë 34 masa gjithsej,

nga këto 23 masa organizative, 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,235,680 lekë, 2 masa për eliminimin e efekteve negative dhe 2 masa lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë. Masat disiplinore janë lënë që të merren nga Kryetari i Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga KLSH, por nuk është vepruar.

Nga verifikimi, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 23 masa organizative gjithsej të rekomanduara, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Nga 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,235,680 lekë të rekomanduara, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara, nuk është zbatuar asnjë masë.

-Nga 2 masa lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në Bashkinë Lezhë, nuk është zbatuar asnjë prej tyre. Masat disiplinore janë lënë që të merren nga Kryetari i Bashkisë sipas shkeljeve të konstatuara nga KLSH, por nuk është vepruar.

- Bashkia Lezhë, nuk ka respektuar afatet 20 ditore dhe 6 muaj të kthimit të përgjigjes në KLSH për zbatimin e rekomandimeve dhe mbi ecurinë e zbatimit të tyre, ende nuk ka asnjë korrespondencë për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me nenin 15 germa "j" dhe 30 pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" (*Trajtuar më hollësisht në pikën 1, faqe 8-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1.Rekomandim: Bashkia Lezhë, të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përkatësisht gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

"Mjedisi i kontrollit"

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat saj, duke mos kryer dhe dokumentuar monitorimin e sistemit MFK dhe realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Rregullorja e brendshme nuk i përgjigjet si duhet ndryshimeve strukturore të bëra pas miratimit të saj.

"Menaxhimi i Riskut"

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve ka sjellë mos identifikimin e vlerësimit e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

"Aktivitetet e Kontrollit"

- Bashkia Lezhë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave. Nuk ka

ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin, testimin etj.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Lezhë, të marrin masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhet përmirësimi rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartojë programe për zhvillimin e trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së punës së auditit të brendshëm, u konstatua se realizimi i planit në vitin 2021 është i ulët rreth 33.5%, gjë e cila nuk është e argumentuar dhe për ndryshimet e ndodhura nuk është bërë rishikimi i planit. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit, mungon ndarja e detyrave, në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të MFK, raportet nuk janë koncize; gjetjet janë të karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, mungon kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë si dhe nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët; rekomandimet janë jo të mirë përcaktuara). Projekt Raporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve; Pyetëtori i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar. Afatet në fund të Projekt-raportit dhe Raportit Final janë vendosur jo sipas fateve ligjore të përcaktuara. Nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar, po ashtu memo e hartuar është pa adresim gjë që nuk vërteton faktin nëse është përcjellë tek Kryetari i Bashkisë. Në auditimet e kryera për zbatim të rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit, dhe nuk përcaktohen masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë rrisht: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare etj. Procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej, pasi nuk dokumentohej në asnjë nga dosjet e shqyrtuara me plotësimin e anekseve “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë”

dhe “vetëvlerësimin periodik”, duke mos realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

8.1. Rekomandimi: Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve dhe formulimit konkret të rekomandimeve, duke përcaktuar afatet e realizimit. NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të kryhet një planifikim i auditimeve efektiv dhe i realizueshëm. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari, që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2021, u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2021 është 3,030,371 mijë lekë nga 3,911,049.6 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.5%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 602 “Shpenzime operative” në masën 70.7% dhe zëri 230-231 “Shpenzime për investime” realizuar në masën 72.1%. Pra konstatohet një planifikim jo real dhe i pastudiuar i tij.

b. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhet në zërat e shpenzimeve, ku për vitin 2021 janë kryer 56 ndryshime, gjë që tregon një planifikim jo të mirë në fazën e hartimit të PBA dhe buxhetit vjetor, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv.

c. Detyrimet e papaguara për vitin 2021 sipas bilancit janë në shumën **273,627,818** lekë, ose në masën 7.54 % të shpenzimeve të planifikuara, të cilat kanë ardhur duke u ulur, krahasuar me vitin 2020, ku detyrimet janë në shumë të konsiderueshme prej 306,308,895 lekë.

d. Të ardhurat janë realizuar në masën 76.1%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 83% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike, FZHR e Ministrisë e Linjës) dhe 16.9% nga të ardhurat e veta. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42., udhëzimin i MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

9.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme bazuar në treguesit e realizuar në periudhat e mëparshme, me qëllim që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të

ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për uljen e detyrimeve ndaj të tretëve të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Referuar akt-rakordimeve me Thesarin konstatohet se për vitin 2021, të ardhurat nga **703,556.7** mijë lekë të planifikuara janë realizuar **535,113.9** mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 168,442.8 mijë lekë, ose në masën **76.1%**.

Nga analiza e të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, me ndryshime të tilla realizimi edhe për të njëjtën taksë apo tarifë nga njëri vit në tjetrin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pasi nuk është bazuar në llogaritje reale dhe të plotë të kapacitetit fiskal.

Gjithashtu ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet regjistrit në Excel të krijuar me raportet e gjeneruara nga sistemi DATECH në fund të periudhës ushtrimore 2021. Pra akoma nuk administrohen të dhëna të sakta, si për numrin e bizneseve me status aktiv dhe për numrin e vlerat e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” të ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54 “Raportimi financiar” nënpika c, Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime. (Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera drejtuese, për arritjen e një planifikimi të plotë të të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore, të saktësojë treguesit e planit të ardhurave mbi baza reale, duke saktësuar regjistrin e taksapaguesve në lidhje me numrin e bizneseve (aktiv, pasiv e të pezulluar) nëpërmjet të dhënave nga QKR, DRTT e inspektimit në terren etj., për shfrytëzimin e plotë të kapacitetit fiskal.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Në bazë të përpunimit të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga DTTV, rezultoi se ka një numër të lartë debitorësh nga biznesi, (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesë etj), ku nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Në fund të **vitet 2020** numri i debitorëve është **5451 subjekte** në

vlerën prej **232,216,597 lekë** dhe në fund të **vitet 2021** numri i debitorëve është **44349 subjekte** në vlerën prej **241,253,830 lekë**. Për një pjesë të debitorëve konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta, që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave apo tarifave dhe kamatëvonesave të akumuluar, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018, duke filluar nga viti 2011 janë gjeneruar nga sistemi në listim subjektësh debitorë me shumë progresive të debisë, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Nga Sektori i Borxhit për vitin 2021 janë bërë 499 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 190 masa shtrënguese si dhe janë nënshkruar **32 marrëveshje** për likuidim me këste nga subjektet debitorë me vlerë **26,068,589 lekë**, nga të cilat janë arkëtuar brenda vitit 2021 në vlerë **20,601,727 lekë**. Ndërsa për 7 institucionet debitorë në vlerën **2,892,100 lekë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së njoftimit për pagesë të detyrimeve tatimore.**

Nga DTTV për subjektet debitorë në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar ditore si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite, në kundërshtim me ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1. 3, neni 35, me ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, dhe ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkinë Lezhë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuar të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **44349 subjekte** në vlerën prej **241,253,830 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, DPTTV të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana DTTV dhe Drejtoria Juridike Bashkia Lezhë, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- *Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të DTTV rezulton se taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për familjarët për vitin 2021 është realizuar 58,940 mijë lekë nga 54,900 mijë lekë e planifikuar ose në masën 107%. Kjo tregon për një planifikim jo real të bazuar vetëm në derdhjet e Agjentit tatimor UKsha Lezhë, duke përjashtuar në planifikim abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK sha.

Sipas akt-rakodimeve me UK sha debitorë për *taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit* (pastrim-gjellbërim-ndriçim) për **vitin 2021** janë 2003 familje në vlerën 8,282,513 lekë. Nga Bashkia Lezhë nuk është lidhur akt-marrëveshje me UK sha Lezhë, në bazë të së cilës për mosrealizimet e taksës së ndërtesës dhe tarifën e shërbimit dhe pasi evidenton diferencat e pa mbledhura, i lind e drejta për gjobitjen e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Nga krahasimi i numrit të banesave familjare për Bashkinë e Lezhës së bashku me NJA sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke hequr numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë faturuar, si dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat, sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Lezhë rezulton se, për vitet 2020-2021 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga *taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjellbërim-ndriçimit* për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Lezhë, pasi kanë munguar të dhënat nga DTTV dhe Administratorët e Njësive Administrative, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjetës, duke mos hartuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Nga përlllogaritjet e përafërta për periudhën 2020-2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sha, detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit rezulton ***në vlerën 105,804,400 lekë, që janë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Lezhë*** e ndarë: për **vitin 2020** për 15009 familje pa kontratë në vlerën 54,244,400 lekë dhe për **vitin 2021** për 14639 familje pa kontratë në vlerën 51,560,000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime, neni 4 pika 7, neni 35 pika 2, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 70 dhe 117, VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.a “Taksa e ndërtesës” (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, Bashkia Lezhë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartojë regjistrin përkatës me të dhënat dokumentare e të evidentuara në terren, të kryejë njoftimet për familjet taksapaguese si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës e tarifës së pastrim-gjellbërim-ndriçimit. Gjithashtu Bashkia Lezhë të lidhë kontratë dhe të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e **vlerës debitorë prej 20,332,301 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:Taksa e tokës bujqësore për **vitin 2021** është realizuar në shumën 5,105 mijë lekë nga 10,064 mijë lekë të planifikuar ose në masën 50.7%. Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhurnuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme,(sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përlllogarit, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me cfarë etj).

Për vitin 2021 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i regjistrit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në regjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të të dhënave mbi bazën e të cilave janë përlllogaritur detyrimet.

Referuar të dhënave që disponojnë NJA-të, të cilat janë të pa përditësuara, nga përlllogaritjet e përafërta për 14665.8 ha të ndarë në 14382 familje fermere me ligjin 7501 shumëzuar me vlerën vjetore të taksës së tokës të kategorisë V-së prej 2100 lekë/ha, duke zbritur të ardhurat e realizuara rezulton vlera prej **26,680,180 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24, VKB nr. 46, datë 13.11.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b “Taksa mbi tokën bujqësore”, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1.Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK dhe Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjetnjoftim-vlerësimit për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermere dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë (periudhën 2018-2021), u konstatua se në disa raste nga Bashkia Lezhë nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë. Sipas të dhënave të nxjerra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit rezulton se, për 9 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, Bashkia Lezhë ka lëshuar autorizime kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës të vlerës prej 200,000 lekë, pra 1/5 e tarifës së miratuar për licencim (prej 1,000,000 lekë), duke sjellë të **ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë në shumën prej 7,200,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar dhe VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, të marrë masa që të arkëtojnë tarifën e plotë për 9 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me licencë/autorizimet që ushtrojnë aktivitet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve dhe

nënprodukteve të tyre, për diferencën debitore prej 7,200,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Sipas listave të vëna në dispozicion për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), pranë Bashkisë Lezhë sipas shkresave periodike të dërguara nga ish-ALUIZNI (sot ASHK), Drejtoria Rajonale Lezhë rezulton se:

Janë identifikuar 1125 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit, ku për 691 legalizime ka të dhëna për detyrimet, ndërsa për 434 legalizime nuk disponohen të dhëna për sipërfaqen dhe për detyrimin. Nga 691 legalizimet e identifikuara me të dhëna, vlera e detyrimit është 26,504,380 lekë, ku nga këto kanë paguar 407 subjekte vlerën prej 18,375,997 lekë, **duke mbetur pa shlyer nga 284 posedues të lejeve të legalizimit për taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 8,128,383lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë, pa llogaritur 434 legalizimet për të cilat nuk disponohen të dhëna dhe rastet e tjera të paidentifikuara fare në vite, për të cilat nuk përlllogaritet dot detyrimi në vlerë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk ka patur komunikim me ZVRPP Lezhë (sot ASHK) Drejtoria Lezhë, për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për të bashkëpunuar për arkëtimin e kësaj takse nga individët që tashmë kanë kryer legalizime dhe janë debitorë ndaj Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, dhe neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK, Drejtoria Lezhë që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Lezhë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.2.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa për evidentimin e plotë të individëve të pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale që nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për gjithë periudhën e shtrirjes së procesit të legalizimit në Shqipëri, duke hartuar një databazë të plotë me të gjitha të dhënat. Në bazë të këtij databaze të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse në shumën **8,128,383lekë**, nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 2 kontratave të lidhura ish-Komuna Zejmen në vitet 2013-2015 për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme dhe të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit u konstatua se 2 qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet e kontratës për 4 vite (2018-2021), **në vlerën 260,280 lekë e cila përbën dëm ekonomik buxhetin e Bashkisë Lezhë.**Gjithashtu nga

ish-Komuna Zejmen në vitin 2020 ka lidhur 7 kontrata jashtë formatit tip të kontratës, me afat 30 vjet për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 58.49 ha nga fondi pyjor dhe kullor, të cilave u mungon vlera të tarifës së qirasë, si dhe qëllimi i dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore. Nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqeje Bashkia nuk arkëton të ardhura, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë i cili është i pallogaritshëm.

Nga ish-komuna Kolsh dhe sot NjA Kolsh janë lidhur 8 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjor dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera si dhe vendosje antene. Nga këto 6 kontrata janë lidhur në vitet 2012-2013, me afat 10 vite dhe pa vlerë, për të cilat është përlllogaritur për 4 vitet (2018-2019-2020-2021) ***një vlerë debitoare prej 556,740 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Lezhë***. Ndërsa 2 kontrata janë lidhur në vitin 2021 me afat 2 vjet, të cilat kanë likuiduar detyrimet kontraktore. Për të gjithë fermerët që kanë në përdorim parcela pyjore si për ato raste që u ka përfunduar afati dhe për ato kontrata akoma në fuqi, por nuk paguajnë nga Bashkia Lezhë, nuk është kryer asnjë procedurë administrative apo ligjore për detyrimin e pagesës, apo marrjen mbrapsht të parcelave, duke anuluar VKK apo kontratat. Veprime në kundërshtim me Nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar, Manuali i Mbarështimit të Pyjeve, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 49-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1.Rekomandim: Bashkia Lezhë, të ngrëjë një grup pune për verifikimin e parcelave nga fondi pyjor dhënë në përdorim nëpërmjet VKK apo kontratave individëve të ndryshëm, të bëjë saktësimin e të dhënave për sipërfaqet dhe të dhënave të tjera kadastrale, si dhe të identifikojë se për çfarë qëllimi përdoren. Të rishikojë akt-marrëveshjet dhe kontratat në fuqi dhe të negociohet për ndryshimin e kushteve nëpërmjet amendimit të kontratave fillestare. Për kontratat e përfunduara të kryhen veprimet për marrjen në dorëzim të parcelave pyjore, pas detyrimit të individëve që i kanë patur në shfrytëzim të kthimit të sipërfaqeve në gjendjen fillestare.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.2.Rekomandim: Bashkia Lezhë të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore në vlerën 260,280 lekë nga dy qiramarrësit e parcelave pyjore Zef Nika në vlerën 108,000 lekë dhe Gj.M. në vlerën 22,140 lekë

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

M. B.

I.SH.
A.R.
A. H.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B. D.

V. ANEKSET

Aneksi nr.1

Risku i Kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i riskut të kontrollit;

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet, niveli i precizionit pranohet në vlerën **32.890** mijë lekë për **vitin 2021**, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë: - Risku i lidhur me shpenzimin specifik; - Pështja specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit. Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi për 2021, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikulli buxhetor : Precizioni x Faktor risku)
Niveli i materialitetit është përlllogaritur sipas tabelave të mëposhtme:

Bashkia Lezhë viti 2021 (shpenzimet) në 000 lekë			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatë	Faktori i Riskut(mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	419367	2,00	26
Sigurime Shoqërore (601)	69170	0,70	1
Mallra e Shërbime (602)	365760	1,00	11
Investime të brend. (230-231)	1172122	2,00	71
Te tjera transfer. korren (604)	3798	0,70	0
Total	2.030.217		

Materialiteti në %	2%
Materialiteti në vlerë	40.604
Kalkulimi i precizionit	
Materialiteti	40.604
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	4.060
Nëntotali	36.544
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%
Vlera e precizionit	32.890

Bashkia Lezhë viti 2021 (të ardhurat) në 000 lekë			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhura nga taksat e tarifrat	703.557	0,70	43
Të ardhura nga privatizimi			
Total	703.557		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	14.071		
Kalkulimi i precizionit			

Materialiteti	14.071
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1.407
Nëntotali	12.664
Precizionit i planifikuar (80 -90%)	90%
Vlera e precizionit	11.398

Aneksi nr.2

Planifikimi dhe Realizimi i angazhimeve të AB për vitin 2018

Nr.	Objektet e audituara në fakt	Objekte perauditim sipas planit	Nivellit vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objekte të pa audituara mbi 2 vjet	Realizimi
1	Drejtoria Aseteve dhe pronave	Drejtoria Aseteve dhe pronave, Regjistrimi dhe vlerësimi i asetëve, përfshirja në kontabilitet.	I larte	përputhshmërie	jo	po
2	Drejtoria e Bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë, sektori i bujqësisë	I mesem	përformance	jo	po
3	Drejtoria Shërbimeve Publike	Dr. Shërbim publik., Agjencia e Shërbimeve		I kombinuar	jo	po
4	Drejtoria Ujësllësit		I larte	Të kombinuara	jo	po
5	Auditim Tematik (Parking)Drejtoria Shërbimeve Publike ,-Sektori i Transportit		I larte	A. financiar	jo	po
6	Auditim Tematik (Rekomandimet e KLSH) për ish Komunitetin, Ungrej, Kolsh, Zejmen -Për dokumentacionin e prokurimeve Publike sipas rekomandimeve të KLSH-së		I mesem	përputhshmërie	jo	po
7	Zjarrfikësja (Drejtoria e MZSH-se		I mesem	përputhshmërie	jo	po
8	Njësia Administrative Blinisht	NJA Blinisht	I larte	Të kombinuar	jo	po
9	Auditim Tematik (Arkat) Shëngjin		I larte	A. Financiar	Cdo vit	po
10	Auditim Tematik (Arkat) Kallmet		I larte	A. Financiar	Cdo vit	po
11	Auditim Tematik (Arkat) Kolsh		I larte	A. Financiar	Cdo vit	po
12	Auditim (Arkat) Ungrej		I larte	A. Financiar	Cdo vit	po
		Dr. Financës dhe Kontabilit, Hartimi dhe zbatimi i buxhetit dhe PBA		I kombinuar		
		Dr. Burimeve njerzore ,Rekrutimet dhe trajnimet		I kombinuar		
		Dr. Të ardhurave, kapaciteti fiskal për çdo NJA		I kombinuar		
		Dr. Të ardhurave, Arkëtimi i detyrimeve nga biznesi		Financiar		
		Urbanistika, lejet e zhvillimit në zbatim të planit urban		Të kombinuar		
		Dr. Juridike dhe Prok. Publik., Sektori i prokurimeve Publike		përputhshmërie		
		Dr. Shërbim publik., Sektori IT		përputhshmërie		
		Dr. Ars. Kulture dhe Sport., Klubet Sportive		Financiar		
		Dr. Emergjencia Civile, Sektori i mbrojtjes Civile		përputhshmërie		
		NJA Shënkoll		Të kombinuar		
		NJA Dajç		Të kombinuar		
		Inspektorati i Ndërtimit IMTV		përputhshmërie		
	12 auditime të realizuara	16 angazhime të planifikuara				

Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2021

Nr.	Objektet e audituara në fakt	Objekte per auditim sipas planit	Nivellit vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objekte të pa audituara mbi 2 vjet	Realizimi
1	Drejtoria Emergjencave Civile	Dr. Emergjencave Civile	I larte	Performance	po	po
2	Drejtoria Bujqësisë	Dr. Bujqësisë, Ujtitjes dhe Kujdesit Social	I mesëm	përputhshmërie	po	po
3	Njësia Administrative Kolsh	Njësia administrative Kolsh	I mesëm	përputhshmërie	po	po
4	Njësia administrative Blinisht	Njësia administrative i Blinisht	I larte	përputhshmërie	po	po
5	Njësia administrative Kallmet	Njësia administrative i Kallmet	I larte	përputhshmërie	po	po
6	Njësia administrative Shëngjin	Njësia administrative Shengjin	I mesëm	përputhshmërie	po	po
7	Drejtoria Taksave Vendore		I mesëm	Me kërkesë Titullar	po	po
8	Ndjekur zbatimi rekomandDr.Bujqesis			e		po
9	Zbatim rekomandimesh NJA Kolsh			e		po
10	Zbatim rekomandimesh Kallmet			e		po
11	Zbatim rekomandimesh Blinisht			e		po
		Drejtoria Juridike, Sektori i i Përputhshmërisë Ligjore, Përfaqësimi dhe Prokurimeve Publike		përputhshmërie		jo
		Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i hartimit dhe Zbatimit të Buxhetit dhe pagave.		përputhshmërie		jo
		Dr. Burimeve Njerzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse		përputhshmërie		
		Urbanistika, Sektori i Hartimit të Projekteve		përputhshmërie		jo
		DR. Arsimit dhe Rinisë dhe Sporteve, Konvikti i shk .mesme profesionale		i kombinuar		jo
		Klubi Sportiv Besëlidhja				jo
		Dr.Sherb.Publike Transp Infrastr dhe Mjedisit., Sektori i shërbimeve Mbikëqyrjes, Sipërmarrje Pastrim-gjelbërim		përputhshmërie		jo
		Dr.Sherb.Publike Transp Infrastr dhe Mjedisit., Sektori i Shërbimeve publike dhe Mirëmbajtjes së institucione		përputhshmërie		jo
		Ndermarrja.UK sha Lezhë		përputhshmërie		jo
		Drejtoria MZSH		përputhshmërie		jo

7 auditime të realizuara dhe zbatim rekomandim	16 angazhime të planifikuara	11		
------------------------------------------------	------------------------------	----	--	--

Aneksi nr.3

Detyrimet e prapambetura për fatura të pa likuiduara

Në lekë

Nr	Objekti	Kreditore	Numri i Faturave	Kreditor me dt.	Likuiduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.12.2020			
1	Furnizimi me uje deri Qershor2019	Ujesjelles Sh.a	486	25,306,644		3,444,866	28,751,510
2	Sherbimi Postar deri Qershor 2019	Posta Lezhe	338	4,263,201	4,263,201		-
3	Materiale Ndertimi	S. Shpk	11	6,271,454		2,245,198	8,516,652
14	Krevate +karrige	E. L.	1	625,800	625,800		-
15	Sh Dezinfektim	H.E.G.	1	233,940	233,940		-
16	Automjete	T.SHPK	1	17,158,800	17,158,800		-
17	Kancelari	I.O.	1	490,935		45,757	536,692
18	Materi elektrike per ndricimin rrugor	D. A Shpk	5	2,573,185	2,573,185		-
22	Sherbim Autom. Policia Bashkiake	E. P.	2	590,880	590,880		-
23	Bllok fjetje ne hotel	Shtypshkr letra me vlere	1	720,000		64,500	784,500
24	Shpenzime gjyqesore	TT A. L.	-	1,371,429	1,371,429		-
25	Mb. Pun.Parki e Lulisht shesh perball shk Hydaje Lezha	I.D	1	34,800			34,800
26	Mbik pun Rivesh rrug Pran Shko 9 Vjec Marash Gjoni	I. D	1	117,277	117,277		-
27	Mb PunRr. Zalle Shenkoll +Mb. Pun. Asf Rr. Tale 1 Alk Tale 2+ Nd. Trot. Manati	P.C.	1	870,732	870,732		-
28	Mbikqyrje punimesh kanali vadites	N. M.	1	276,600	276,600		-
29	Mbikqyrje punimesh	R.-95 Shpk	1	554,004	554,004		-
30	Sherbim larje rruge	L. 2007 Shpk	1	568,435	568,435		-
31	Kryepleq viti 2016-2019	-	-	1,444,800	1,444,800		-
32	Pastrim NJA Dajc Kallmet Blinisht Balldren	Nderkom. zadrime	1	689,085	689,085		-
33	Shpronosime	-	-	126,103,140			126,103,140
34	Gaz	S.&Co shpk	1	209,364			209,364
35	Tabela sinjalistike	S.S.Al	1				2,231,400
36	Ushqime	L.G. Shpk	3				914,464
37	Kancelari per zyrat	A.Shpk	1				2,676,328
38	Sherbim DDD	M. Shpk	1				209,758
39	Hartim PDV	UTS	1				11,932,200
40	Sist. Asf.Rr. varrezaveBalldre	D.A Shpk	1	1,563,800	1,563,800		-
41	Rik. rrug Zall Shenkoll e rruges se varrezave	K. C.	2	3,537,148	3,537,148		-
42	Rruga Luigj Gurakuqi	A.B. Shpk	1	2,346,428			2,346,428
43	Rruga Superstrate Piraj	A.C.	2	6,675,040			6,675,040
44	Sist. Asf. rruge brendsh FshatTroshan	Sh. 07 Shpk	2	2,088,200	2,088,200		-
45	Sist.Asf Rr. Qender- Rrabosh - Shkoll 9 vj	Sh. 07 Shpk	2	3,993,600			3,993,600
46	Sist. Asf. Rr.te brendshme Fshati Gramsh	N. Shpk	1	5,972,719			5,972,719
47	Sis. Asf. Rruge te brendshme Fshati Mabe	N.Shpk	2	10,279,300			10,279,300
48	Asf. Rr.Brend Tresh	D.A Shpk	1	4,662,700	4,662,700		-
49	Sist. Asf. Rr.Çameria	N. Shpk	1	9,688,352			9,688,352
50	Sistemim Asfaltim Blloku Lagjia Beselidhja	N.Shpk	1	3,259,808	3,259,808		-
51	Sist Asf RrugKakarriq –Gocaje Ndric Qend Kakarr	C. R. 2008	1	5,245,680			5,245,680
52	Sist Asf Rrug Kolin Gjoka nga Qend OLA te tunel	U.N. Shpk	1	5,409,250	5,409,250		-
53	Sist. Asf. Rr. e Varrezave Pllane	K.shpk	1	1,480,074	1,480,074		-
54	Nd.trotuari fshatin Manati	U. N. Shpk	1	1,390,724	1,390,724		-
55	Sherbim GPS	P.Shpk	1	88,048	88,048		-
56	Asf. Rr. Brend Lagjia e Pukjaneve	C. R. 2008Shpk	1	5,912,173			5,912,173
57	Sist.Asf. Rr. Gjok Nika	N. Shpk	1	106,630			106,630
58	Sist. Rr. Hydajet Lezha Perballe Hotel L.	N. Shpk	1	6,872,138			6,872,138
59	Sist. Asf. Bll. Lagjia Beselidhja tek DTT	N. Shpk	1	900,036	900,036		-
	Shuma Bashkia deri 31.12.2020			271,946,353	55,717,956	5,800,321	239,992,868

Detyrimet e trashëguara nga ish-Komunat që nga viti 2015

Nr	Objekti	Kreditore	Numri i Faturave	Kreditor me dt.	Likuiduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.07.2015			
	Komunat			31.07.2015			
	Komuna Shengjin						
1	Rikualifikim Urban Shetitorja Eïllson	F.shpk	3	17,495,807			17,495,807
2	Punime sherbimi pagese karte Telefonike	F. shpk	1	552,000			552,000
	Komuna Dajc						-
1	Pyllezim shega	4 A. Shpk	1	4,907,937			4,907,937

Komuna Kolsh							-
1	Furnizimi me uje Kolsh Viti 2010-2016	U.Sh.a	37	4,669,581	727,592		3,941,989
2	Sherbimi Postar Kolsh viti 2009-2013	P.Lezhe	71	420,376			420,376
4	Mbikq Punime Ndert I Tregut Agroushqimor	L.B.	1	664,013			664,013
	Vendim gjykate tregu Kolsh		1	918,831			918,831
Komuna Balldren							-
1	Sherbim Interneti	G.N.	1	150,000			150,000
2	Blerje Librash	A. D.	1	32,500			32,500
3	Blerje Nafte	V. shpk	1	112,000			112,000
4	Blerje shtypshkrimesh	Enti botues Gj. F.	2	12,240			12,240
5	Blerje Nafte	Gj. K.	1	350,000			350,000
6	Sistemim asfaltim rruga Malecaj/Balldre	B.shpk	1	1,008,228			1,008,228
7	Projekte(kontrate)	A.Xh.	-	1,100,000			1,100,000
8	Projektime(me kontrate)	A.S.	-	499,999			499,999
9	Punime shkolle	D. I.	1	374,400			374,400
10	Mbikqyrje punimesh	L. V.	1	14,280			14,280
11	Blerje Kancelarish	Kancelari K.	1	63,700			63,700
12	Sherbim Interneti Janar Shkurt 2016	Z.M.	1	20,000			20,000
13	Sherbim Interneti	R. Com Shpk	1	163,550			163,550
14	Sherbim Interneti	R. Com Shpk	1	150,000			150,000
15	Mbikqyrje punimesh Rikonstr Rruga Balldren	N. M.	1	47,400			47,400
16	Flamuj	E. C.	1	10,000			10,000
17	Kancelari	M. Z.	1	30,000			30,000
18	Pjese kembimi	B. P.	1	14,800			14,800
19	Dosje	K. K.	1	1,200			1,200
20	Kabull	L. c.	1	20,500			20,500
21	Pompe Uji	A.Z.	1	9,000			9,000
22	Riparim elektropompe	B. K.	1	30,000			30,000
23	Pjese kembimi	P. L.	1	520,200			520,200
Shuma ish-Komunat				34,362,542	727,592		33,634,950
Totali Bashkia + komunat				306,308,895	56,445,548	5,800,321	273,627,818

Aneksi nr.4

Ndryshimet e buxhetit per vitin 2021

Në lekë

Ndryshimet buxhetore për vitin ushtrimor 2021 sipas VKB dhe Kryetarit të Bashkisë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nëlekë

Buxheti fillestar			Ndryshime gjatë vitit		Shtesa / pakësime në artikullin			
Periudha buxhetore	Nr./datë	Prog.	Nr. datë vendimi	Vlera	Shtesë artikulli	Shuma	Pakësime artikulli	Shuma
Viti 2021	Nr. 172, datë 27/11/2020	01110		682,194,396	602 mallra e shërbime	5,125,286		
		01110			231 investime	1,647,968		
		01120			231 investime	53,340		
		01710			166/651 Kredi - interes	393,839		
		03140			602 mallra e shërbime	44,438		
		03280			601 sigurime shoqërore	18,025		
		03280			602 mallra e shërbime	876,679		
		03280			606 Fond i veçantë	43,877		
		03280			231 investime	513,000		
		03600			231 investime	648,210		
		04240			601 sigurime shoqërore	89,230		
		04240			602 mallra e shërbime	1,160,864		
		04240			606 Fond i veçantë	143,000		
		04240			231 investime	969,725		
		04260			601 sigurime shoqërore	88,683		
		04260			602 mallra e shërbime	198,780		
		04260			606 Fond i veçantë	113,000		
		04520			600 paga	268,979		
		04520			601 sigurime shoqërore	88,461		
		04520			602 mallra e shërbime	312,162		
		04520			231 investime	34,931,373		
		04690			606 grante termeti	7,650,000		
		05100			602 mallra e shërbime	50,400		
		06140			602 shëmbje banesash	49,633,459		
		06140			230 studim-projektime	33,805,575		

	06140			231 investime - termeti	414,181,173		
	06260			602 mallra e shërbime	568,435		
	06440			602 mallra e shërbime	1,174,176		
	08220			231 investime termeti	26,000,000		
	09120			600 paga	1,587,054		
	09120			601 sigurime shoqërore	176,544		
	09120			602 mallra e shërbime	1,943,888		
	09120			606 Fond i veçantë	295,953		
	09120			231 investime	48,815,180		
	09230			600 paga	1,925,724		
	09230			601 sigurime shoqërore	552,531		
	09230			606 Fond i veçantë	259,000		
	09230			231 investime	13,374,076		
	09240			600 paga	24,324		
	09240			601 sigurime shoqërore	11,292		
	09240			602 mallra e shërbime	104,000		
	09240			606 Fond i veçantë	157,000		
	09240			231 investime	31,026,660		
	10430			602 mallra e shërbime	30,000		
	10430			231 investime	510,000		
	10661			602 mallra e shërbime	609,033		
	08220	Nr.19, 04.02.2021	104,000,000	231 investime Fonde përtërmetin	104,000,000		
	01110	Nr.22, 16.02.2021	599,216			609 Fond Kontigjence	599,216
	08220			231 investime	599,216		
	01110	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.36, 23.02.2021	3,448,620			602 detyrime prapamb.	3,348,620
	01110					606 fond i veçantë	100,000
	01110			604 Kuota qarku + 1 %	3,448,620		
	01110	Nr.26, 24.02.2021	550,101			609 Fond Kontigjence	550,101
	04520			231 investime	550,101		
	01110	Nr.29, 24.02.2021	60,000			609 Fond Kontigjence	60,000
	06260			602 shpenzime varrimi	60,000		
	09120	Nr.30, 24.02.2021	8,463,601	600 paga	7,252,443		
	09120		Fond i akorduar nga MFE	601 sigurime shoqërore	1,211,158		
	09120	Vend. Kr. Bashkisë Nr.45, 03.03.2021	100,000			602 pagesë mësues jashtëm	100,000
	09120			602 Certifikim pajisjesh	100,000		
	01110	Nr.54, 30.03.2021	1,000,000			609 Fond Kontigjence	1,000,000
	01110			602 shpenzime kadastrale	1,000,000		
	01110	Nr.55, 30.03.2021	96,500			609 Fond Kontigjence	96,500
	06260			602 shpenzime varrimi	96,500		
	04520	Nr.56, 30.03.2021	14,519,000			231 investime	14,519,000
	05100			602 shpenzime pastrimi	14,519,000		
	08220	Nr.57, 30.03.2021	93,600,000	231 investime fond termeti	93,600,000		
	06140	Nr.58, 30.03.2021	78,088,867	231 investime fond termeti	78,088,867		
	01110	Nr.77, 19.04.2021	1,150,000			609 Fond Kontigjence	1,150,000
	10430			606 Ndihmë ekonomike	1,150,000		
	03280	Nr.78, 19.04.2021	794,900			602 mallra e shërbime	794,900
	03280			602 shpenzim ura Kalivaç	794,900		
	01110	Nr.85, 30.04.2021	100,000			609 Fond Rezervë	100,000
	10430			606 Ndihmë financiare	100,000		
	06140	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.171, 19.05.2021				230 Oponencë teknike	1,100,000
	06140			231 investime Hartim projektsh	1,100,000		
	01110	Nr.86, 30.04.2021	50,000			609 Fond Rezervë	50,000
	10430			606 Ndihmë financiare	50,000		
	10430	Nr.91, 30.04.2021	4,141,612	600 Paga	279,089		
	10430		Fond shitesë	601 Sigurime	55,951		

	10430		nga	602 mallra e shërbime	2,931,572		
	10430		MSHMS	231 investime	875,000		
	04220	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.171, 19.05.2021	191,000			602 Blerje blloqe e certif	191,000
	04220			602 Aktivit."Dita botërore e bletarisë"	191,000		
	08220	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.233, 07.06.2021	135,000			602 Aktivitete kulturore	135,000
	08220			602 Pagesë anëtarëve të Këshillit Artistik	135,000		
	08220	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.266, 24.06.2021	10,800			602 Biblioteka levizëse	10,800
	08220			602 Blerje librezat, kartela për bibliotekën	10,800		
	01110	Nr.104, 29.06.2021	327,888			609 Fond Kontigjence	327,888
	04240			231 investime	327,888		
	01110	Nr.108, 29.06.2021	50,000			609 Fond Kontigjence	50,000
	06260			602 Shpenzime varrimi	50,000		
	04760	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.278, 05.07.2021	1,200,000			602 Promovim turizmi	1,200,000
	04760			602 Projekt turizmi virtual	1,200,000		
	4760		350,000			602 Festivali gastronomisë	350,000
				602 Hapja sezonit Turistik			
	01110	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.304, 23.07.2021	1,700,000			602 shpenzime operative	1,700,000
	01110			231 investime Bl.pajisje kondicionimi dhe zyre	1,700,000		
	01120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.309, 28.07.2021	190,000			602 Mirëmb.sistemi Datech	190,000
	01120			602 Marrje magazinë qira	190,000		
	01110	Nr.123, 29.07.2021	1,097,586			602 Shërbim konsulence	1,097,586
	06140			231 investime	1,097,586		
	09120	Nr.115, 29.07.2021	107,000			600 Paga	82,000
	09120					601 Sigurime	13,000
	09120					606 Fond i veçantë	11,000
	09230			600 Paga	107,000		
	09230					606 Fond i veçantë	1,000
	04520	Nr.121, 29.07.2021	58,936,598	231 investime Rindërtim të urës Lezhë	58,936,598		
	06140	Nr.122, 29.07.2021	17,835,093	231 investime Rindërtim banesa individuale	17,835,093		
	09120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.325, 20.08.2021	1,000,000			602 Mirëmbajtje kaldajash	1,000,000
	09120			231 F/V kaldajash	1,000,000		
	09230	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.326, 20.08.2021	150,000			602 Aktivitete rinore	150,000
	09230			231 Blerje pajisje për aktivitetet rinore	150,000		
	03600	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.333, 26.08.2021	73,000			602 Takime informuese	73,000
	03600			231 Blerje pajisje për zyrën e shtypit	73,000		
	01110	Nr.125, 30.08.2021	30,000			609 Fond Rezervë	30,000
	10430			606 Ndihmë financiare	30,000		
	08130	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.344, 08.09.2021	54,000			602 Aktivitete sportive	54,000
	08130			602 Pjesëmarrje Kampionatit Ballkanik Atletëve	54,000		
	01120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.361, 20.09.2021	120,000			602 Shp.barrë hipotekore	120,000
	01120			231 investime Blerje rafta metalik	120,000		
	03280	Nr.132, 04.10.2021	9,101,416			602 Fond emergjence	9,101,41
	03280			231 investime nd.urash	9,101,41		
	01110	Nr.136, 04.10.2021	30,000			609 Fond Rezervë	30,000
	08220			606 Mbështetje financiare	30,000		

	01110	Nr.138, 04.10.2021 Rishikim buxheti shitesa e pakësime	76,458,310			602 Shërbime	3,902,414
	01110					602 Kuota qarku	3,348,620
	01110					231 investime rik.zyrash	35,500,000
	04260					231 investime bl.automj.	1,200,000
	04520					606 Shpronësime	3,000,000
	04520					231 investime	18,113,388
	04760					602 aktivite	2,031,000
	05200					231 investime	11,660,000
	06260					231 investime	4,300,000
	06330					231 investime	4,600,000
	06440					231 investime	10,000,000
	07220					231 investime	2,000,000
	08220					231 investime	400,000
	08220					602 Shërbime - aktivite	605,000
	09120					602 Shërbime - aktivite	300,000
	09120					231 investime	600,000
	09230					602 Shërbime - aktivite	350,000
	09230					231 investime	500,000
	10220					606 Pagesa honorare	200,000
	10430					602 Shërbime - aktivite	800,000
	01110					602 Mallra e shërbime	252,112
	01110					231 investime Rik.objekti	2,000,000
	04240					231 investime	1,200,000
	06140			230 investime - projekte	20,000,000		
	08130			602 Mallra e shërbime	700,000		
	08130			602 Pagesa për sportin	300,000		
	09120			231 investime rik.palestre	2,500,000		
	01110	Nr.140, 04.10.2021	110,000			609 Fond Rezervë	110,000
	06260			602 Shpenzime varrimi	110,000		
	06260	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.381, 20.10.2021	2,499,040			602 Shpenzime dekori	2,499,040
	06260				602 Bl. mallra e materiale	2,499,040	
	01110	Nr.146, 28.10.2021	100,000			609 Fond Kontigjence	100,000
	06260			602 Shpenzime varrimi	100,000		
	06260	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.418, 11.11.2021	618,936			231 investime	618,936
	06260				231 investime supervizim	618,936	
	10430	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.436, 23.11.2021	70,000			602 Aktivite	70,000
	10430				231 Blerje lava-triçe për çerdhen	70,000	
	09230	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.438, 24.11.2021	200,000			602 Mirëmbajtje kaldaje	200,000
	09230				602 Blerje peleti për ngrohje	200,000	
	09120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.454, 09.12.2021	80,000			602 Analiza uji i pijshëm	80,000
	09120				231 investime Bl. Pompë zhytëse	80,000	
	09120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.463, 16.12.2021	30,000			602 Aktiv. 28-29 Nëntor	30,000
	09120				602 Aktivite për festat e fundvitit	30,000	
	10430	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.467, 17.12.2021	120,000			602 Aktivite k/dhunës	120,000
	10430				602 Blerje pako ushqimo-re	120,000	
	09120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.469, 21.12.2021	38,000			602 Blerje ushqimesh	38,000
	09120				231 Blerje batanijash për kopshtet	38,000	
	09120	Vendim i Kryetarit të Bashkisë Nr.474, 22.12.2021	111,400			602 Blerje ushqimesh	111,400
	09120				231 Blerje enë kuzhine për	111,400	

				kopshtet				
	01110	Nr.173, 23.12.2021	30,000				609 Fond Rezervë	30,000
	10430			602 Ndhimë financiare	30,000			
	03280	Nr.174, 23.12.2021	88,650				606 Fond emergjence	88,650
	03280		Djegje banese	606 Ndhimë financiare				
29 ndryshimeme VKB		23 me V. Kryetari						

Burimi: Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga BashkiaLezhë.

Aneksi nr.5

Projektet e investimeve sipas burimeve te financimit

Viti 2020										
Nr.	Institucioni	Burimi I financimit	Objekti	Fondi (leke me TVSH)/ Buxhet	Operatori ekonomik fitues	Vlera e Kontratesme TVSH	Data e lidhjes se Kontrates	Afati i parashi kuar (dite)	Likujdimi faktik me TVSH	Mbetur pa likujduar vlera e kontrates
1	Bashkia	ardhura	Blerje motorsharre profesionale	353667	x	291600	0	0	291600	
2	Bashkia	Tr.pakus	Blerje ndricues LED-	40000000	Light	37938000	26.05.2020	45 dite	37938000	
3	Bashkia	ardhura	Blerje eskavator me zinxhir	11402400	T. SHPK	11402400	05.05.2020	10 dite	11402400	
4	Bashkia	ardhura	Blerje fadrome me gome	4000000	T.SHPK	3690000	05.05.2020	10 dite	3690000	
5	Bashkia	ardhura	Blerje fadrome e vogel	2000000	T. SHPK	1771200	05.05.2020	10 dite	1771200	
6	Bashkia	ardhura	Blerje makine me kosh	2214000	T. SHPK	2214000	05.05.2020	10 dite	2214000	
7	Bashkia	ardhura	Blerje kamion fshires	3000000	T. SHPK	2673600	05.05.2020	10 dite	2673600	
8	Bashkia	ardhura	Bl makin ngjesh plakash trotua	868800	TIMAK SHPK	868800	05.05.2020	10 dite	868800	
9	Ministri Infrastru	Grant	Ndert ujesjellfsh Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh	298801000	SH. SHPK-47.45%	140384087	18.06.2020	0	74992582	65391505
9	Ministri Infrastru	Grant	Ndert ujesjellfsh Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh	298801000	N.S -11.51%	34053126	18.06.2020	0	18191036	15862090
9	Ministri Infrastru	Grant	Ndert ujesjellfsh Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh	298801000	G. COMPANY 41.04%	121419662	18.06.2020	0	51576434	69843228
10	Ministri Infrastru	Grant	SupervNdert Ujesjellfsh Pllane, Zejmen,Markatoj,Spiten, Tresh	3673842	XH&M. shpk	3149752	21.07.2020	18 muaj	1429949	1719803
11	Bashkia	ardh Gra	Mirem sistem asfalt rruge rurale	306558108	P. G.	303018300	18.08.2020	36 muaj	172929240	130089060
12	FZSHH	Grant	Rehabi kanal ujites Koterr-Rrabosh, Segm Koterr -Nnashat dhe segmenti Piraj -Rraboshite	46199992	N.S SHPK-60% M.shpk-40%	46096540	18.09.2020	4 muaj	46099540	
13	shteti	Gra/MF	Rikons Gjimm Hydjat Lezha	15000000	K. c.	14985961	11.09.2020	1 muaj	14985961	
14	shteti	Gra/MF	Kolaupunim:RikGjim H Lezha		L. C.	37655			37655	
15	Ministria Rinderti	Grant	Hart Proj. te nderhy rehabi per objektet e demtuara nga termeti	63483700	A. N.	63383700	27.10.2020	39 dite	63383699	1
16	Bashkia	ardhura	Mbikq "Miremb sist asfarrug rur	2208805	T.SHPK	1944851	15.10.2020	36muaj	600874	1343977
17	Bashkia Lezhe	Grant	Mbikq te obj.te Rik godin se vjeter se Gjimm Hydjat Lezha-	313796	M. SHPK	264750	21.09.2020		263590	1160
18	Buxhet Shtetit	Grant	Mbikq puni te obj.Rehabi I kanal ujit Koterr-Rrabosh, segm Koter-Nnashat e segm Piraj -Rraboshite	945040	N. M. PF	850075	23.09.2020		850075	
19	Bashkia	ardhura	Blerje Materi te buta per kopshte	305392		276600			276600	
20	Ministria Rinderti mit	Grant	Shembja objektete demtuara nga termeti e transport materi te dala nga shembjae tyre.	46775578	SH. 50% N.S -50%	46687718	17.11.2020	48 dite	46687718	
21	Bashkia	ardhura	Bl krevat, karrig cerdhe e kopshte	770322	E. L.	625800		8 dite	625800	
22	Bashkia	ardhura	Sist e rikonyres me nje ndalese	1496891	C.Shpk	1181340	23.11.2020	42 dite	1181340	
23	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Bl.paisje(frigorif+pushore)për kopshtet dhe magazines	120000		80000	0	0	80000	
24	Bashkia	ardhura	Bl.mat te buta per kopshtet	375672	E. L.	273600			273600	
25	Ministria Rinderti mit	Grant	Mbikq "Shemb e objekt te pa banueshdemtuar nga termet e transp mater dala nga shembja.	543901	M.SHPK	551017	19.11.2020		459181	91836
26	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Rikons Shk. mesme Kallmet e Rik shk 9-vjecare Manati	8030915	K.K.	8022467	05.01.2021	0	8022466	1
27	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Permires infrastrukt e sigurise ne shetitoren e lumit Drin	37998728				0		
SHUMAPer vitin 2020				1.495.042.549		848.136.601			563796 940	284342661
Viti 2021										
Nr.	Institucioni	Burimi I financimit	Objekti	Fondi (leke me TVSH)/ Buxhet	Operatori ekonomik fitues	Vlera e Kontratesme TVSH	Data e lidhjes se Kontrates	Afati i parashi kuar (dite)	Likujdimi faktik me TVSH	Mbetur pa likujduar vlera e kontrates
1	Buxhet Shteti	Ministr Infrastruktures	Ndert Ujesjellesifshatrat Pllane, Markatomaj, Zejmen,Spiten, Tresh--LOTI I 2	160,801,124	Sh. Shpk 50.3%	80,791,893	07.04.2021	18 muaj	51,386,544	29 405 349
2	Buxhet Shteti	Ministri Infrastruktures	Ndretim Ujesjellesi ne fshatrat Pllane,Markatomaj,Zejmen,Spiten, Tresh--LOTI I 2	160,801,124	NG S. 49.7%	79,829,173	07.04.2021	18 muaj	50,773,583	29055590
3	Buxhet Shteti	Ministri Infrastruktures	Mbikq:Ndert Ujesjellfsh:Pllane, Markatomaj, Zejmen,Spiten, Tresh LOTI2	2,531,909	A.SH E.	2,234,596	26.03.2021	18 muaj	1,148,919	1085677

4	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Permires infrastrukt dhe sigurise ne shetitoren e Lumit Drin"2 Urat"	31,665,607	P.-U6	31,498,151	17.02.2021	6 muaj	22,063,335	9434816
5	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Permires infrastrukt dhe sigurise ne shetitoren e Lumit Drin"2 Urat"	6,333,121	P.-U6	6,299,630	17.02.2021	6 muaj	5,633,282	666348
6	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Mbikq: Permires infrastrukt dhe sigurise ne shetitoren e Lumit Drin"2 Urat"	901,337.0	M.A.K S.	684,299	11.03.2021	6 muaj	583,762	100537
7	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Mbikq: Permires infrastrukt dhe siguri ne shetitoren e Lumit Drin"2 Urat"	901,337.0	M.A.K S.	136,859	11.03.2021	6 muaj	94,000	42859
8	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Vleres I ndikimit ne mjedis 2 Urat	120,000.0	E. S. Shpk	117,600			117,600	
9	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rikons Mjedise ne Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Nderesat Pallat te prekura nga termeti	214,635,977	U. SHPK	211,461,570	18.02.2021	11 muaj	159,964,076	51497494
10	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Mbikqyrje Rikons Mjedise Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Nderesat Pallat te prekura nga termeti		H.&S 11 SHPK	2,900,000	16.03.2021	11 muaj	2,146,000	754000
11	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rikons Mjedise ne Bashkepron ose Perbashke ne Nderes Pallat prekur ngatermeti LOT II	92,506,912	R.&H. C.	92,410,112	14.06.2021	6 muaj	81,042,367	11367745
12	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Mbikq: Rikons Mjedise be Bashkepron ose Perbashke ne Nderes Pallat prekermeti LOT II	1,415,687	M.HPK	1,400,000	03.08.2021	6 muaj	1,015,000	385000
13	Buxhet Shteti	Ministri Infrastru	Ndert Ujes zon Bregd NJA Shenkoll	797,285,402	A.N.K SHPK	786,272,802	11.02.2021	48 muajs	188,378,404	597 894 398
14	Buxhet Shteti	Ministri Infrastru	Mbikq: NdertUjes zon BregdNJAShenko	5,580,997	A&E E.	4,783,712	05.05.2021	48 muaj	1,575,657	3208055
15	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rindert KonvikShkProfes K. Gjok	152,372,490	G. K.	151,500,000	24.12.2020	8 muaj	30,547,605	120952395
16	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Mbikq "Rindertimi shkollës se mesme Profesionale Kolin Gjoka	1,527,534	M.SHPK	1,510,000	12.04.2021	8 muaj	302,000	1208000
17	Bashkia Lezhe	05	Bl Automjet per e Drejtorise se Sherbimit &Kujdesit Social	874,560	A. G. shpk	870,000	15.07.2021	2 dite	870,000	
18	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Hartim projekt nderhy rehap per kthim e strukturobjekte klasifiku me demtim te medha strukturo dhe jostrukturore	11,823,500	N.-G. Shpk	11,468,795	6884/20 dt 24.06.2021	15 ditesh	9,748,476	1720319
19	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rindertimi I shkollës 9-vecareAt Zef Pllumbi -Njesia Adm,Zejmen	220,523,000	N. C.	220,376,980	16.02.2021	6 muaj	218,049,815	2327165
20	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Mbikqyrje Punimesh "Rindertimi shkollës 9-vecare AT Zef Pllumbi	2,420,240	G.0% K.-P. 80%	2,400,000	1725/23 dt 08.03.2021	6 muaj	2,015,414	384586
21	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Harti PlaneDetaju Vendore (PDV)	12,374,519	U.01 SHPK	11,932,200	18.06.2021	45 dite		11,932,200
22	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rifocimpallat e banesat individ ne kuader te rindert ne territ e Bashki	503,024,890	L.C.SHP.K-60 %	301,012,860	19.04.2021	11 muaj	50,330,983	250681877
23	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rifocimpallat e banesat individ ne kuader te rindert ne territ e Bashki	503,024,890	E. SHPK-40%	200,675,240	19.04.2021	11 muaj	51,746,797	148928443
24	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rifocimpallat e banesat individ ne kuader te rindert ne territ e Bashki	6,283,246	M.	6,200,000	12.02.2021	11 muaj	1,426,000	4774000
25	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Blerje pajisje per sistemimin e zyrate te administrates se Bashkise	471,840	Sh. Shpk	379,680	02.08.2021		379680	0
26	Bashkia Lezhe	Te ardhura	Blerje pajisje kondicionimi per zyrate dhe keshillin bashkiak	1,195,200	H. C.	1,185,600	27.07.2021		1185600	0
27	MF fond emergjen	Grant sektorial	Rikon e Rehab Urave Malecaj, Lalm i RI,Kalivac,Kolsh Ungrej	8,851,890	A. I. G.C.	403,095	19389 dt 30/12/2021			403095
28	MF fond emergjen	Grant sektorial	Rikon e Rehab Urave Malecaj, Lalm i RI,Kalivac,Kolsh Ungrej	8,851,890	L. C.	7,658,812	19389 dt 30.12.2021			7658812
29	MF fond emergjen	Grant sektorial	MbikqRik e Rehab Urave Malecaj, Lalm i RI,Kalivac,Kolsh Ungrej	212,444	P. D. 2019 & R. Shpk	194741.00	21590/6 dt 10.01.2022			
30	Bashkia	Grant	Rikonstruk I KU Koterr-Kakarriq	327,888	K. C.	327,599			327,599	-
31	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rindert 40 njesi indivibanim Lezhe	88,933,510	K.K.	88,855,210	14.12.2021			88855210
32	Bashkia	ardhura	Rrethim sist varrezNJAt e B Lezhe	28,586,064	L.C.	27,986,064	05/11/2021			27986064
33	Bashkia	ardhura	Mbikq:Rreth sist varrNJAB Lezh	409019	P. G.	398,830	29/12/2021			398830
34	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Rindert Ure e Zeze mbi Lumin Drin&Rehabil I rr Inxhinier Gjadri	290,013,771	GPG	85,604,492	24.01.2022			
35	Ministria Rindertimit	Buxhet Shteti	Mbikq : Rindert Ure Zeze mbi Lum Drin&Rehabil I rr Inxhinier Gjadri	3,808,853	M. Shpk	3,750,000	670/15 dt 04.03.2022	-	-	
36	Bashkia	ardhura	Blerje Automjeti te ri Zjarrfikes	11,970,600	S. CO SHPK	11,850,600	19.11.2021			11850600
37	Ministria Rindert	Buxhet Shteti	Perforcim dhe Rikoi Bibliotekes Gjergj Fishta &Rikoi pallatit te Kultures Ded Ndue Lazri	241,578,098	J. SHPK	236,725,554	21.01.2022			
38	Ministria Rindert	Buxhet Shteti	Mbikqyrje :Perforcim dhe Rikoi Bibliotekes Gjergj Fishta &Rikoi pallatit te Kultures Ded Ndue Lazri	2,864,729	P. G. Shpk	2 800 000				
			SHUMAPer vitin 2021	3577396180		2873759150			932472818	1414959464

Aneksi nr.6

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitet 2020-2021 referuar akt-rakordimit me Dgën e Thesarit Lezhë

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2020				Viti 2021			
		Plani Fillestar	Plani Rishikuar	Fakti	Në %	Plani Fillestar	Plani Rishikuar	Fakti	Në %
I	Të ardhurat nga taksat (I/a +I/b)	408,215	375,428	189,480.6	50.5	518,074	441,615.7	324,013.6	73.4
I/a	Vendore (1-6)	367,859	335,072	130,332.0	38.9	478,924	402,465.7	254,039.8	63.1
1	Taksa mbi pasurinë	122,860	122,860	71,806.1	58.4	95,515	95,515.0	99,604.0	104.3
1.1	Taksa mbi ndërtesat	97,020	97,020	54,523.2	56.2	70,122	70,122.0	78,661.3	112.2
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	3,814	3,814	4,580.3	120.1	10,064	10,064.0	5,105.0	50.7
1.3	Taksa mbi truallin	22,026	22,026	12,702.6	57.7	15,329	15,329.0	15,837.7	103.3
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	7,981	7,981	9,667.0	121.1	10,000	10,000.0	6,025.3	60.3
3	Taksa e ndikimit të infrastrukturës nga nd.reja	200,016	166,337	31,269.8	18.8	358,909	282,450.7	133,225.3	47.2
4	Taksa e tabelës dhe reklamës	12,002	12,002	11,615.5	96.8	4,000	4,000.0	5,114.5	127.9
5	Taksa e fjetjes në hotele	25,000	25,000	4,410.4	17.6	10,000	10,000.0	9,663.1	96.6
6	Taksa të tjera të përkohshme	0	892	1,563.2	175.2	500	500.0	407.6	81.5
-	Për infrastrukturën nëntokësore	0	0	0.0	0.0	0	0.0	35.2	=
-	Për infrastrukturën në arsim	0	892	1,563.2	175.2	500	500.0	372.4	74.5
I/b	E Ndara (1-5)	40,356	40,356	59,148.6	146.6	39,150	39,150.0	69,973.8	178.7
1	Taksa e kalimit të drejtës pronësisë P.Palujtshme	10,003	10,003	7,705.7	77.0	7,000	7,000.0	9,986.2	142.7
2	Taksa e regjistrimit të automjeteve	30,004	30,004	36,760.9	122.5	32,000	32,000.0	40,333.7	126.0
3	Taksa e rentës minerale	349	349	249.6	71.5	150	150.0	500.3	3.3 herë
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0	14,432.4	=	0	0.0	19,153.6	=
5	Taksa të tjera	0	0	0.0	0.0	0	0.0	0.0	0.0
II	Të Ardhurat Jotatimore (II/a + II/b + II/c)	291,785	248,933	147,350.7	59.2	261,941	261,941.0	211,100.3	80.6
II/a	Të ardhurat nga tarifët vendore	243,567	200,715	123,689.4	61.6	196,795	196,795.0	171,663.4	87.2
1	Tarifa shërbimi	122,001	106,888	70,394.2	65.9	99,352	99,352.0	98,369.4	99.0
-	Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeve	122,001	106,888	70,394.2	65.9	62,422	62,422.0	98,369.0	157.6
-	Tarifë ndriçimi publik	0	0	39.6	=	17,962	17,962.0	0.4	0.0
-	Tarifë gjelbërimit	0	0	0.0	0.0	18,968	18,968.0	0.0	0.0
2	Tarifë shërbimi veterinar	1,300	1,300	338.0	26.0	782	782.0	629.7	80.5
3	Tarifa të tjera (licence, leje, autorizime etj.)	2,000	2,000	800.0	40.0	2,000	2,000.0	2,000.0	100.0
4	Tarifë parkimi	8,000	8,000	4,773.1	59.7	4,500	4,500.0	7,890.8	175.4
5	Tarifë për kulturën	2,264	361	274.1	75.9	1,588	1,588.0	819.0	51.6
6	Tarifë për hapësirat publike	70,002	58,562	35,359.7	60.4	60,000	60,000.0	42,065.8	70.1
7	Të ardhura nga tarifët e Urbanistikës	10,000	10,000	4,278.8	42.8	10,000	10,000.0	9,741.6	97.4
8	Tarifë për shërbimet e MZSH	1,802	1,802	751.0	41.7	1,860	1,860.0	1,070.0	57.5
9	Tarifë leje transporti	2,000	2,000	1,291.0	64.6	1,319	1,319.0	898.9	68.1
10	Të ardhura nga tarifa e lëndeve drusore	70	70	105.2	150.3	489	489.0	57.4	11.7
11	Tarifa për shërbimet administrative	0	0	0.0	0.0	71	71.0	400.0	5.6 herë
12	Tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit	0	0	6.4	=	0	0.0	10.0	=
13	Pagesat nga Çerdhet	4,580	3,180	1,321.8	41.6	2,880	2,880.0	1,580.6	54.9
14	Pagesat nga Kopshtet	15,158	5,584	3,860.8	69.1	11,954	11,954.0	6,061.2	50.7
15	Pagesat nga nxënësit e Konviktit	3,400	968	95.7	9.9	0	0.0	69.0	=
16	Tarifa për sportet	990	0	0.0	0.0	0	0.0	0.0	0.0
II/b	Të ardhura nga shitja e pronës, dhënia me qira	2,818	2,818	6,798.6	241.2	8,030	8,030.0	8,787.5	109.4
1	Shitje ndërtesë banimi	0	0	0.0	0.0	0	0.0	0.0	0.0
2	Shitje troje	0	0	235.0	=	0	0.0	1,183.1	=
3	Shitje prona të tjera (automjete dhe inv.ek.)	0	0	0.0	0.0	0	0.0	0.0	0.0
4	Qira mbi trojet	0	0	6,493.5	=	6,493	6,493.0	6,493.5	100.0
5	Qira tokë bujqësore	1,387	1,387	60.1	4.3	95	95.0	1,095.9	11.5 herë
6	Qira mbi ndërtesat ,paisje etj.	1,431	1,431	10.0	0.7	1,442	1,442.0	15.0	1.0
II/c	Të ardhura të tjera	45,400	45,400	16,862.7	37.1	57,116	57,116.0	30,649.4	53.7
1	Nga dhuratat dhe sponsorizimet etj.	35,400	35,400	11,433.9	32.3	50,996	50,996.0	18,767.0	36.8
2	Nga gjobat	10,000	10,000	4,121.0	41.2	5,970	5,970.0	10,499.6	175.9
3	Të ardhura të tjera (debitorë, ankande etj)	0	0	1,307.8	=	150	150.0	1,382.8	9.2 herë
GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II)		700,000	624,361	336,831.3	53.9	780,015	703,556.7	535,113.9	76.1

Aneksi nr.7
Formati nr.2 “Pasqyra e përfomancës financiare”

NE/ LEKE				
Nr. rresh	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I M E P A R S H E M
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	2,468,996,556.48	1,539,175,288.13
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	178,922,582.41	549,837,139.88
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	8,866,992.00	7,115,037.00
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	8,866,992.00	7,115,037.00
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	66,809,109.41	56,815,325.32
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	66,809,109.41	56,815,325.32
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	103,246,481.00	485,906,777.56
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	103,246,481.00	485,906,777.56
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	95,180,605.15	110,104,381.00
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	7,818,465.00	11,332,555.00
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	7,818,465.00	11,332,555.00
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	87,362,140.15	98,771,826.00
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	72,146,056.65	78,696,680.00
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	7,663,752.00	9,754,021.00
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	751,000.00	430,000.00
44	7114	Te ardhura nga biletat	2,672,850.00	3,348,790.00
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime ezhdemtime	4,128,481.50	6,542,335.00
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
53	72	V.GRANTE KORENTE	2,194,893,368.92	879,233,767.25
54	720	1.Grant korent I Brendshem	2,194,893,368.92	879,233,767.25
55	7200	Nga Buxhetiper NJQP(Qendrore)	2,110,442,925.76	763,790,230.39
56	7201	Nga Buxhetiper NJQP(Vendore)	51,442,911.00	35,450,039.00
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	21,573,666	77,946,565
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	11,433,866.16	2,046,932.38
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	1,783,176,680.28	1,414,433,698.39
75	600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	391,062,362.00	458,222,801.00
76	6001	Paga, personel I perhershem	391,062,362.00	458,222,801.00
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	64,549,653.00	75,850,375
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	64,549,653.00	75,850,375.00
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	241,251,544.91	327,819,948.00
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,773,705.00	12,845,707.00
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	48,969,299.00	50,179,927.00
87	6022	Sherbime nga te trete	113,775,756.91	185,850,968.00
88	6023	Shpenzime transporti	25,855,674.00	14,867,756.00
89	6024	Shpenzime udhetimi	106,430.00	808,425.00
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	10,333,766.00	8,501,256.00
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	8,644,523.00	28,915,935.00
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	11,557,928.00	12,095,783.00
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0.00	0.00
94	6029	Shpenzime te tjera operative	12,234,463.00	13,754,191.00
101		V.TRANSFERIME KORENTE	1,081,507,641.00	564,017,169.00
102	604	1.Transferimekorentete brendshme	324,759,990.00	9,638,546.00
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	324,759,990.00	9,638,546.00
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	605	2.Transferimekorenteme jashte		
112	606	3.Transferimeper Buxhetet familjare e Individe	756,747,651.00	554,378,623.00
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	756,747,651.00	554,378,623.00
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	1,179,999.13	2,382,105.42
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	1,179,999.13	2,382,105.42
	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme	1,179,999.13	2,382,105.42
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	3,625,480.24	-13,858,700.03

131		IX.SHPENZIME TE TJERA		
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHDHES	685,819,876.20	124,741,589.74

Aneksi nr.8

Viti 2021

Urdher Shpenzimi					Fatura		Subjekti
VITI 2021							
Nr	USH	Date	Vlera	Pershkrimi	Date	Vlera	
1	86	1/20/2021	2,696,386	Energji Elektrike	31.11.2020	2,696,386	u.
2	108	1/28/2021	50,400	Blerje materiale ndertimore	10/20/2020	50,400	S.Shpk
3	110	1/28/2021	1,545,378	Blerje materiale ndertimore	02.10.20/	1,545,378	S.Shpk
4	121	2/9/2021	145,980	Adm&Sherb I miremb. se Varrezave	11/30/2020	145,980	F.SHPK
5	225	2/10/2021	233,940	dezif,dezinsederatizKopsh,Çerdh, Shk	9/11/2020	233,940	H. E. G.
6	244	2/22/2021	19,550	Aktivite ne 553-vjetorinSkenderbeut	1/13/2020	19,550	P.L.
7	318	3/1/2021	2,366,943	Grumb, Transpo,Depozi,e TrajtMbetje	12/31/2020	2,366,943	P. S. Shpk
8	320	3/1/2021	1,122,600	Grumb, Transpo,Depozi,e TrajtMbetje	12/31/2020	1,122,600	L. 2007 Shpk
9	321	3/1/2021	145,980	Adm&Sherbim I miremb. se Varreza	12/30/2020	145,980	F. SHPK
10	322	3/1/2021	1,590,839	Gjelberim I qytetit	12/30/2020	1,590,839	F. SHPK
11	324	3/1/2021	1,371,876	Blerje matriale ndertimore	10/13/2020	1,371,876	S. Shpk
12	374	3/9/2021	1,328,685	Ushqime, Kopshte,Çerdhe, konvikt	31.11.2020-	1,328,685	L. G. Shpk
13	390	3/8/2021	1,604,901	Nafte	11/16/2020	1,604,901	L.-80 shpk
14	404	3/10/2021	110,220	Sherbim Printimi dhe Fotokopjimi	04.11.2020	110,220	K. Shpk
15	419	3/19/2021	2,129,624	Blerje materiale ndertimore	13.10.2020	2,129,624	S. Shpk
16	420	3/19/2021	1,338,855	Nafte	12/24/2020	1,338,855	L.-80 shpk
17	515	4/2/2021	3,886,968	Bler Kabulli Elektrik ndricimit rrugor	12/22/2020	3,886,968	S.Shpk
18	532	4/9/2021	1,097,520	Ble emergjente lendes drusore shkolla	2/1/2021	1,097,520	V. B.
19	539	4/9/2021	695,379	Ushqime, Kopshte,Çerdhe, konvikt	2/26/2021	695,379	L. G. Shpk
20	540	4/9/2021	68,000	Qera Automjeti	Janar 2021	68,000	M. D.
21	542	4/9/2021	850,400	Nafte	1/8/2021	850,400	L.-80 shpk
22	543	4/9/2021	145,980	Adm&Sherbim miremb. se Varrezave	1/30/2021	145,980	F.SHPK
23	544	4/9/2021	3,181,678	Gjelberim I qytetit	26.02.2021	145,980	P.
24	591	15.04.2021	45,000	Pllaka Aktivitet "Cmimi At Zef Pllumi"	19.02.2021	45,000	P. Shpk
25	601	19.04.2021	670,800	Blerje uniforma & emblema policie	28.12.2020	670,800	V.Z.PF
26	611	20.04.2021	590,880	Riparim Automjetesh	30.10.2020	590,880	E.P.
27	612	20.04.2021	865,850	Nafte	20.01.2021	865,850	L.-80 shpk
28	672	05.05.2021	869,250	Nafte	27.01.2021	869,250	L.80 shpk
29	684	05.05.2021	2,404,366	Blerje materiale ndertimore	05.11.2020	2,404,366	S. Shpk
30	692	19.05.2021	236,999	Shërbim mirëmbajtje sistemi tatimor	12.02.2021	236,999	D. shpk
31	747	10.05.2021	1,218,968	Materiale Pastrimi	17.02.2021	1,218,968	L. G. Shpk
32	762	24.05.2021	872,000	Nafte	03.02.2021	872,000	L.-80 shpk
33	800	26.05.2021	6,367,200	Riparim Automjetesh	30.11.2020	6,367,200	E.P.
34	802	26.05.2021	5,877,020	Nafte	30.03.2021	5,877,020	L.-80 shpk
35	808	6/1/2021	242,709	Material miremb rrugeve e Trotuare	12/30/2019	242,709	D.shpk
36	884	6/9/2021	180,000	Interneti vitin 2021per bashkine e NJA	6/4/2021	180,000	E. M.
37	1376	9/10/2021	129,800	Blerje Gaz per Gatim	7/26/2021	129,800	E. C.
38	1378	9/10/2021	2,714,350	Nafte	6/23/2021	2,714,350	L.-80 shpk
39	1715	15.11.2021	379,680	blerje pajisje per sistemimin e zyrave	20.08.2021	379,680	Sh.
40	1734	23.11.2021	683,249	Materiale pastrimi	08.09.2021	683,249	L. G. shpk
41	1816	02.12.2021	954,950	Nafte	04.10.2021	954,950	L.80 shpk
42	1928	28.12.2021	64,281	Mësuesit me kontrate kurset e jashtme	12.04.2021	64,281	P. I.
			53,095,434				

Pagesat per investimet llogaria 230-231 "Shpenzime për investime"

Viti 2021

Urdher Shpenzimi					Fatura		Subjekti
VITI 2021							
Nr	USH	Date	Vlera	Pershkrimi	Date	Vlera	
1	418	19.03.2021	1,000,000	Blerje makine me kosh	12.06.2020	1,000,000	T.
2	394	09.03.2021	348,954	mbikqyrje : Miremb, sistem e asfaltim i rrugeve rurale	18.02.2020	348,954	T. shpk
3	409	11.03.2021	8,208,000.8	Ndert ujesj fsh Pllane,Zejmen, Markatomaj,Spiten, Tresh	28.12.2020	8,208,000.8	G. C. shpk
4	550	12.04.2021	19,215,000	Rehab I kanalit ujites Koterr -Rraboshte -Nenshat	30.01.2021	19,215,000	NG S. shpk
5	605	19.04.2021	276,600	MbikqRehab kanal ujites Koterr -Rraboshte -Nenshat	12.10.2020	276,600	N. M. PF
6	717	05.05.2021	1,181,340	Sistemim dhe rikonstruksinon e zyres me 1 ndalese	11.02.2021	1,181,340	C. shpk
7	728	07.05.2021	2,852,267	Hartim projek nderh rehabilit objekte e demtuaratermeti	27.03.2021	2,852,267	A. MK shpk
8	729	07.05.2021	6,655,288	Hartim projek nderh rehabilit objekte e demtuaratermeti	27.03.2021	6,655,288	NG S. shpk
9	795	24.05.2021	1,480,000	Sistemim asfaltim rruga e varrezave Pllane	31.01.2020	6,411,534	K.shpk
10	896	09.06.2021	287,700	Rik.i rr Zall-Shenkoll e sisit, asfaltim rruge se varrezave	12.07.2019	287,700	K. C. shpk
11	919	16.06.2021	20,000,000	Mirembajtje, sistemim dhe asfaltim i rrugeve rurale	11.02.2021	38,019,000	P. G. shpk

12	920	16.06.2021	2,088,200	Sistemim asfaltim rrugëve të brendshme Fshati Troshan	26.07.2019	9,088,200	Sh.07 shpk
13	1362	09.09.2021	9,620,000	Blerje automjesh: eskavator me zinxhire	12/06.2020	22,620,000	A. P.PF
14	1392	16.09.2021	300,000	Mbikqyrje punimesh: Ndërtim ujësjes Njesia Zejmen	14.06.2021	453,187	Xh & M.
15	1553	18.10.2021	12,619,440	Mirembajtja, sistemimi dhe asfaltimi I rrugëve rurale	24.05.2021	19,600,440	P. G. shpk
16	1575	22.10.2021	573,475	Mbikq punim objektit, Rehab kanal ujtes Koterr - Rraboshte -Nenshat Piraj -Rraboshte	10.04.2021	573,475	N. M.PF
17	1949	29.12.2021	753,455	Sherbim mbikqyrje Sist, Asf. Rruga Tale1-Alk-Tale2	13.08.2019	753,455	P. C. shpk
18	1950	29.12.2021	117,277	mbikq: Rivesh rrug Rrile-shkoll 9-vjecar Marash Gjoni	09.08.2019	117,277	P. C.shpk
19	1951	29.12.2021	1,200,000	Sistemim I oborrit te pallatit nr.28 lagjia Beselidhja	26.12.2019	2,225,879	N. SHPK
20	1855	09.12.2021	1,390,724	Ndërtim dhe ndricim trotuari e fshatit Manati	09.08.2019	1,390,724	U.N.shpk
21	1856	09.12.2021	5,409,250	Sis. Asfa rrug Kolin Gjok, Qendr Ola-Tunel L.Nen Terez	09.08.2019	5,409,250	U. N. shpk
			95,576,971				

Aneksi nr.9 **Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”**

Nr	Objekti	Kreditori	Numri i Fatu rave	Kreditor me dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.12.2020			
1	Furnizimi me uje deri Qershor2019	Ujesjelles Sh.a	486	25,306,644		3,444,866	28,751,510
2	Sherbimi Postar deri Qershor 2019	P. L.	338	4,263,201	4,263,201		-
3	Materiale Ndërtimi	S. Shpk	11	6,271,454		2,245,198	8,516,652
14	Krevate +karrige	E. L.	1	625,800	625,800		-
15	Sh Dezinfektim	H.E. G.	1	233,940	233,940		-
16	Automjete	T. SHPK	1	17,158,800	17,158,800		-
17	Kancelari	I. O.	1	490,935		45,757	536,692
18	Materi elektrike per ndricimin rrugor	D. A Shpk	5	2,573,185	2,573,185		-
22	Sherbim Autom. Policia Bashkiake	E. P.	2	590,880	590,880		-
23	Blok fjetje ne hotel	Shtypshk letra me vlere	1	720,000		64,500	784,500
24	Shpenzime gjyqesore	TT A. L.	-	1,371,429	1,371,429		-
25	Mb. Pun.Parki e Lulisht shesh perball shk Hydaj Lezha	I. D	1	34,800			34,800
26	Mbik pun Rivesh rrug Pran Shko 9 Vjec Marash Gjoni	I. D	1	117,277	117,277		-
27	Mb PunRr. Zalle Shenkoll +Mb. Pun. Asf Rr. Tale 1 Alk Tale 2+ Nd. Trot. Manati	P. C.	1	870,732	870,732		-
28	Mbikqyrje punimesh kanali vadites	N. M.	1	276,600	276,600		-
29	Mbikqyrje punimesh	R.-95 Shpk	1	554,004	554,004		-
30	Sherbim larje rruge	L. 2007 Shpk	1	568,435	568,435		-
31	Kryepleq viti 2016-2019	-	-	1,444,800	1,444,800		-
32	Pastrim NJA Dajc Kallmet Blinisht Balldren	Nderkom. zadrimë	1	689,085	689,085		-
33	Shpronësime	-	-	126,103,140			126,103,140
34	Gaz	S.&C shpk	1	209,364			209,364
35	Tabela sinjalistike	S.-S.-A.	1				2,231,400
36	Ushqime	L. G.Shpk	3				914,464
37	Kancelari per zyrat	A.Shpk	1				2,676,328
38	Sherbim DDD	M.Shpk	1				209,758
39	Hartim PDV	UTS	1				11,932,200
40	Sist. Asf.Rr. varrezaveBalldre	D. A Shpk	1	1,563,800	1,563,800		-
41	Rik. rrug Zall Shenkoll e rruges se varrezave	K. C.	2	3,537,148	3,537,148		-
42	Rruga Luigj Gurakuqi	A.B. Shpk	1	2,346,428			2,346,428
43	Rruga Superstrate Piraj	A. C.	2	6,675,040			6,675,040
44	Sist. Asf. rruge brendsh FshatTroshan	Sh. 07 Shpk	2	2,088,200	2,088,200		-
45	Sist.Asf Rr. Qender- Rrabosh - Shkoll 9 vj	Sh.07 Shpk	2	3,993,600			3,993,600
46	Sist. Asf. Rr.te brendshme Fshati Gramsh	N. Shpk	1	5,972,719			5,972,719
47	Sis. Asf. Rruge te brendshme Fshati Mabe	N. Shpk	2	10,279,300			10,279,300
48	Asf. Rr.Brend Tresh	D. A Shpk	1	4,662,700	4,662,700		-
49	Sist. Asf. Rr.Çameria	N. Shpk	1	9,688,352			9,688,352
50	Sistemim Asfaltim Blloku Lagjia Beselidhja	N. Shpk	1	3,259,808	3,259,808		-
51	Sist Asf RrugKakarrq –Gocaje Ndric Qend Kakarr	C.R. 2008	1	5,245,680			5,245,680
52	Sist Asf Rrug Kolin Gjoka nga Qend OLA te tunel	U. N.Shpk	1	5,409,250	5,409,250		-
53	Sist. Asf. Rr. e Varrezave Pllane	K. shpk	1	1,480,074	1,480,074		-
54	Nd.trotuari fshatit Manati	U. N. Shpk	1	1,390,724	1,390,724		-
55	Sherbim GPS	P. Shpk	1	88,048	88,048		-
56	Asf. Rr. Brend Lagjia e Pukjaneve	C. R.2008Shpk	1	5,912,173			5,912,173
57	Sist.Asf. Rr. Gjok Nika	N. Shpk	1	106,630			106,630
58	Sist. Rr. Hydajet Lezha Perballe Hotel Leti	N. Shpk	1	6,872,138			6,872,138
59	Sist. Asf. Bl. Lagjia Beselidhja tek DTT	N. Shpk	1	900,036	900,036		-
	Shuma Bashkia deri 31.12.2020			271,946,353	55,717,956	5,800,321	239,992,868

Detyrimet e trashëguara nga ish-Komunat që nga viti 2015

Nr	Objekti	Kreditore	Nu mri Fatu rave	Kreditore dt.	Likujduar viti 2021	Shtesat 2021	Detyrime 31.12.2021
				31.07.2015			
	Komunat			31.07.2015			
	Komuna Shengjin						
1	Rikualifikim Urban Shetitorja Eïllson	F.shpk	3	17,495,807			17,495,807
2	Punime sherbimi pagese karte Telefonike	F.shpk	1	552,000			552,000
	Komuna Dajc						-
1	Pyllezim shega	4 A.Shpk	1	4,907,937			4,907,937
	Komuna Kolsh						-
1	Furnizimi me uje Kolsh Viti 2010-2016	Ujesjelles Sh.a	37	4,669,581	727,592		3,941,989
2	Sherbimi Postar Kolsh viti 2009-2013	P.Lezhe	71	420,376			420,376
4	Mbikq Punime Ndert I Tregut Agroushqimor	L. Bano	1	664,013			664,013
	Vendim gjykate tregu Kolsh		1	918,831			918,831
	Komuna Balldren						-
1	Sherbim Interneti	G. N.	1	150,000			150,000
2	Blerje Librash	A.D.	1	32,500			32,500
3	Blerje Naftë	V.shpk	1	112,000			112,000
4	Blerje shtypshkrimesh	Enti botues Gj. F..	2	12,240			12,240
5	Blerje Naftë	Gj.K.	1	350,000			350,000
6	Sistemim asfaltim rruga Malecaj/Balldre	B.shpk	1	1,008,228			1,008,228
7	Projekte(kontrate)	A. Xh.	-	1,100,000			1,100,000
8	Projektime(me kontrate)	A.S.	-	499,999			499,999
9	Punime shkolle	D.I.	1	374,400			374,400
10	Mbikqyrje punimesh	L. V.	1	14,280			14,280
11	Blerje Kancelarish	K. K.	1	63,700			63,700
12	Sherbim Interneti Janar Shkurt 2016	Z.M.	1	20,000			20,000
13	Sherbim Interneti	R.C. Shpk	1	163,550			163,550
14	Sherbim Interneti	R.C.Shpk	1	150,000			150,000
15	Mbikqyrje punimesh Rikonstr Rruga Balldren	N. M.	1	47,400			47,400
16	Flamuj	E.C.	1	10,000			10,000
17	Kancelari	M.Z.	1	30,000			30,000
18	Pjese kembimi	B.P.	1	14,800			14,800
19	Dosje	K.K.	1	1,200			1,200
20	Kabull	L. c.	1	20,500			20,500
21	Pompe Uji	A.Z.	1	9,000			9,000
22	Riparim elektropompe	B. K.	1	30,000			30,000
23	Pjese kembimi	P. L.	1	520,200			520,200
	Shuma ish-Komunat			34,362,542	727,592		33,634,950
	Totali Bashkia + komunat			306,308,895	56,445,548	5,800,321	273,627,818